



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.02.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 30 janar 2019.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 11 shkurt – 1 mars 2019.
3. Seancë dëgjimore publike me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtës Sociale për skemën e ndihmës ekonomike dhe asistencës sociale.

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Klodiana Spahiu, Bardh Spahia, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Klotilda Bushka, Nuri Belba, Floida Kërpaçi, Halim Kosova, Grida Shqina Duma, Orjola Pampuri, Roland Xhelilaj, Lindita Metaliaj dhe Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Vangjel Tavo.

Të ftuar:

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Merita Xhafaj - Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Denada Seferi – Drejtore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Lida Leskaj - Nëndrejtore e Shërbimit Social Shtetëror
Miranda Pashaj - Drejtore drejtorie në SHSSH

Etiola Kola - Këshilltare në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Enzo Shijaku - Këshilltar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Mirëdita!

Sot në rendin e ditës kemi tri çështje: miratimin e procesverbalit të datës 30 janar 2019, miratimin e kalendarit të punës së komisionit për periudhën 11 shkurt – 1 mars 2019 dhe seancë dëgjimore publike me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtës Sociale për skemën e ndihmës ekonomike dhe asistencës sociale.

T’i marrim pikat e rendit të ditës një për një.

Sot është miratimi i kalendarit të punës dhe më pas vazhdojmë edhe me seancën dëgjimore me ministren e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale të kërkuar nga deputetja Grida Duma, që natyrshëm do të bëhet pjesë e kalendarit të këtyre tri javëve. Dakordësinë e kemi, se e kemi të mbartur.

Së dyti, në datën 13 propozohet të bëhet shqyrtimi në parim i projektligjit për nxitjen e punësimit.

Lidhur me këtë ligj, një nga problemet që ka ndodhur, që unë mendoj se do të kemi dakordësi, por edhe në rast se nuk e kemi do t’i drejtohem Kryetarit të Kuvendit për një mendim, është se pasi është parashkruar vetëm shqyrtimi nga ana e komisionit tonë si komision përgjegjës, por nuk është parashikuar (sepse ligji është goxha i komplikuar) dhënie mendimi nga Komisioni i Ligjeve, në rast se do të kishte interes edhe nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese.

Komisioni i ligjeve në këtë rast është i nevojshëm për shkak se ligji është goxha i komplikuar dhe ka mjaft elemente që kanë të bëjnë jo vetëm me teknikën legislative, por edhe me rakordime.

Mendoj që ne duhet t’ia kërkojmë Kryetarit të Kuvendit për të parë mundësinë që të shqyrtohet edhe nga ai komision.

Në qoftë se kemi dakordësi, ne fillojmë me shqyrtimin në parim ditën e mërkurë, në datën 13, ndërkohë ia kërkojmë kryesisë së Kuvendit këtë gjë, që të na ndihmojë në punën tonë, që gjetjet që kanë ata ne t’i reflektojmë në ligj që ligji të dalë sa më i mirë dhe më i plotë.

A jeni dakord me këtë?

(Diskutime pa mikrofon)

Një ligji të tillë, me aq volum, i cili ka një kohë të gjatë që shkon e vjen, se ky është një ligj i komplikuar, unë mendoj se do t’i bënte mirë...

Ne mund të bëjmë edhe një kalim të përciptë, por nuk e kemi kapacitetin e gjykimit për sa i përket anës legislative.

Klodiana Spahiu – Ju keni shumë të drejtë dhe unë e mirëkuptoj këtë gjë, se është një ligj me të vërtetë shumë i rëndësishëm ndaj ne kërkojmë shtyrjen e seancës, sepse, nëse do të kërkojmë këtë gjë, nuk bëhemi dot gati për datën 21.

Petrit Vasili – Kjo është një shenjë e vullnetit të mirë, që ne e fillojmë shqyrtimin në parim. Këto janë resurset që Kuvendi ka për ta përmirësuar edhe më, sepse kemi gjithmonë një lloj merak, se kapacitetet janë të ndryshme për detyrat që kanë komisionet e ndryshme. Ata e kanë këtë mundësi, ata mund edhe të refuzojnë që të gjithë, por në rastet se do të ketë ndonjë pasaktësi, ne të jemi të qetë se çfarë kishim ne e shteruar, kërkuam edhe mbështetjen e të tjerëve, meqë kanë një kompetencë juridike.

Ne e fillojmë punën tonë dhe në rast se në rrugë e sipër ka gjëra që e bëjnë ligjin më të mirë, dakord, nëse nuk ka ne vazhdojmë, se kjo do të evitonte shumë debatet që do të ndodhnin këtu, të cilat mund të shteroreshin atje më parë. Ky është qëllimi i vetëm në këtë punë.

Klodiana Spahiu – Ne jemi shumë dakord me këtë gjë, vetëm se do të kisha një propozim të vogël, nëse biem dakord. Na ka ndodhur në disa mbledhje komisioni që ne jemi anëtarë dhe nuk kemi mundur të marrim pjesë për shkak të përplasjes së orareve. Është shumë e vështirë të koordinohen mbledhjet midis komisioneve të ndryshme, por ne duke qenë në tre komisione shumë herë nuk kemi pasur mundësi të shkojmë fare.

A do të ketë mundësi, meqenëse ju e bëtë një propozim të tillë, që ky projektligj të shqyrtohet edhe në komisionet që kanë lidhje me tematikën që diskutohet që, të paktën, ta shtyjme, pra jo të mërkurën që është planifikuar?

Petrit Vasili – Për të qenë në rregull me vendimin e seancës, është thjesht prezantimi dhe ka votim.

Klodiana Spahiu – Ju kuptoj.

Petrit Vasili – Po, hapja e rrugës së shqyrtimit duhet të bëhet se do të thonë ju as nuk e keni hapur që të prezantoni, çfarë kërkon nga ne do të thonë.

Dakord atëherë, edhe për pikën e dytë biem dakord që ditën e mërkurë prezantohet në parim projektligji. Sigurisht, i pashoqëruar pa asnjë proces votimi dhe asnjë tjetër, vetëm t'u japim mundësi propozuesve që ta paraqesin ligjin.

Ndërkohë, sekretaria do të përgatisë një propozim, një sugjerim, që ne i bëjmë kryesisë së Kuvendit, që ta marrë në shqyrtim. Pastaj, sigurisht, në varësi nga përgjigja, do të riaplojmë datat me njëri-tjetrin dhe disponibilitetin që të evitojmë përplasjet e mundshme në oraret e komisioneve, për të bërë çdo gjë ashtu siç duhet.

Kështu që edhe për këtë kemi dakordësi.

Për datën 18, i bie si sot java, të bëjmë një seancë dëgjimore me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, lidhur me projektligjin “Për nxitjen e punësimit”. Kuptohet që është një ligj me ndjeshmëri të lartë.

A ka ndonjë propozim?

Nuk ka.

Biem dakord edhe për këtë pikë.

Në datën 19 është parashikuar të shqyrtohet projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar”. Është nismë deputeti. Data është përcaktuar jo rastësisht, se në datën 18 kjo nismë merret në shqyrtim nga Komisioni i Ligjeve dhe meqenëse ata mbarojnë punë më 18, ne e fiksuam mbledhjen në datën 19, për të vazhduar me paraqitjen e nismës dhe për të marrë vendim që nisma t’i paraqitet qeverisë për mendim, sikurse Rregullorja e përcakton. Qeveria ka të drejtën, në bazë të Rregullores, të shprehë opinionet dhe të japë një certifikim përfundimtar lidhur me faturën financiare që mund të ketë në ngarkesë ligji.

Relatori, propozuesi, ka pretenduar që ligji nuk ka ndonjë efekt financiar, megjithatë i takon qeverisë të thotë në mënyrë përfundimtare, në bazë të vlerësimit që bën, nëse nisma ka faturë financiare apo nuk ka.

A ka ndonjë vërejtje për këtë?

Nuk ka.

Miratohet.

Eventualisht kemi lënë një datë, e cila është edhe kjo me tentativë. Propozimi për shqyrtimin nen për nen për ligjin e punësimit në draftin që kemi është pa datë, pasi e kemi të pamundur sot të themi se cili do të jetë momenti, pasi ka disa zhvillime.

Kështu që ne, në varësi të zhvillimeve, edhe në rast se do të zhvillohet në komisionet e tjera, në mbledhjet e radhës që do të kemi të komisionit, do të biem dakord me njëri-tjetrin se kur do të jetë mundësia e shqyrtimit nen për nen të ligjit “Për nxitjen e punësimit”. Gjithsesi, po e përfshijmë në kalendar, megjithëse kalendari ka detyrimin të ketë shqyrtimin në parim, shqyrtimin nen për nen dhe shqyrtimin në tërësi të ligjit.

Kjo është si detyrim, por data është e pamundur të vendoset sot. Do të ishte mirë që të përfundonte çdo gjë brenda kohës së parashikuar në kalendar. Në rast se do të ketë rrethana madhore, pra që të tjerët nuk kanë përfunduar punën, mund të kemi ndonjë shtyrje, të cilën do ta vendosim të gjithë së bashku.

A ka vërejtje për këtë pikë?

Nuk ka.

Miratohet.

Një tjetër gjë që propozohet për t'u përfshirë, një propozim i deputetes Metaliaj.

Urdhëron, zonja Metaliaj!

Lindita Metaliaj – Propozimi im është të bëjmë një seancë dëgjimore me ministren e Shëndetësisë për funksionimin e qendrave shëndetësore në të gjitha rrethet, sepse konstatova qysh herën tjetër se prej më se një vit në qendrën shëndetësore të qytetit të Lezhës nuk funksionon më dhe nuk jepet shërbimi shëndetësor për fëmijët nga 0-1 vjeç dhe gratë shtatzëna dhe është spostuar nga qendra e qytetit në periferi, me një distancë prej 2 km. Pra, i gjithë qyteti nuk ka një qendër shëndetësore ku ofrohet shërbimi shëndetësor për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0-1 vjeç.

Kjo më dha shtysë për të kërkuar një dëgjese me ministren. Përveç kësaj, qendrat shëndetësore në njësitë administrative të Lezhës lënë shumë për të dëshiruar. Shumica e tyre nuk funksionojnë, janë thjesht disa ndërtesa të kalbura në të cilat jo vetëm nuk ka mjek dhe nuk ka ilaçe, por edhe si godina janë drejt shkatërrimit total.

Mendoj se qendra shëndetësore ka një rëndësi të veçantë.

Petrit Vasili – Kërkesa juaj është për Lezhën, apo në përgjithësi?

Lindita Metalia – E sqarova që në fillim se shtysa më lindi pikërisht nga qyteti që unë përfaqësoj, Lezha, sepse është një problematikë shumë e madhe që një rreth i tërë të mos ketë një qendër shëndetësore në qendër të qytetit. Nuk besoj se kjo ndodhë në të gjithë Shqipërinë, ndoshta edhe ndodh. Pra, unë kërkoj dëgjese për funksionimin e qendrave shëndetësore në të gjithë Shqipërinë.

(Diskutime pa mikrofon)

Petrit Vasili – Ky nuk është momenti i debatit. Ne vetëm po formulojmë objektin se cili do të jetë objekti i dëgjesës.

Objekti i dëgjesës do të jetë mbulimi nga pikëpamja infrastrukturore, domethënë mbulimi me qendra shëndetësore, apo mbulimi i qendrave të mëdha, sepse pretendoj që dëgjesa të jetë sa më informuese, duhet që edhe objekti të jetë sa më i qartë në formulim.

Qendrat shëndetësore në tërësinë e tyre janë pjesë integrale të shërbimit parësor të RSH-së dhe problemi është se ato janë të shpërndara në të gjithë territorin dhe janë të disa niveleve, ka qendra të nivelit të parë, qendra të nivelit të dytë dhe ato që quhen “ambulanca fshatrash”, që janë të nivelit të tretë, pra janë thjesht dhe vetëm për nevojat bazike të një infrastrukture të vogël, siç mund të jetë fshati. Do ta orientojmë më tepër mbulimin me qendrat shëndetësore, në mënyrë të veçantë në qytete, sepse e shpërndarë, flas meqenëse e njoh këtë problem, druaj se do të jetë shumë e gjerë dhe nuk do të arrijë dot as objektivin që ju mund

të keni, as edhe të informohemi si duhet. Pra, kemi interes të mbulimit me qendra shëndetësore të qyteteve, sepse “qytete dhe fshatra të tëra” është një informacion shumë i madh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doni ta amendojmë që qytetet në mënyrë të veçantë, qendra qarku, meqenëse janë qytetet më të mëdha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Një herë është miratimi në parim, pastaj kalohet në detaje.

Petrit Vasili - Ka një kërkesë. Ta formulojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Bode, të lutem!

Zonja Metaliaj, evitoni debatin me njëri-tjetrin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo! Unë po shkoj drejt një gjëje. Le të bëjmë debat kur ka vend për debat. Nuk doni ta vazhdojmë në mënyrë normale?

Kërkesa është e tillë, shumë e thjeshtë : funksionimi i qendrave shëndetësore, eventualisht i shëndetit parësor, sepse ai është themeli i funksionimit të saj, në mënyrë të veçantë në qytetet kryesore veçanërisht në ato që janë qendra qarqesh.

Sekretaria ta ketë parasysh, pasi kjo është kërkesa. Kemi dakordësi që të jetë edhe kjo pjesë?

Zoti Xhelilaj, se nuk dëgjohet zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu - Ne jemi afër, dëgjohet.

E mirëkuptojmë kërkesën që bëri kolegja. Gjithmonë kemi pasur dakordësi për të zhvilluar seanca dëgjimore, por së pari duhet të kemi parasysh se puna jonë kryesore është miratimi i projektligjeve, mendoj për këtë kalendar ku jemi. Miratimi i këtij projektligji “Për nxitjen e punësimit” është shumë i rëndësishëm dhe ne duhet të punojmë fort që ta nxjerrim këtë projektligj sa më mirë. Në gjykimin tonë edhe në emër të grupit socialist propozoj që seanca dëgjimore të shtyhet, ta zhvillojmë në një moment të dytë, të merremi me problemin që kemi aktualisht. Mendoj se ka plot rrugë që bazohen në Rregulloren e Kuvendit për të marrë informacione të detajuara, sesi është situata e qendrave shëndetësore në të gjithë Shqipërinë, ka rrugë të tjera nisur nga interpelanca dhe deri te kërkesat që i bëhen direkt ministrisë për t’u përgjigjur për situatën e qendrave shëndetësore me shkrim. Propozimi ynë është që seanca dëgjimore të shtyhet në një kohë të dytë. Këtë propozim ta hedhim në votim.

Petrit Vasili – Së pari, zonja Metaliaj e ka kërkuar këtë gjë përpara se ne të shqyrtonim kalendarin. Si kërkesë është bërë prej kohësh. Nuk është kërkesë e improvizuar. Jo rastësisht është këtu në këtë draft, sepse u kërkuar në praninë tuaj. Ne e parashikojmë në kalendar dhe në pamundësi për ta shqyrtuar, do të kemi mirëkuptim. Në rast se nuk kemi mundësi objektive për ta shqyrtuar në këtë kalendar, siç ka ndodhur, dëgjesa e sotme ka qenë e parashikuar prej kohësh në kalendar, me mirëkuptim është shtyrë për arsye objektive, e bëjmë pjesë të kalendarit dhe në rast se nuk e gjejmë dot hapësirën, nuk e përcaktojmë datën, e lëmë të hapur, sikurse ramë dakord për shqyrtimin nën për nën të projektligjit “Për nxitjen e punësimit” dhe brenda kalendarit. Në rast se mund ta realizojmë, le të mbetet, në të kundërt do të mbartet në kalendarin tjetër. Nuk e gjejmë të udhës që të mos e miratojmë për të qenë pjesë e kalendarit tjetër.

Po, zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – Mund të përqendrohemi te kjo pikë, le të flasim për këtë gjë. Ne nuk jemi dakord si grup që të mbetet në këtë kalendar.

Petrit Vasili – Ju nuk keni dakordësi? A ka problem për një kërkesë...

Klodiana Spahiu – Nuk mendoj se ka arsye për t'i zhvilluar më diskutimet dhe debatet rreth kësaj pike. Nëse kërkon ta votojmë, e hedhim në votë. Nuk jemi dakord që të përfshihet në kalendar.

Petrit Vasili – A mund të jepni një arsye, sepse zonja Metaliaj e ka kërkuar që më parë? Nuk jemi në kushtet që do ta hedhim në votë: duam apo nuk duam.

Klodiana Spahiu - Bazuar në Rregullore ju keni të drejtë që me një të tretën e votave të opozitës të propozoni seancë dëgjimore.

Petrit Vasili - Në cilën pikë të Rregullores? Çfarë duhet të bëjmë ne?

Klodiana Spahiu – Bazuar në Rregulloren e Kuvendit ju keni të drejtë që me firmën e një të tretës së anëtarëve të opozitës të kërkon seancë dëgjimore.

Petrit Vasili – Ju intereson kjo anë formale apo zhvillimi i saj? Këtu kemi një dakordësi që është e qartë. Këtu nuk ka ndonjë dakordësi maxhorancë –opozitë, sepse ne do të bëjmë një seancë dëgjimore, nuk kemi një ligj për të votuar. Ne kemi pranuar me shumë dashamirësi dhe mirëkuptim të kemi edhe nisma ligjore të deputetit, që janë shqyrtuar në mënyrë skandaloze në Kuvend dhe për të dalë nga ky impas, kemi pasur mirëkuptimin që t'u japim rrugë gjërave. Të ndërpresim mbledhjen e komisionit, po i mbledhim ato 4 firma, por mendoj se mund të dalim nga kjo gjë. Nuk ka për të ndodhur ndonjë gjë që do ta shtyni dhe nuk do ta votoni. Kjo është një mundësi për të pasur disa informacione më shumë. Kaq mendjehapur duhet të jemi për ta përdorur votën atje ku duhet. Si të doni!

Klodiana Spahiu - Zoti Vasili fatkeqësisht ju jeni shumë më mendjehapur, ne jemi më mendjembyllur, por unë kam këtë propozim për ju: po të diskutojmë për qendrat shëndetësore, pa diskutim që është bërë ajo që nuk është bërë në 40 vjet. Ne kemi këtë mendim, në qendrat shëndetësore është investuar aq sa nuk është investuar në shumë vjet më parë. Do t'ju lutesha shumë...

Petrit Vasili - Nuk është e vërtetë. Ka investuar maxhoranca socialiste më shumë se sa gjithë të tjerët. Nëse nuk keni informacion, kjo është puna juaj.

Klodiana Spahiu – Ne këtë mendim kemi. Nëse ju jeni dakord mirë, nëse jo...

Petrit Vasili- Kam një pyetje për të bërë, megjithëse formalisht ju vetë u shprehët dakord kur zonja Metaliaj kërkoi herën e kaluar që të përfshihej në kalendarin e javës tjetër. Kjo është në rekordet e komisionit. I qëndroni kësaj që keni thënë?

Klodiana Spahiu - I qëndroj fjalës sime që ne nuk jemi dakord të përfshihet në këtë kalendar.

Petrit Vasili- Në rregull. Le të depozitohet kërkesa. Zonja Metaliaj nuk ka asnjë problem...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, në rregull. E shmangim këtë gjë.

Roland Xhelilaj- Lindita e ke gabim. Ne na është paraqitur një draftkalendar ku thuhet: 11 shkurt -1 mars. Nuk është propozimi...

Petrit Vasili- E kemi futur eventualisht.

Roland Xhelilaj - Kryetari thotë ta fusim në këtë kalendar, ne themi jo, tek tjetri po. Nuk ka nevojë për diskutim.

Petrit Vasili –Më fal!

Pyetja është kjo, zoti Xhelilaj i gjithë ky fillim dhe mbarim është draft, edhe propozimi është pjesë e draftit. Kjo do të thotë, që ne kemi përfshirë këtu për të qenë krejtësisht korrektë nëse doni edhe nismat të cilat kanë qenë *pending* dhe për opinion. Nismat e deputetëve ishin për opinion dhe deri në momentin që ky bëhet kalendar janë të gjithë propozimet këtu. Këto që janë në kuti, nuk kanë ndonjë status të veçantë në krahasim me këtë që është shkruar me korsive. Madje këtu, në këtë komision, nuk e di nëse e mbani mend, keni qenë apo jo në atë moment, kur zonja Metaliaj e paraqiti dhe zonja Spahiu tha plotësisht dakord, ta përfshijmë në kalendarin tjetër. Mbi këtë dakordësi...

Klodiana Spahiu - Të shikojmë procesverbalet...

Petrit Vasili- Hajdeni të mbledhim firmat!

Klodiana Spahiu – Ju lutem!

Petrit Vasili- Zonja Metaliaj, të mbledhim firmat dhe të ecim më tutje. Kot humbasim më shumë kohë për këtë çështje, se nuk ia vlen.

Floida Kërpaçi - Faleminderit, zoti kryetar!

Do t'i bëja një propozim komisionit për të zhvilluar një seancë dëgjimore me ministrin e Brendshëm, ministren e Arsimit dhe me ministren e Shëndetësisë lidhur me rastin e rëndë të ndodhur në qytetin e Kavajës: përdhunimin e një të miture. Besoj se nuk është seancë për ta shpërfillur, por duhet të tregohemi të kujdesshëm të shikojmë rastin, se çfarë ka ndodhur dhe të gjithë bashkë të diskutojmë se çfarë mund të bëjmë për situatën dhe për fenomenin që po ndodh dita ditës në shoqëri. Unë besoj se është një situatë emergjente dhe do të propozoja të futej në këtë kalendar të punës së komisionit.

Petrit Vasili – Po, zoti Pendavinji.

Ilir Pendavinji - Duke marrë shkas edhe nga diskutimi që po bëhet, diskutimi më duket i pavlerë. Ne jemi të gjithë dakord se seancat dëgjimore i shërbejnë pozitivisht punës sonë, edhe qeverisë në rast se bëjmë një lloj analize, por për momentin jam me Rolandin. Në këtë kalendar nuk mund ta fusim. Mund të diskutojmë kur të diskutohet në kalendarin e ardhshëm. Për pjesën e zonjës Metaliaj

Petrit Vasili – Ilir e kalojmë këtë gjë, nuk gjetëm dakordësi.

Për korrektesë po ta përsëris sërish...

Ilir Pendavinji- Nuk dua të hyj në debat.

Petrit Vasili - Po ta përsëris, zonja Metaliaj në mënyrë shumë korrekte e ka paraqitur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patëm dakordësi këtu, tani nuk ka më marrëveshje fjale. U pa kjo punë, nuk kemi çfarë t'i bëjmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal!

Janë rekordet e komisionit. Ramë dakord që do të bëhej pjesë e kalendarit tjetër. Nuk e mohojmë dot, sepse gjërat janë të shkruara. Nuk doni ta bëni, puna juaj. Nuk është fundi i botës. As për zonjën Metaliaj nuk është fundi i botës. E mbyllim këtu.

Zoti Pendavinji, keni ndonjë gjë tjetër?

Ilir Pendavinji – Po, për pjesën e propozimit të zonjës Kërpaçi, nuk mendoj se mund të bëjmë një seancë të tillë. Nuk dua të jem pjesë e një maskarade që mund të bëjmë me atë fëmijë, se aq kam vajzën dhe djalën bashkë. Nuk më vjen mirë, sepse është gjë shumë sensibil

për të gjithë opinionin ajo që ka ndodhur. Të gjithë jemi të shqetësuar, por besoj se i bëjmë keq edhe vajzës, por edhe të gjithë situatës në lidhje me këtë gjë. Jam kundër për këtë pjesë.

Petrit Vasili – Po, zoti Spahia.

Bardh Spahia- Zoti kryetar, dëshiroj të jap një përgjigje të shpejtë pa dashur të hyj në polemika me zonjën Spahiu, e cila minimalisht duhet të informohet se gjatë qeverisjes së PD-së janë ndërtuar dhe rikonstruktuar 1200 qendra shëndetësore, shifër jashtëzakonisht larg asaj çfarë duhet të kishit bërë ju në 6 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju jap shifrat! Ju duhet t’i kishit lexuar dhe t’i dinit, por nuk ka problem.

Kur të ndërtoni ose të rikonstruktoni të paktën 20 qendra shëndetësore, hajdeni se edhe mund ta dëgjojmë këtë histori!

Kjo ishte një replikë e shpejtë, pasi nuk e keni informacionin e duhur.

Kalojmë te kërkesa konkrete. Zoti kryetar, mendoj se edhe në dritën e një investigimi, i cili me sa duket i ka të gjitha gjasat që të jetë një ndër skandalet më të mëdha në fushën e shëndetësisë, siç ishte investigimi i “ Shqiptarja. com” mbi lidhjet e dyshimta të kompanive që kanë me koncesion hemodializën, koncesionin e laboratorëve dhe të spitaleve private, për të cilat me sa duket Ministria e Shëndetësisë në rastin më të mirë nuk ka pasur informacion, në rastin më të keq ka qenë palë në fshehjen, mbulimin e këtij informacioni, i cili me sa duket arsye të vetme ka pasur korrupsionin e thellë në dhënien e këtyre koncesioneve. Unë do të kërkoj një interpelancë me ministren e Shëndetësisë, një dëgjese ku të sqarohemi mbi...

Klodiana Spahiu - Zoti Vasili, ju lutem, për procedurë!

Petrit Vasili - Ta mbarojë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardh Spahia - Mbi rrethanat e dhënies së këtyre koncesioneve dhe lidhjeve...

Petrit Vasili - Kur flet ti mbaron deri në fund, ndërsa zoti Spahia të mos flasë?!

Bardh Spahia – Të kërkonit minimalisht informimin e opinionit publik po edhe të këtij komisioni.

Petrit Vasili - Po propozon për dëgjese.

Bardh Spahia - Zonja Spahiu unë ju dëgjova me shumë vëmendje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili - E korrektoi, propozon dëgjese.

Bardh Spahia - Zonja Spahiu i dëgjova me vëmendje edhe perlat që lëshuat sot në komision. Unë nuk ju ndërhyra! Ki mirësinë dhe dëgjo kolegët, të paktën të komisionit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardh Spahia - Jemi duke diskutuar përpara miratimit. Për sa kohë nuk është miratuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...ka vend për sugjerime. Dakord, ky ishte sugjerimi im në dëgjuesë me ministren e Shëndetësisë, në lidhje me sqarimin e rrethanave të lidhjeve e dyshimeve të këtyre koncesioneve: hemodializën dhe laboratorët. Në rregull!

Petrit Vasili – Kemi tre propozime, që janë pjesë e të gjitha propozimeve të tjera, për të cilat patëm dakordësi, deri te pika e shqyrtimit nën për nën për zgjidhjen e punësimit, pa datë, siç ramë dakord. Njëri ishte propozimi për dëgjuesë, i zonjës Metaliaj, lidhur me qendrat shëndetësore, me sistemin parësor, të përqendruara në qytete, kryesisht qendra qarqesh.

Jemi dakord për ta përfshirë në këtë kalendar?

Kush është dakord? Kush është kundër?

Nuk miratohet me shumicë votash.

Ka një propozim tjetër nga deputetja Kërpaçi, për një seancë dëgjimore lidhur me ngjarjen e ndodhur në Kavajë. Pra, seancë dëgjimore me ministrin e Brendshme, ministren e Arsimit dhe me ministrin e Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, për të sqaruar apo për të hedhur më shumë dritë në lidhje me këtë ngjarje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thatë njëherë. Tani ta votojmë, jemi dakord apo s’jemi dakord.

Klodiana Spahiu – Një minutë, dakord, para votimit...

Petrit Vasili – Po, patjetër.

Klodiana Spahiu – Kisha një ndërhyrje të vogël. Zonjusha Kërpaçi ka bërë një propozim, që kjo të zhvillohet në Nënkomisionin për Barazinë Gjinore. E ka shkruar para pak minutash.

Unë mendoj se...

Petrit Vasili – Zonja Kërpaçi është shprehur saktësisht se nënkomisioni përkatës të përqendrohet në këtë çështje dhe jo tek ligji i inspektoriatit dhe sigurisë në punë. Ka thënë tjetër gjë.

Klodiana Spahiu – Dakord!

Petrit Vasili – Me një fjalë, kush është dakord me këtë propozim të zonjës Kërpaçi? Kush është kundër?

Prëzohet me shumicën e votave propozimi për një seancë dëgjimore në lidhje me çështjen e Kavajës.

Së treti, është propozimi i nënkryetarit të komisionit, zotit Spahia, lidhur me një seancë dëgjimore për sa u takon çështjeve që lidhen me elementë të korrupsionit eventual në kontratat që kanë të bëjnë me dializën dhe shërbimin e laboratorëve, nën dritën edhe të informacioneve të fundit, të bëra publike në medie.

Kush është dakord të jetë kjo dëgjese të jetë pjesë e këtij kalendari? Dakord? Kush është kundër?

Rrëzohet edhe propozimi për të bërë një seancë dëgjimore për hedhje dritë mbi korrupsionin në koncesionet e dializës e të laboratorëve, edhe sipas informimeve të medias.

Bardh Spahia – Zoti kryetar, a mund të bëj një sugjerim? Mbase është në interes të të gjithëve.

Petrit Vasili – Po. Shkurt.

Bardh Spahia – Propozoj një seancë dëgjimore edhe për situatën e gripit të derrit në vend, edhe kjo në kuadër të shqetësimeve të fundit, të bëra publike nga qytetarë të shumtë, për mbulim të situatës reale nga ana e ministrisë dhe e strukturave të shëndetësisë.

Petrit Vasili – Ja edhe një propozim tjetër, të fundit: organizimi i një dëgjese, urgjente, me sa e kuptova unë, lidhur me situatën më të fundit të influencës së derrit, por jo vetëm, e cila është shoqëruar edhe me vdekje, me qëllim informimin e komisionit për këtë çështje.

Kush është dakord? Kundër?

Pra, rrëzohet edhe kërkesa për t’u informuar lidhur me situatën e gripit, si dhe vdekjet që e kanë shoqëruar atë kohët e fundit.

Përfundimisht, mbetemi me kalendarin dhe me propozimet përkatëse, qoftë edhe për kërkesën për ligjin “Për nxitjen e punësimit”, me kërkesën eventuale kryetarit të Kuvendit për shqyrtimin nga komisionet e tjera.

Me këtë mbyllet programi i kalendarit. Besoj se s’kemi gjë tjetër.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: “Seancë dëgjimore publike me ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtës Sociale për skemën e ndihmës ekonomike dhe asistencës sociale.”, sa i takon dëgjesës së kërkuar nga deputetja Duma, lidhur me çështje që kanë të bëjnë me skemën e ndihmës ekonomike dhe asistencën sociale.

Përschendetje! Le të fillojmë.

Pra, vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Në këtë pikë, sot zhvillojmë një dëgjesë lidhur me probleme të skemës së ndihmës ekonomike e asistencës sociale dhe zbatimit në praktikë, dëgjesë e kërkuar nga deputetja Grida Duma.

E ftuar është ministrja e Shëndetësisë. Mirë se keni ardhur, zonja Ministre! Po ashtu edhe stafi që e shoqëron.

Hyjmë direkt në thelbin e çështjes së rendit të ditës.

Zonja Duma, shkurtimisht, cili është objekti i kërkesës suaj? Më pas do të na jepet mundësia të bëjmë pyetje.

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar, ju lutem, një propozim. Ndoshta ishte harresë, por nuk përmendët të ftuarit.

Petrit Vasili – Jo, jo, thashë: zonja Ministre dhe stafi që e shoqëron. Nuk i përmenda për t'i dhënë kohë zhvillimit të seancës.

Klodiana Spahiu – Thjesht meqë është procedurë, dhe meqë i kemi këta emra.

Petrit Vasili – Nuk është përjashtuar asnjë nga emrat. Mos na e humbni kohën me një gjë pa kuptim.

Zonja Duma, ju lutem!

Grida Shqina Duma – Faleminderit, zoti kryetar!

Dëgjesa me ministren e Shëndetësisë ka në fokus ndihmën ekonomike. Ndihma ekonomike është asistencë sociale financiare që i jepet familjeve në nevojë, që nuk kanë asnjë të ardhur.

Arsyeja pse e kemi kërkuar prej kohësh këtë dëgjesë, ka të bëjë me shqetësimin e madh që kemi për përjashtimin nga skema e ndihmës ekonomike të një numri prej mijëra familjesh, të cilët ndodhen në varfri ekstreme. Së dyti, është transparenca plotësisht e munguar për sa i përket mënyrës se si përzgjidhen përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike. Është bërë shqetësim i nivelit kombëtar fakti se, pas nisje së projektit nga Banka Botërore, për të vendosur kriteret dhe pikëzimin që përcakton se kush do ta marrë dhe kush s'do ta marrë ndihmën ekonomike, ndaj sot pas më shumë se një viti, jemi në këtë situatë. Unë ju kam dërguar shkresë, auditi i Kontrollit të Lartë të Shtetit ju ka kërkuar specifikisht, në faqen 6 të tij, që të publikoni formulën e pikëzimit të unifikuar. Nga ana tjetër, janë qytetarët që vijnë nga çdo qark i vendit, që shqetësimin më të madh kanë faktin që nuk e dinë se me cilat kritere përjashtohen, ndërkohë që kanë qenë në skemë, dhe gjendja e tyre jo vetëm që nuk ka ndryshuar, por është përkeqësuar.

Përpara se ju të filloni me këtë pjesë të dëgjësës, unë do t'ju pyes, ashtu sikundër edhe kolegët, besoj, në lidhje me mundësitë e abuzivizmit në këtë skemë, dhe mundësitë për t'u keqpërdorur si për efekte të fushatës elektorale, por edhe për afera të tjera, të cilat, siç do të shikoni nga argumentimi racional i shifrave që vetë ju paraqisni, ka shumë arsye objektive për të besuar se skema mund të keqpërdoret, siç dhe është keqpërdorur herë pas here.

Ju keni dërguar një raport. Paraprakisht, ju them se në raportin që keni dërguar nuk ka asnjë shifër totale mbi numrin e familjeve përfituese. Raporti juaj i referohet vetëm këtij viti, gjë që nënkupton se, që në këtë moment ju keni zgjedhur të shkruani në raport shifra brenda një viti, dhe nuk e thoni aspak numrin total të përfituesve. Ju thoni vetëm se sa kanë përfitur brenda vitit dhe sa kanë hyrë rishtas në skemë, por evitoni gjithçka tjetër.

Në fakt, ne kemi një vit që ju kërkojmë transparencën e skemës: pikëzimin. Po e them në parantezë: janë 56 milionë euro projekt i Bankës Botërore, që bëhet fjalë të sigurojnë 4-5 komponentë. Në raportin tuaj e keni kaluar vetëm me një paragraf, duke thënë se janë realizuar indikatorët e epsh komponentëve. Njëri, dhe më i rëndësishmi, që jua ka nxjerrë auditin i Kontrollit të Lartë të Shtetit është transparenca e pikëzimit. Në Fletoren Zyrtare jeni në shkelje të Kushtetutës, të së drejtës së informimit të qytetarëve, që e keni hequr kolonën se sa pikë ka çdo kriter i varfërisë. Nuk është transparente askund. Është menduar që skema të jetë një dualizëm mes pushtetit vendor dhe pushtetit qendror, por në fakt është kthyer në ping-pong.

Për ta mbyllur këtë parashtresë, vetë Banka Botërore ka deklaruar se tashmë skema rezulton jo plotësisht e kënaqshme, ndërkohë që shumë familje duhet të rifuten në skemë, sepse nuk e ka ulur aspak ndihmesën nda varfërisë.

Kjo ishte për parashtresë.

Faleminderit!

Petrît Vasili – Faleminderit, zonja Duma!

Fjala për ju, zonja Ministre!

Ogerta Manastriliu – Faleminderit!

Në fakt, është e çuditshme që jam kaq vonë në këtë komision, pasi duhej të isha shumë më shpejt, për të folur mbi reformën më të rëndësishme të programit të mbrojtjes sociale, që është reforma për skemën e ndihmës ekonomike. Më vjen mirë që jeni kujtuar tani, sepse në fakt prisja të vija shumë shumë më shpejt.

Ajo çfarë dua...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam për dëgjësë këtu, nuk jam për dialog. Jam për dëgjësë dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk ju ndërpreva.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të vazhdojmë?

Petrit Vasili – Zonja Duma, ju lutem! Keni plotësisht të drejtë të ndërhyni pasi të mbarojë.

E vetnja gjë, për të cilën donte t'ju korrigjonte zonja Duma, është se ju e dini shumë mirë që kjo dëgjese është kërkuar prej shumë kohësh, prej muajsh, dhe është shtyrë për rrethana objektive. Kësisoj, them ta kapërcejmë këtë pjesë, sepse ngjallim një debat të panevojshëm.

Ogerta Manastriliu – Ishte një konsideratë.

Petrit Vasili – Faktikisht, është kërkuar prej shumë kohësh, zonja Ministre.

Ogerta Manastriliu – Mund ta shmang këtë konsideratë, por mendoj se është një çështje shumë sensitive.

Petrit Vasili – Pa problem. Mund të vazhdoni!

Ogerta Manastriliu – Faleminderit për fjalën!

E nisim që nga koha kur filloi reforma e skemës së ndihmës ekonomike, nga targetimi jo i mirë i varfërisë që kishte modeli i mëparshëm, si dhe të gjitha situatat disavantazhuese për tërë ato familje në nevojë, që kjo skemë nuk siguronte.

Në vitin 2008, programi i ndihmës ekonomike arriti të mbulonte vetëm 22 % të familjeve të varfra, kundrejt një mbulimi 36 % në 2005-ën.

Kriteret e vlerësimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, të përcaktuara me ligj, kishin elementë të cilët përjashtonin familje të varfëra nga ndihma ekonomike.

Studimi i Bankës Botërore, që ka mbështetur këtë reformë, ka treguar se nga zbatimi i kriterëve përjashtuese, që kishte kjo skemë e ndihmës ekonomike, 60% e familjeve të varfëra përjashtoheshin nga mundësia e përfitimit të ndihmës ekonomike. Dhe çfarë sillte kjo? Me kriteret që ishin në skemën e mëparshme të ndihmës ekonomike, procesi i vlerësimit për familjet në nevojë ishte tërësisht subjektiv dhe, më shumë se transparent, ishte abuziv nga bashkitë apo administratorët socialë.

Pas fillimit të punës për implementimin e kësaj skeme, rezultoi që në njësitë pilote ishin më shumë se 18 mijë familje, të cilat nuk përfitonin, siç e parashikonte ligji. Nuk kishte asnjë sistem elektronik për menaxhimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, pra nuk kishte asnjë regjistër dhe çdo përzgjedhje apo proces bëhej në bazë të letrave të paverifikuara nga institucionet përkatëse. Nuk kishte një sistem të ngritur, që, pa dyshim, sillte edhe inefficiencë në aplikimin dhe përfitimin e pagesës.

Aplikuesit për ndihmë ekonomike, edhe pse të varfër, duhet të përballeshin me kostot e marrjes dhe të depozitimit të një numri dokumentesh pranë administratorit shoqëror dhe institucioneve të tjera. Administratorët shoqërorë, nga ana tjetër, duhet të shpenzonin kohë për të kryer verifikimet e deklaramit të aplikantëve përmes komunikimit me një rrjet institucionesh të tjera dhe mundësia e kapjes së deklarimeve të rreme ishte pothuajse zero. Nuk kishte asnjë mekanizëm që të monitoronte performancën e sistemit të ndihmës ekonomike.

Projekti i modernizimit të asistencës sociale synon (sot mund të flasim me shifra) një shenjestrim më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të familjeve më në nevojë, duke modernizuar e administruar më mirë dhe në mënyrë më eficiente skemën e ndihmës ekonomike; duke ngritur mekanizmat për të reduktuar abuzimet dhe gabimet, për rrjedhojë edhe rritjen e eficiencës së programit; duke filluar që nga përdorimi i teknologjisë së informacionit në procesin e aplikimit dhe dhënies së ndihmës ekonomike, nëpërmjet ngritjes së regjistrit elektronik të ndihmës ekonomike; duke krijuar regjistrin kombëtar dhe verifikimin automatik me të gjitha institucionet; duke shmangur një herë e përgjithmonë procedurat e gjata të aplikimit dhe marrjen e vendimit për përfitimin e ndihmës ekonomike; duke shmangur çdo abuzim; duke përdorur një formulë të pikëzuar për përzgjedhjen e përfituesve, e cila targeton më mirë varfërinë dhe shmang subjektivizmin njerëzor në vlerësimin e nevojave të familjes.

Për herë të parë vendimmarrja për përfituesit u vendos nga drejtoritë e Shërbimit Social Shtetëror, jo nga këshillat bashkiakë, siç ndodhte më parë.

Si fillim, skema e ndihmës ekonomike, pra reforma, u shtri në tri qarqe pilot; u mbikëqyr sistemi; u adresuan sfidat nga të gjitha institucionet, nga Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Mbrojtjes Sociale dhe ekspertët e Bankës Botërore.

Dua të theksoj që gjithë reforma është ndjekur hap pas hapi nga ekspertët e Bankës Botërore, është punuar me ta në të gjitha hapat e procesit, qoftë në sistemin elektronik të propozuar, qoftë në vendosjen e formulës unike të pikëzimit sipas koeficientëve përkatës.

Banka Botërore i ka sqaruar në komunikim e saj publik, por edhe në atë institucional (meqë përmendët Kontrollin e Lartë të Shtetit) se cilat janë arsyet e vendosjes së koeficientëve në formulë dhe se cilat janë arsyet e bërjes apo mosbërjes publike të kësaj formule nga një rreth ekspertësh, që dinë ta lexojnë formulën dhe nuk e bëjnë atë publike për arsye politike, jo për arsye të përmirësimit të eficiencës.

Ndërkohë, në të gjitha hapat e procesit që ka ndjekur Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social, Banka Botërore ka dhënë gjithmonë objeksionin e saj për të gjitha veprimet e ndërmarra për qëllimin e kësaj reforme, që është targetimi më i mirë i familjeve, të cilat kanë më shumë nevojë për këtë mbështetje dhe ndihmën ekonomike.

U arrit që Banka Botërore të konfirmojë që në janar të 2018-s ne ishim gati për ta shtrirë skemën pas pilotimit, i cili rezultoi efikas dhe në tri qarqe, në Durrës, Elbasan dhe Tiranë nxori se rreth 14 mijë familje këtë ndihmë ekonomike e merrnin në mënyrë abuzive. Vendosëm ta shtrimë këtë skemë të re në gjithë vendin.

Në janar, ju e mbani mend shumë mirë që kemi pasur edhe një interpelancë, një mocion, ku kemi shpjeguar në mënyrë të detajuar mënyrën se si u aplikua skema në të gjitha bashkitë. Kemi reduktuar të gjitha kriteret përjashtuese, që shpesh linin jashtë kësaj skeme familje, që, për shembull, ishin shpërngulur nga zonat rurale në ato urbane pas vitit '91, familje që kishin në përbërje anëtarë që përfitonin pension apo ndonjë të ardhur tjetër. Pas aplikimit të skemës në të gjithë territorin vërejtëm se më shumë se 18 mijë familje aplikuan për herë të parë në këtë skemë, që, në sajë të kriterëve përjashtuese, nuk lejoheshin të aplikonin më parë.

Përdorimi i skemës ka rritur saktësinë e të dhënave, sepse me këtë vendimmarrje dhe këtë skemë të re, qytetarët, familjet, duhet të deklarojnë të vërtetën, pasi sistemi i nxjerr në mënyrë shumë të qartë të gjitha aktet që ti mund t'i kesh plotësuar gabim.

Ka dy momente, që ne i kemi hasur gjatë implementimit të skemës në periudhën janar-mars. Shumë qytetarë nuk e vlerësonin plotësimin e formularit, kur shkonin për të bërë deklarin për aplikimin për skemën e ndihmës ekonomike. Po ashtu, në disa raste kemi konstatuar se administratorët socialë nuk kishin përgjegjësi maksimale në plotësimin dhe leximin e të gjitha pikave të familjarëve apo anëtarëve që aplikonin nga familja. Si rezultat i kësaj, në tremujorin e parë janë shfaqur disa problematika, të cilat janë korrigjuar më tej me këtë skemë të re.

E kemi thënë edhe më parë, e kemi thënë edhe në mars, ne i kemi verifikuar shqetësimet e qytetarëve për aplikimet.

Kjo skemë ka garantuar një gjë: nuk ka më nevojë të vish me një seri dokumentesh për të aplikuar për një program të mbrojtjes sociale. Mjafton vetëm karat e identitetit për të aplikuar në skemën e ndihmës ekonomike, nga 9 dokumente që duheshin më parë për të aplikuar për ndihmën ekonomike.

Nga ana tjetër, për të gjithë ata që aplikojnë dhe nuk dalin përfitues, ka një mundësi të dytë, që është mbështetja e kushtëzuar nga buxheti i mbrojtjes sociale, që tashmë është rritur. Nga 3% që ka qenë mbështetja për bashkitë, tashmë është 6 %, për të gjithë ata që nuk janë përfitues nga sistemi elektronik, duke qenë se është një sistem i ftohtë, i bazuar në një koeficient, i cili përlllogarit ftohtë, por saktë aplikuesit si përfitues. Nga ana tjetër, i lihet mundësia bashkisë që, nëpërmjet kriterëve të vendosura nga këshilli bashkiak, të mundet të përfshijë në skemën ndihmës ekonomike (me fonde të buxhetit të shtetit, të Ministrisë së

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilat janë dyfishuar, nga 3% në 6%) familjet që sistemi nuk i ka përfshirë, duke vendosur madje kritere sipas situatave të ndryshme në bashki.

E thashë numrin e familjeve që për herë të parë aplikuan për të përfituar ndihmën ekonomike. Nuk ishin pak, por ishin 18 mijë e 730 familje, që aplikuan për herë të parë në këtë skemë, vetëm me heqjen e kritereve skualifikuese.

Ishin 14 mijë e 86 familje që përfituan për herë të parë ndihmë ekonomike, pikërisht në sajë të sistemit, që tashmë shmang abuzimet për deklarime fiktive, në sajë të bërjes së skemës shumë më të hapur dhe transparente për familjet që janë në vështirësi ekonomike dhe kanë nevojë të mbështeten nga programet sociale.

Nga muaji në muaj, nga janari deri në dhjetor të 2018-s... Një reformë apo një skemë e re ka nevojë për t'u konsoliduar, për t'u përmirësuar. Edhe ne kemi nevojë për t'u përmirësuar, sepse kjo nuk është një punë që e bën një institucion, por bëhet në mënyrë të bashkërenduar: pushtet qendror, pushtet lokal, organizata të shoqërisë civile, si dhe vetë qytetarët, të cilët duhet të ndërgjegjësohen për detyrat që kanë, në kuadër edhe të përfitimit të shërbimeve sociale apo pagesave *cash*.

Dua të ndalem te disa kategori, që janë prioritare dhe janë mbështetur më shumë në kuadër të implementimit të kësaj reforme: gratë kryefamiljare, ku nga muaji në muaj, në sajë edhe të konsolidimit të skemës, është rritur numri i përfitueseve. Janë 6463 gra kryefamiljare që trajtohen me ndihmë ekonomike në muajin dhjetor, krahasuar me 4277 gra kryefamiljare në muajin janar 2018.

Dua të shtoj (do të jap edhe numrin e përgjithshëm të aplikimeve dhe përfituesit e dhjetorit 2018) që për herë të parë kjo skemë hoqi pagesat e pjesshme, ndihmën ekonomike të pjesshme, që ishte një lëmoshë për të mbajtur peng familjet për arsye politike dhe abuzive, të cilat rrinin në varfëri dhe jetonin me 8 mijë-10 mijë lekë të vjetër, që jepeshin nga këshillat bashkiakë.

Besoj se jeni në dijeni që me pilotimin e reformës më shumë se 4 anëtare të këshillave bashkiakë kanë shkuar për ndjekje penale për arsye të abuzivitetit me pagesat e ndihmës ekonomike dhe pagesat e pjesshme.

Prandaj numri i aplikuesve ishte 100 mijë dhe i fituesve 90 mijë në vitet kur qeverisnit ju, sepse e ndanit ndihmën ekonomike në 100 mijë familje, ndërkohë që e përdornit për arsye tërësisht politike dhe abuzive.

Kjo reformë, e ndjekur nga ekspertët e Bankës Botërore, hoqi të gjitha pagesat e pjesshme, duke dyfishuar masën mesatare të ndihmës ekonomike për familje dhe duke vendosur pagesat e subvencioneve.

Në dhjetor, numri i aplikimeve për përfitimin e ndihmës ekonomike ishte 63 150 familje aplikuese. Numri i familjeve përfituese ishte 60 052, pa përfshirë këtu 6%-in, fondin që alokohet, nga i cili në muajin dhjetor përfituan më shumë se 3800 familje. Pra, nëse ne bëjmë një përlllogaritje të thjeshtë, përfitues janë rreth 98% e aplikuesve.

Kjo skemë ka nevojë të konsolidohet muaj pas muaji. E rëndësishme është që skema e ndihmës ekonomike nuk mund të jetë një skemë ku familjet vendosen në një status pasiviteti dhe dembelizmi. Skema e ndihmës ekonomike dhe e mbrojtjes sociale është një program që duhet të alternohet me ndihmë dhe shërbime në komunitet, si edhe me alternativë të punësimit dhe formimit profesional.

Vetëm në këta muaj janë trajtuar nga zyrat e punësimit 15 mijë individë, nga të cilët, për periudhën shkurt-dhjetor 2018, janë punësuar rreth 4200 prej tyre. Gjithashtu, janë regjistruar në programet e formimit profesional 681 persona ish-përfitues të skemës së ndihmës ekonomike dhe përfitues aktual. Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Ministre!

Po, zonja Duma.

Grida Shqina Duma – Zonja Ministre, sa është numri total i përfituesve nga skema?

Ogerta Manastirliu – 60 052 familje, pa përfshirë fondin 6% që u akordohet bashkive.

Grida Shqina Duma – Deri në cilën datë është kjo shifër?

Ogerta Manastirliu – E muajit dhjetor.

Grida Shqina Duma – E dhjetorit të vitit 2018.

Ogerta Manastirliu – Po.

Grida Shqina Duma – Sa familje kanë përfituar në vitin 2017?

Ogerta Manastirliu – Nuk ka bazë krahasimi, sepse kjo skemë nuk ka qenë në vitin 2017.

Grida Shqina Duma – Ka qenë. Sa ka qenë numri i përfituesve në vitin 2017?

Ogerta Manastirliu – Jo, nuk ka qenë. Duhet të kuptosh, pastaj të flasësh. Zonja Duma, nuk e thua dot sa ka qenë, sepse nuk ka bazë krahasimi.

Grida Shqina Duma – Po ju drejtohem me “ju”...

Ogerta Manastirliu – “Zonja Duma”, thashë.

Petrit Vasili – Bëni të gjitha pyetjet në mënyrë që të ketë mundësi ...

Vazhdoni, zonja Duma.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka mbaruar. Po bën pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund t'ia ndërpresim fjalën. Ka kërkuar dëgjesën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pendavinji, ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të mos përgjigjet. Nuk mund t'i kontrollojmë pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grida Shqina Duma – Të mbaroj unë dhe pastaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Të mbaroj fjalinë.

Grida Shqina Duma – Ilir, unë e kam nisur fjalën. Ju merreni për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptova. Ta mbaroj unë ...

Bardh Spahia – Ilir, ta kishe ndërprerë kur po fliste ministrja. Tani zonja po flet

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po i ndërpret fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ndërpritet. Ndërprisnit ministren. Zonja është duke folur.

Petrit Vasili – Vazhdoni, zonja Duma.

Ilir Pendavinji – Jo, nuk mund të vazhdojë. Nuk mund të vësh veton këtu.

Petrit Vasili – Çfarë kërkon konkretisht?

Ilir Pendavinji – Në këtë komision kanë hyrë tre qytetarë që nuk janë të ftuar. Duhet të nxirren jashtë ata dhe më pas të vazhdojmë fjalën zonja Duma.

Arben Kamami – Zoti kryetar, tek të pranishmit janë emrat e përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë. Ndërkohë, shikojmë që janë në komision tre përfaqësues të tjerë, të cilët nuk i njohim. Kush janë këta persona? Nuk ka asnjë problem, por duhet të ishin prezantuar që në fillim të takimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Zonja Duma, do ta marrësh fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Jo, nuk mund të vazhdojmë kështu. Nuk mund të vijmë qytetarët e Kamzës këtu dhe të bëjnë shown politik të Partisë Demokratike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar i komisionit, për procedurë ju kam kërkuar të lexoni emrat e të ftuarve. Kjo është e papranueshme. Ju kam kërkuar të lexoni emrat e të ftuarve në fillim të seancës dëgjimore. Nuk ka ndodhur asnjëherë që para seancës dëgjimore të mos prezantohen të gjithë të ftuarit. Ju lutem, po ju kërkoj edhe një herë të lexohen emrat e të ftuarve në këtë seancë dëgjimore, që neve na i ka dërguar sekretaria e komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili - Do të të kthej unë përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Nuk vazhdon kështu mbledhja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi frikë, por ka procedurë. Je nënkryetar komisioni, Bardhi. Nuk drejtohet kështu ky komision.

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar i komisionit, ka mundësi ta drejtosh këtë komision? Ju lutem, thërrisni gardën, të nxjerrin jashtë njerëzit që nuk janë të ftuar në këtë komision. Zbatoni procedurën ligjore dhe Rregulloren e Kuvendit. Ju si kryetar komisioni duhet ta zbatoni tani që të vazhdojmë procedurën.

Petrit Vasili – Dakord, por ja ta mbarojë fjalën zonja.

Klodiana Spahiu - Jo, zbatoni procedurën. Është rast i paprecedent.

Ilir Pendavinji – Nuk vazhdon mbledhja pa u zbatuar procedura.

Klodiana Spahiu – Nuk ka ndodhur kurrë në historinë parlamentare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu - Përgjegjësia është e kryesisë së komisionit. Ne të katër jemi pjesë e kryesisë së komisionit. Emrat që na kanë ardhur janë këta. Përgjegjësia është juaja nëse ju pranoni emra të tjerë.

Ju lutem zoti kryetar, prononcoheni për këtë gjë para se zonja Duma të vazhdojë fjalën.

Grida Duma – Mund ta marr fjalën për procedurë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Ashtu siç e morët ju fjalën për procedurë, ka edhe ajo të drejtën të bëjë të njëjtën gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Ju lutem zgjidhni pikën e parë. Është procedura e fillimit të seancës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Siç ndërhyri Pendavinji për procedurë, ka të drejtë ta bëjë edhe ajo.

Klodiana Spahiu – Duhet përgjigjja juaj përpara se të vazhdojmë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grida Duma – Për procedurë. Me mirëkuptim unë e ndërpreva fjalën meqenëse ju kishit shqetësim që dy qytetarë shqiptarë, as të Partisë Demokratike dhe as të Partisë Socialiste, të cilët nuk kanë përfituar ndihmën ekonomike, kanë paraqitur një kërkesë për dëgjuesë. Nuk po bëjnë asgjë, thjesht po qëndrojnë aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, të mbaroj. Po flas për procedurë. Në këtë komision kemi pasur të ftuar grupe interesi nga më të ndryshmet. Ajo që nuk ju nderon është që shqetësoheni kaq shumë që në mbledhje janë prezentë dy qytetarë në nevojë, të cilët janë duke dëgjuar. Kaq ka ndodhur. Këtë po e them për dëgjuesit.

Fakti që ata qytetarë janë këtu po u shërben atyre, sepse për herë të parë po e kuptojnë pse nuk e kanë marrë ndihmën.

Janë dy qytetarë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Petrit, nuk mund të vazhdojë kështu kjo mbledhje.

Klodiana Spahiu – Ju lutem, kryetar i komisionit, për procedurë!

Kjo që po bëni është në shkelje totale të ligjit.

Petrit Vasili – Do apo nuk do sqarim?

Klodiana Spahiu – Mos bërtit! Jepe sqarimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili - Meqenëse ka një shqetësim ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Ju lutem, merreni fjalën për të sqaruar problemin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Meqenëse

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Zbato procedurën!

Petrit Vasili – Pusho! Pusho! Mbylle mikrofonin që të flasë.

Ata qytetarë nuk kanë të drejtë as të flasin dhe as të marrin pjesë në debat. Meqenëse ka në shqetësim nga komisioni, ju lutem qytetarëve të dalin nga mbledhja.

Klodiana Spahiu – Jo, nuk është shqetësim, por procedurë. Nuk ka lidhje me shqetësim. Pse e bëtë këtë gjë? Pse e shkelët Rregulloren?

Petrit Vasili – Unë nuk kam bërë gjë fare. Nuk shkelëm asnjë Rregulloren?

Klodiana Spahiu – Ju si kryetar komisioni, pse e shkelët Rregulloren? Pse nuk i prezantuat të ftuarit?

Petrit Vasili – Cilët të ftuar?

Klodiana Spahiu – Këta që ishin këtu.

Petrit Vasili – Ata janë stafi i ministrisë.

Klodiana Spahiu – Pse nuk i prezantuat njerëzit që kishit ftuar?

Petrit Vasili – Në momentin e hapjes së mbledhjes nuk ka pasur asnjë të ftuar në sallë.

Klodiana Spahiu – Atëherë, po kthehemi në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. Që një person të futet brenda në parlament ...

Petrit Vasili – Sekretaria, kur hapëm mbledhjen, ka qenë vetëm stafi i ministrisë, apo jo?

Klodiana Spahiu – Atëherë, si hyn këta njerëz?

Petrit Vasili – Nuk e di.

Klodiana Spahiu- Përgjegjësia qenka e sekretarisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Nuk ishin kur u hap mbledhja.

Klodiana Spahiu – Ne do ta zgjidhim këtë gjë, por do të merrni në qafë njerëz që janë në punë këtu.

Petrit Vasili – Nuk kanë qenë të ftuar.

Klodiana Spahiu – Nuk ka shanse që të hyjë njeri pa konfirmimin e kryetarit të komisionit. Nuk ka shanse të ngjiten lart, sepse nuk i fut njeri.

Petrit Vasili – Nuk kam komunikuar me askënd nga sekretaria.

Klodiana Spahiu – Ju si kryetar komisioni së bashku me zotin Bardhi si nënkryetar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Nuk kam komunikuar me asnjë. Vazhdojmë mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Zoti Bardhi, këtu jemi në parlament dhe nuk mund të hyjë dot çdo njeri. Ata që janë të ftuar e bëjnë kërkesën me shkrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Vasili, ...

Bardh Spahia - Sot e treguat që u fshiheni qytetarëve. Ky ishte rezultati. Nuk përballeni dot as me dy qytetarë, të cilët janë hequr nga lista e ndihmës ekonomike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili - Po, zonja Duma.

Grida Shqina Duma – Do të vazhdojmë, apo jo?

Klodiana Spahiu – Ka mundësi të flas për procedurë?

Petrit Vasili – Jo, do të vazhdojë zonja, sepse ka lënë pyetjet në mes.

Grida Shqina Duma – Qytetarët dolën jashtë, ndaj duhet të jeni të lumtur.

Klodiana Spahiu – Jo, nuk dalin jashtë. Ju duhet të tregoheni korrekt dhe të ndershëm pse e bëtë këtë punë, sepse nuk i njihni rregullat e parlamentit shqiptar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne përballemi përditë me qytetarët. Kjo histori është e paprecedentë në parlamentin shqiptar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardh Spahia – Ju tmerron transparenca me qytetarët shqiptarë. E treguat sot.

Klodiana Spahiu – Zoti Spahia, pusho një minutë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardh Spahia – Ju nuk doni transparencën me qytetarët shqiptarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – ... dhe për këtë arsye ju nuk duhet të bënit një gjë të tillë

Bardh Spahia – E humbët rastin për t’u treguar transparentë me qytetarët shqiptarë, me ata të dy atje dhe me ata që ju shikojnë nëpërmjet televizioneve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Logjika juaj është shumë dritëshkurtër. Hilet dhe poshtërsia nuk të çojnë askund. Nuk mund të vazhdosh në këtë komision me hile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kërkojmë 5 minuta pushim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji - Zbato procedurën. Je nënkryetar komisioni dhe nuk mund të flasësh kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardh Spahia – Je përfaqësues i popullit, zotëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëre tani! Po më tregon mua parlamentar. Parlamentari është për të përcjellë hallet e atyre njerëzve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Zoti Spahia, të vazhdojmë tani, se e debatuar...

Klodiana Spahiu - Zoti kryetar, kërkoj 5 minuta pushim.

Petrit Vasili – Vazhdojmë me zonjën Duma!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdoni, zonja Duma!

Grida Shqina Duma – Mbani pak qetësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu - Ju lutem, zoti kryetar, kërkoj 5 minuta pushim.

Grida Shqina Duma – Mund ta nxirrni jashtë dikë, që nuk pushon.

Petrit Vasili – Zonja Kërpaçi, ju lutem!

Vazhdoni, zonja Duma me pyetjet!

Klodiana Spahiu - Zoti kryetar, kemi kërkuar 5 minuta pushim.

Petrit Vasili – Mund të largoheni, nëse nuk doni të vazhdoni!

Klodiana Spahiu - Jo, ne kemi kërkuar si grup 5 minuta pushim.

Grida Shqina Duma – Mund të largohen që të gjithë, ndoshta.

Petrit Vasili – E kemi ndërprerë disa herë. Nuk e përmban Rregullorja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdoni, zonja Duma me pyetjet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rast se nuk doni t'i dëgjoni pyetjet, është tjetër gjë. Vazhdoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është propozim procedural. Nuk ka asnjë pikë të Rregullores, ku parashikohet ky pushim.

Klodiana Spahiu – Është një propozim që e bëj në bazë të Rregullores.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Nxirre Rregulloren dhe më thuaj se ku është parashikuar pushimi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grida Shqina Duma – Unë ju pyes ju dhe nuk pyeta grupin. A jeni në gjendje të vijoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti a je në gjendje të vijosh?

Klodiana Spahiu – Jo, nuk ka lidhje fare me ministren.

Petrit Vasili – Këtu drejtoj unë. Ju jeni thirrur për këtë çështje, nuk jeni thirrur për këtë. Ju jeni thirrur për komisionin.

Mund të vazhdoni, zonja Duma!

Grida Shqina Duma – Edhe ne ju kerkuam mirekuptim per shume degjesa dhe ju nuk e bete.

Petrit Vasili – Nese nuk keni deshire, mund te mos rrini. Ketu keni ardhur per kete pune.

Grida Shqina Duma – Ne ju kerkuam mirekuptim. Ju kerkoni mirekuptim te njehanshem.

Petrit Vasili - Vazhdo me pyetjen zonja Duma!

Ilir Pendavinji – Zoti kryetar, per procedure!

Eshte hedhur nje propozim nga nenkryetarja per 5 minuta pushim, ne menyre qe kjo mbledhje te hyje ne normalitet.

Petrit Vasili - Nuk ka kerkesa per 5 minuta per pushim ne komision.

Ilir Pendavinji – Nuk mund te vazhdojme keshtu. Kerkojme nje pushim per te vendosur per menyren e vazhdimet te kesaj mbledhjeje.

Petrit Vasili - Kjo eshte qesharake.

Klodiana Spahiu – Nuk eshte aspak qesharake dhe ju lutem mos i ofendoni koleget por hidheni ne votim propozimin tone.

(Nderrhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, hidheni ne votim propozimin dhe te vazhdojme proceduren!

Petrit Vasili - Nuk ka gjë për të votuar këtu.

Klodiana Spahiu – Nuk eshte aspak qesharake. Ju lutem mos i ofendoni koleget, por hidheni ne votim propozimin tone! Ne kemi kerkuar 5 minuta pushim.

(Nderrhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, hidheni ne votim dhe vazhdoni me proceduren!

Petrit Vasili - Nuk ka kerkese per pushim ne mbledhje komisioni.

(Nderrhyrje pa mikrofon)

Nese nuk doni te qendroni, s'ka problem.

Klodiana Spahiu – Atëherë, 5 minuta pushim.

(Nderrhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka lidhje fare, por ka lidhje me ndërprerjen e mbledhjes së komisionit bazuar në Rregullore, qe e ben nje pjesë e madhe e numrit të deputetëve.

Ju lutem, hidheni ne votim kerkesen tone!

Petrit Vasili – Nuk ka kerkese per pushim ne mbledhje komisioni. Ato kerkesa duhet te depozitohen me shkrim.

(Nderrhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Zoti Vasili, po të isha e re në komision, mund të ma thoshe këtë gjë.

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, ne bëjmë një kërkesë për ndërprerjen e mbledhjes për 5 minuta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Ule zërin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjesa është hapur dhe mund të vazhdojë edhe pa kuorum, zonjë. Nuk ka problem. Nëse doni ta braktisni, braktiseni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e thotë njeri këtë. Edhe seancat e Kuvendit hapen me kuorum dhe mund të vazhdojnë edhe pa kuorum.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do të bëjmë Rregullore të re, se doni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ashtu siç vazhdon seanca e parlamentit edhe me 7 veta në sallë.

Po të doni, mund të largoheni! Mund të largohen edhe ministrat. Pa problem fare. Nuk ka fare nevojë për kuorum.

Klodiana Spahiu – Jo, ne nuk largohemi, sepse nuk kemi ardhur për t'u larguar.

Petrit Vasili - Po të doni, mund të largoheni! Mund të vini përsëri. Nuk ka asnjë arsye për ndalimin e mbledhjes. Kjo seancë është hapur dhe mund të vazhdojë, ashtu siç vazhdon seanca e parlamentit edhe me 7 veta në sallë.

Vazhdoni, zonja Duma!

Grida Shqina Duma – Pyetja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se kërkesa u miratua dhe dy qytetarët dolën jashtë. Çfarë doni më? A mund të vijoj?

Petrit Vasili – Po, vazhdo, zonja Duma.

Grida Shqina Duma – Pyetja ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Për ta kthyer në normalitet seancën dëgjimore, meqë e nisët me shkelje, po kërkoj 5 minuta pushim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë pushim po e kërkojnë të gjithë deputetët e maxhorancës. Ju lutem, hidheni në votë!

Petrit Vasili – Ne po e vazhdojmë seancën dëgjimore. Ju mund të vijoni me mbledhjen tuaj!

Klodiana Spahiu – Ju nuk mund ta vazhdoni dot seancën dëgjimore, sepse ne kemi kërkuar 5 minuta pushim.

Petrit Vasili – Mund të shkoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Ne e morëm vesh se kush donte ta prishte dhe se çfarë u bë dhe se sa në mënyrë të shëmtuar dhe të trishtë për këtë komision, e bëtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdimisht kanë qenë të ftuar të gjitha grupet e interesit, por ju nuk e njihni Rregulloren dhe mund të thoni çfarë të doni, por duhet të kuptoni, që në komision nuk mund t'i bëjmë dot hile njëri-tjetrit, sepse nuk shkon përpara kjo punë kështu.

Është interesi jonë i përbashkët që kjo punë të zgjidhet.

Petrit Vasili - Ashtu siç dhe fjalën ti për zonjën Metaliaj që do ta bënim dëgjuesën dhe e hëngre fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani të dëgjojmë përralla me moral.

Klodiana Spahiu - Duhet të jemi transparentë të gjithë edhe ju, edhe ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni të drejtë! Kjo është një procedurë parlamentare. 1/3 e opozitës ka të drejtë të kërkojë seancë dëgjimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk po bërtasim, por ata 2 qytetarët nuk mund të vijnë. Këtu vijnë grupet e interesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Xhelilaj – Ju nuk doni dëgjesa pa i bëtë sot, Grida. Doni të bëni vetëm politikë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kishit 3, por kishit 2, sepse i treti ishte përfaqësuesi i partisë, që kishte marrë të zinjte me vete për t'i prurë këtu për të bërë show. Është prishur dëgjesa dhe çudi që kryetari qëndron kaq i qetë dhe thotë se po vazhdon normalisht. Jo, nuk e ka prishur ai.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Moj motër, po ne nuk jemi hunj gardhi këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I sjell këtu dhe pa gjë të keq dhe thua se vazhdon dëgjesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grida Shqina Duma – ... Kjo është e vetmja arsye. A i keni gjërat vetëm në letër apo i keni të konkretizuara në njerëz? Kaq. Nxorët jashtë 2 qytetarë se nuk janë në letër. Kjo ishte prova më e madhe që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Xhelilaj – I nxorëm se na erdhi keq për ata të dy, që i përdorët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Klodi!

Ata mund të jenë hallexhinj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Na erdhi keq se si i përdorët. Ata mund të jenë hallexhinj. Nuk ka më keq sesa trajtimi që u bëtë atyre, Grida.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grida Shqina Duma – Do të bëjmë replikë bashkë apo do të vazhdojmë me ministren?

Roland Xhelilaj - Jo, nuk mund të vazhdosh me ministren, se ne kemi kërkuar pushim për të sqaruar situatën.

Grida Shqina Duma – Dilni jashtë dhe bëni pushim aq sa minuta kërkon!

Petrit Vasili - Mund të dilni dhe të bëni pushim.

Klodiana Spahiu – Jo, të ndërpritet seanca në bazë të Rregullores.

Roland Xhelilaj - Je i detyruar ta ndërpresësh, për mënyrën e trajtimit të mbledhjes, jo për Rregulloren.

Petrit Vasili - Pse, rregullat e tua do të zbatoj unë? Jo, nuk e bëj unë Rregulloren si të doni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të dilni dhe të bëni pushim, nëse nuk doni të rrini!

Klodiana Spahiu – Ne kemi kërkuar të ndërpritet mbledhja. Nuk largohemi. Ne, si grup deputetësh duam të bëjmë një mbledhje të shkurtër.

Petrit Vasili – Mund të shkoni ta bëni pushim.

Klodiana Spahiu – Absolutisht, jo. Ne nuk largohemi. Duke u bazuar në Rregullore, kjo është një procedurë që ndodh edhe në seancat plenare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Pse këtu do ta bëni mbledhjen ju? Nëse doni, shkoni dhe bëjeni mbledhjen e grupit, ku të doni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa problem, mund të shkoni ku të doni ta bëni mbledhjen! Mund të dilni dhe mund të hyni përsëri.

Adelina Rista – Zoti Vasili,

Ne kemi nevojë si grup deputetësh për 5 minuta pushim.

Petrit Vasili - Nëse doni, shkoni dhe bëjeni mbledhjen e grupit ku të doni.

Jo, nuk parashikohet gjëkundi kjo kërkesë.

Adelina Rista – Çdo propozim hidhet në votë.

Ju lutem!

Petrit Vasili - Nuk është propozim ky. Këtu nuk ka fare problem. Ju mund të vazhdoni. Kjo është një seancë dëgjimore që nuk ka nevojë për kuorum dhe ky problem është i zgjidhur. Ne mund të vazhdojmë edhe me 2 veta.

Klotilda Bushka - Zoti Vasili,

Ne jemi të interesuar po aq sa ju të jemi pjesëmarrës në këtë dëgjese me ministren për çështjen e rendit të ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërprisni, se një sqarim do të bëj dhe do ta ezauroj shumë shpejt! Kur filloi mbledhja zonja zëvendëskryetare ju kërkoi me të drejtë listën e të ftuarve. Jo 3 qytetarë, por edhe 3 mijë po të duan dhe po kemi vend, le të vijnë, por rregullat janë të qarta. Duhet lajmëruar të gjithë anëtarët e komisionit se kush do të jenë të pranishëm edhe për të qenë jo vetëm transparentë, por edhe për të qenë të përgatitur për pyetjet dhe për përgjigjet.

Sigurisht, nëse ju sillni 3 qytetarë dhe anëtarët e tjerë të komisionit nuk e dinë, kjo nuk është problem, por është çështje transparence.

Petrit Vasili – Ke ardhur me vonesë.

Klotilda Bushka - Jo, unë erdha kur fillove pikën e rendit të ditës. Mos u kap kot me këto fjalë!

Pra, problemi këtu është, se ju nuk e zbatuat Rregulloren për sa i përket hyrjes së personave, që nuk ishin bërë të njohur për të gjithë anëtarët e komisionit dhe kjo dëgjese është e njëanshme. Edhe një herë ju them, se neve na intereson më shumë sesa ju të jemi pjesë e kësaj dëgjese.

Petrit Vasili – Ju nuk keni interes. Po të kishit interes do ta vazhdonim.

Klotilda Bushka – Ju kërkoj edhe një herë të ndërpritet mbledhja për të bërë 5 minuta pushim, sepse ne duam të pranishëm në këtë dëgjese, por për efekt të shkeljes nga ana juaj të rregullave për sa i takon transparencës për ftesën e njerëzve, që nuk ishin të njoftuar më parë dhe për arsye se ne duhet ta diskutojmë si grup këtë çështje, si dhe duam të jemi pjesë e kësaj dëgjese.

Petrit Vasili – Jeni të lirë të largoheni.

Klotilda Bushka - Ne kemi të drejtën tonë t'ju kërkojmë 5 minuta pushim. Ju jeni të detyruar ta hidhni në votë.

Petrit Vasili – Shko, bëj mbledhje ku të duash! Nuk kam se çfarë të hedh në votë unë. Çfarë do të diskutosh ti?

Klotilda Bushka - Dëgjesa nuk do të bëhet pa prezencën tonë. Ne prandaj do ta kërkojmë, se mund ta kishim lënë mbledhjen dhe ju linim ta vazhdoni.

Petrit Vasili - Ju jeni të lirë të ikni. Nëse nuk doni të rrini. Nuk ju mban njeri me pahir.

Klotilda Bushka - Ju jeni të detyruar ta hidhni në votë. Ne kemi të drejtën tonë të kërkojmë që ju ta hidhni në votim.

Petrit Vasili - Nuk është në asnjë pikë të Rregullores kjo. Cito Rregulloren!

Klotilda Bushka - Përderisa ju ftoni njerëz në dëgjese pa i njoftuar anëtarët e komisionit, përderisa ju veproni këtu sikur jeni në shtëpinë tuaj...

Petrit Vasili – Ohu!

Klotilda Bushka - Kjo është mbledhje pune, nuk është ndonjë takim politik për të ftuar njerëz për miting, as për të bërë sarkazëm me fatkeqësitë e njerëzve...

Petrit Vasili – Podium politik po bën ti. Nuk po bën njeri sarkazëm.

Klotilda Bushka - Kjo është një mbledhje pune. Ju po thoni: mos bëni se bëj unë, por bëni si them unë.

Ju lutem, meqë e shkelët rregullin, bëni që neve të na zbatohet e drejta për pezullimin, për ndërprerjen e kësaj mbledhjeje. Më pas le ta rifillojmë mbledhjen.

Petrit Vasili – Më cito pikën e Rregullores ku bazohet kjo kërkesë për pezullimin e komisioneve parlamentare! Rregullorja nuk ka asnjë pikë. Ju nuk do ta bëni dëgjesën pa ne.

Klotilda Bushka - Ju lutem, hidhni në votë! Në të kundërt, mbledhja do të ndërpritet dhe do ta vazhdojmë më pas. Zbatoni Rregulloren...

Petrit Vasili – Ti nuk ke çfarë të kërkojsh. Lëri këto budallallëqe!

Do të ikësh? S'ka asnjë problem, ik!

Klotilda Bushka - Kjo nuk është zyra e partisë suaj. Kjo është zyra e Kuvendit të Shqipërisë. Ju nuk mund të më thoni mua se çfarë të bëj. Ju e keni shkelur rregullin që në fillim të kësaj seance.

Petrit Vasili – Ja, erdhe ti dhe do të na tregosh rregullat. Rregullorja nuk ka asnjë pikë ku të parashikohet një kërkesë e tillë.

Klodiana Spahiu – Ju lutem edhe një herë, zoti Vasili!

Ju jeni kryetar i komisionit. Ju lutem, mundohuni që të mos i ofendoni kolegët! Edhe një herë ju lutem! Ne kemi kërkuar 5 minuta pushim.

Petrit Vasili – Mos më bëj moral mua ti! Nuk marr leksione morali unë nga ty. Shko, bëja atyre që të dëgjojnë!

Klodiana Spahiu – Ju lutem!

Dakord, mos dëgjoni, por vetëm zbatoni rregullin! Ne kemi kërkuar 5 minuta pushim.

Petrit Vasili – Cila është pika e Rregullores ku bazohet kjo kërkesë? Lexojeni! Nuk ka një pikë të tillë. Ke që qeparë që e ke marrë në dorë Rregulloren.

Klodiana Spahiu – Unë kërkoj ta votojmë në kryesi kërkesën për pezullimin e mbledhjes, sepse keni bërë shkelje ju, si kryetar i komisionit dhe nënkryetari i komisionit. Unë kërkoj të mblidhet urgjentisht kryesia e komisionit për këtë shkelje.

Petrit Vasili – Unë nuk e pezulloj mbledhjen. Është e drejta juaj të bojkotoni mbledhjen.

Klodiana Spahiu – Unë kërkoj pezullimin e mbledhjes për shkak të shkeljes së Rregullores nga ana juaj, si kryetar i komisionit. Kërkoj mbledhjen në mënyrë urgjente të kryesisë së komisionit. Kam të drejtë ta kërkoj këtë për shkak të shkeljes së Rregullores nga ana juaj. Kërkoj edhe një herë urgjentisht pezullimin e mbledhjes dhe mbledhjen e kryesisë së këtij komisioni.

Petrit Vasili - Unë nuk kam bërë asnjë shkelje të Rregullores. Nuk ke se çfarë të kërkosht urgjentisht.

Klodiana Spahiu – Atëherë, e hedhim në votë!

Petrit Vasili – Nuk ke se çfarë të hedhësh në votë. Do të ikësh, ik!

Klodiana Spahiu – Ne nuk ikim, por po kërkojmë 5 minuta pushim për të sqaruar atë situatë të paprecedente që ndodhi këtu.

Petrit Vasili – Nuk ka asnjë situatë.

Klodiana Spahiu – Kemi një situatë për të cilën secili do të mbajë përgjegjësinë e vet. Harrojeni që mund të mbarojë kështu!

Petrit Vasili – Më tmerrove me përgjegjësinë ti mua. Lëri këto! Po më tregon përgjegjësinë ti mua.

Klodiana Spahiu – Ju lutem, përgjigjuni në mënyrë më korrekte!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po si mund të flisni kështu?

Petrit Vasili – Lërimi këto, se nuk janë për mua!

A do të dëgjosh shpjegimin tim....

Klodiana Spahiu – Unë ju thashë që në fillim. Lexoni emrat e të ftuarve....

Petrit Vasili – S’doni të dëgjoni, mos e bëni!

Klodiana Spahiu – Ju lutem!

Ne kemi kërkuar 5 minuta pushim për të diskutuar si deputetë ...

Petrit Vasili – Lexo pikën e Rregullores që ta lejon këtë!

Klodiana Spahiu – Është pika e Rregullores, që i lejon deputetët e një grupi parlamentar për të kërkuar pezullimin e mbledhjes!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Nëse doni të largoheni bëjeni! Ne do të vazhdojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Jo, nuk vazhdon dot mbledhja!

Petrit Vasili – Pse ti i vendos rregullat?

Klodiana Spahiu – Jo, jo, shkathtësi...!

Petrit Vasili – Jo.

Klodiana Spahiu – A e shkelët ju rregullin?

Petrit Vasili – Nëse nuk e ndien të nevojshme të rri, mos rri!

Klodiana Spahiu – Ju e shkelët rregullin që në fillim, duke më ofenduar mua, duke mos lexuar emrat e të ftuarve, sepse e bëtë qëllimisht për të...

Petrit Vasili – Nuk bëra asgjë qëllimisht.

Klodiana Spahiu – E bëtë qëllimisht, vetëm për të fshehur ata njerëz që i kishit futur fshehtazi, duke vënë në siklet edhe punonjësit e parlamentit...

Petrit Vasili – Asnjë njeri nuk ka pasur...

Klodiana Spahiu – ...duke shkaktuar edhe përjashtimin e tyre nga puna.

Petrit Vasili – Në hapjen e...

Klodiana Spahiu – Kjo është shkelje e hapur e Rregullores.

Petrit Vasili – Do ta dëgjosh shpjegimin?

Klodiana Spahiu – Jo, unë shpjegimin tuaj e dëgjova në fillim.

Petrit Vasili – Nuk do të dëgjosh më?

Klodiana Spahiu – Unë ju thashë: “Zoti Vasili, ju lutem, për korrektesë, siç kemi bërë gjithnjë në historinë parlamentare, lexoni emrat e të ftuarve”.

Petrit Vasili – A do të dëgjosh shpjegimin?

Klodiana Spahiu – Ju e mohuat.

Petrit Vasili – Pse ke frikë të dëgjosh?!

Klodiana Spahiu – Kjo gjë është e regjistruar.

Petrit Vasili – Jo, nuk kam mohuar gjë. Ja po ta them shqip.

Klodiana Spahiu – Edhe një herë, kërkoj pezullimin e mbledhjes.

Petrit Vasili – Mirë, mbylleni mbledhjen.

Do mendimin tim? E kërkuat, ja po jua them.

Klodiana Spahiu – Jo, jo, pezullimin e mbledhjes dhe e hedhim në votim.

Petrit Vasili – Kur u hap mbledhja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë do të bësh?

Kur u hap mbledhja...

Klodiana Spahiu – Ju lutem, për procedurë, kërkoj pezullimin e mbledhjes. E hedhim në votim.

Petrit Vasili – Pusho pak, pusho! E morëm vesh tani. E bëre një pyetje, merr një përgjigje.

Kur u hap procedura e mbledhjes në sallë kanë qenë të ftuarit dhe përfaqësuesit e ministrisë.

Me mirëkuptimin e ministres nuk i përmenda të gjithë, por thashë: “me stafin që e shoqëron” dhe në sallë kanë qenë, kamerat i keni, vetëm ministrja me të ftuarit e saj. Ky është fakt. Kështu është hapur mbledhja.

Pikë. Kaq. Në qoftë se kjo nuk është e vërtetë, mbaron.

Kështu që nuk ka pasur gjë për të fshehur. Kaq.

Klodiana Spahiu – Edhe ne, për ta zgjidhur këtë çështje...

Petrit Vasili – Në proces e sipër konstatuam që erdhën. Pati një vërejtje, i nxorëm përjashta. Kaq.

Klodiana Spahiu – Atëherë, si nënkryetare e komisionit, po ju them...

Petrit Vasili – Tani, në qoftë se nuk doni ta vazhdoni dëgjuesën, mbaroi, kjo është e vërteta!

Klodiana Spahiu – Jo, dëgjesa do të vazhdojë përpara, do të sqarohet...

Petrit Vasili – Kjo është e regjistruar, nuk fus dot gjë në xhep unë. Ky është fakt.

Klodiana Spahiu – Kjo që ndodhi nga ne konsiderohet shkelje.

Petrit Vasili – Ti mund ta konsiderosh çfarë të duash, por...

Klodiana Spahiu – Ne kërkojmë pezullimin e mbledhjes.

Petrit Vasili – ... kështu ishte e vërteta.

Klodiana Spahiu – Ne kemi një mbledhje të shkurtër me kolegët deputetë...

Petrit Vasili – Mund të shkosh ta bësh mbledhjen.

Klodiana Spahiu – ...të Partisë Socialiste.

Petrit Vasili – Shko bëje mbledhjen.

Klodiana Spahiu – Jo, do të pezullohet mbledhja e komisionit.

Petrit Vasili – Jo...

Klodiana Spahiu – Është kërkesë që e bëjmë ne dhe ju duhet ta hidhni votë.

Petrit Vasili – Se t'u tek ty të bësh mbledhje dhe të dalim ne nga mbledhja? Jo.

Klodiana Spahiu – Jo, jo, nuk më teket mua.

Petrit Vasili – Jo.

Klodiana Spahiu – Kjo ndodhi si pasojë e shkeljes së Rregullores së njëanshme nga ana juaj.

Petrit Vasili – Jo, e kemi hapur në mënyrë korrekte mbledhjen. Ke kamerat.

Klodiana Spahiu – Jo, nuk është hapur mbledhja në mënyrë korrekte.

Petrit Vasili – Po.

Klodiana Spahiu – Fatmirësisht janë procesverbalet. Ju kam kërkuar të lexohen emrat e të ftuarve.

Petrit Vasili – Po.

Klodiana Spahiu – Nuk ke shanse, sepse këtu, për fat, janë të gjitha kamerat...

Petrit Vasili – Si nuk kam shans? Çfarë shansi nuk kam?! Ç'i ke këto, nuk ke shanse?!

Klodiana Spahiu – Shiko, po nuk keni shans...

Petrit Vasili – Muhabete trotuari!

Klodiana Spahiu – Zoti Vasili, edhe një herë, harrojeni se ju keni të drejtë...

Petrit Vasili – Harrojeni ju.

Klodiana Spahiu – ...të ofendoni dhe të thoni çfarë të doni...

Petrit Vasili – Unë nuk po ofendoj kënd. Ju po më thoni: nuk ke shans. Çfarë shansi nuk kam unë?!

Klodiana Spahiu – ...për anëtarët e komisionit.

Petrit Vasili – Nuk kam bërë asnjëlloj ofendimi, por kam referuar çfarë ka ndodhur.

Klodiana Spahiu – Me shumë korrektesë, bazuar në Rregullore...

Petrit Vasili – Në cilën pikë?

Klodiana Spahiu – ... për arsye të shkeljes së Rregullores nga ana juaj...

Petrit Vasili – Citojeni Rregulloren.

Klodiana Spahiu – ...në mënyrë të njëanshme.

Petrit Vasili – Citojeni pra.

Klodiana Spahiu – Po ju them se kërkoj pezullimin e mbledhjes.

Petrit Vasili – Po pres me durim të lexosh Rregulloren!

Klodiana Spahiu – Po kërkoj pezullimin e mbledhjes...

Petrit Vasili – Citoni Rregulloren. Cila pikë e Rregullores ta lejon?

Klodiana Spahiu – ...së këtij komisioni dhe të diskutojmë ne të katërt se çfarë ka ndodhur, pastaj hajdeni ta hedhim në votim se çfarë do të bëjmë më tutje.

Kjo mbledhje nuk mund të vazhdojë më kështu, sepse ka ndodhur një shkelje e rëndë ligjore...

Petrit Vasili – Po deshe mos rri!

Bardh Spahia – Zonja Spahiu, a mund ta citoni Rregulloren?

Klodiana Spahiu – Nuk mund ta vazhdoni dot ju mbledhjen.

Petrit Vasili – Citoni Rregulloren që të kemi mundësi të ecim përpara.

Bardh Spahia – Zonja Spahiu, citoni Rregulloren në bazë të së cilës ju bëni këtë kërkesë.

(Deputetja Bode ndërhyr pa mikrofon.)

Petrit Vasili – Epo nuk votohet ashtu pa Rregullore, zonja Bode.

Edlira Bode – Jo, jo, bazuar në Rregullore.

Petrit Vasili – Edhe në mjekësi punohet me protokoll, edhe në Shqipëri punohet me rregullore.

Klodiana Spahiu – Zoti Vasili, e dini cila është rregullorja?

Ju jeni parlamentar i vjetër dhe më mirë po bisedoj me ju për ta zgjidhur këtë çështje njëherë e mirë, që të harrohet dhe të mos përsëritet më një gjë e tillë në parlamentin shqiptar.

Unë po ju them se është e paprecedentë. Ju keni më shumë se dhjetë vjet...

Petrit Vasili – Parlamenti shqiptar e voton për një minutë në seancë plenare, i fut ligjet në orën 10 të natës, po më tregon parlamentin shqiptar ti mua?! Lërin këto!

Bardh Spahia – Zonja Spahiu, se tani e tepruat me këto diskutime.

Klodiana Spahiu – Po bisedoj me kryetarin e komisionit.

Për shkak të shkeljes ligjore...

Bardh Spahia – Parlamenti shqiptar ka parë në sallën plenare kriminelë nga më të kërkuarit e Shqipërisë.

(Deputeti Spahia e vazhdon fjalën e tij pa mikrofon.)

Klodiana Spahiu – ... kërkoj pezullimin e mbledhjes.

Bardh Spahia – Në parlamentin shqiptar ju i keni futur kriminelët, drogaxhinjtë, trafikantët...

Në qoftë se për ju qenka e tmerrshme prezenca e dy qytetarëve të thjeshtë aty, që janë hequr nga listat e ndihmës ekonomike, ky është turpi juaj. Nuk e keni ngritur një herë zërin për kriminelët me të cilët keni mbushur sallën atje!

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar i komisionit...

Bardh Spahia – ...i keni pasur në parlament, i keni pasur...

Klodiana Spahiu – Vazhdo ti me ato që thua, mbaji për vete, pasi sot kemi një gjë tjetër!

(Deputeti Spahia flet pa mikrofon.)

Ti do të tregosh arsyen si deputet pse na gënjeve dhe na mashtrove ne, kryesinë e komisionit!

Pastaj do të vazhdojmë mbledhjen.

Bardh Spahia – Ky është skandali juaj! Ky është kundër atij fukarait atje...

Klodiana Spahiu – Zoti Bardhi, nuk të lejon njeri ty të bësh moral me këtë gjë, por dëgjo një sekondë!

(Deputeti Spahia flet pa mikrofon.)

Zoti Bardhi, edhe një herë, ju lutem, zoti kryetar i komisionit, ju kërkoj të mblidhni...

(Deputeti Spahia flet pa mikrofon.)

Bardhi, ti vazhdo, por unë kërkoj të mblidhet kryesia e komisionit!

Bardh Spahia – Kjo është fytyra e vërtetë e...

Klodiana Spahiu – Kërkoj të mblidhet kryesia e komisionit që të vazhdojmë më tutje.

Petrit Vasili – Zonja Shqina, do të vazhdoni me pyetjet?

Adelina Rista – Për procedurë, ju lutem, zoti Vasili.

Grida Shqina – Adelinë, të lutem!

Adelina Rista – Për procedurë, ju lutem, vetëm dy fjalë!

Zoti Vasili, ju lutem, për procedurë.

A mundem ta marr fjalën për procedurë?

Faleminderit!

Ne jemi Komisioni për Punën, Shëndetësinë dhe Çështjet Sociale, jemi një komision ku të gjithë qytetarët sot mbajnë sytë dhe unë sapo pata një telefonatë shpërthyes nga një qytetare në moshë madhore, gati 80 vjeçe, që pyeti: çfarë po bëhet aty te ju? Ne, duke ju parë dhe jemi gati të thyejmë ekranet e televizioneve.

Zoti Vasili, ju jeni kryetar i komisionit dhe drejtimi i kësaj mbledhjeje është përgjegjësia juaj.

Ju lutem, kemi një rend dite, kemi një dëgjuesë. Në momentin që brenda në komision janë anëtarët e komisionit, janë të ftuarit për dëgjuesën. Në momentin që konstatohet se ka të tjerë persona, të cilët nuk janë të autorizuar të hyjnë, është shkelur Rregullorja me të dyja këmbët dhe duhet gjetur përgjegjësia kush e ka shkelur.

Ne nuk jemi kundër dëgjësive të qytetarëve. Sa më tepër të kemi, a ka mundësi të hapen dyert e këtij parlamenti dhe të vijmë, sipas mundësive, t'i dëgjojmë deri tek i fundit për hallet dhe problematikat që kanë? Këtu nuk është han pa porta. Por në momentin kur konstatohet se në sallë kanë hyrë njerëz të paautorizuar, duhet të dalë deri në fund përgjegjësia, deri te punonjësi më i fundit i stafit, si janë futur...

Ju lutem, se nuk ju ndërpreva!

Si janë futur dhe kush i futi?

Të lutem!

Në këtë moment, ne si grup duhet të mbajmë të gjithë qëndrim, prandaj e kërkojmë atë pesëminutësh pushim.

Petrit Vasili – Këtë e diskutuam, zonja Adelina.

Adelina Rista – Ju lutem, zoti Vasili, qëndroni këtu!

Klodiana Spahiu – Si e kemi diskutuar?

(Deputetja Rista vazhdon pa mikrofon.)

Petrit Vasili – Mund të largoheni kur të doni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adelina Rista – Ju lutem, mos më ndërhyini!

Petrit Vasili – Zonja Rista...

Adelina Rista – Kjo foltore nuk është për tribunë politike! Kjo është foltorja e komisionit!

Keni ngatërruar foltoren, doktor Bardhi! Ju lutem!

Bardh Spahia – Po qytetarët kur shohin ata kriminelët...

Adelina Rista – Të lutem, mos e përdor këtë foltore për atë qëllim!

Bardh Spahia – ...nëpër zyrat e shtetit ata trafikantët?

Adelina Rista – Të bëjmë detyrën tonë si parlamentarë këtu!

Lëre, se nuk të shkon kjo pedagogji në komision!

Bardh Spahia – Pse nuk e thyejnë televizorin?!

Adelina Rista – Ke ngatërruar foltoren! Jemi në komision këtu! Të lutem!

Bardh Spahia – Nuk e kam ngatërruar! Kjo është foltorja për qytetarët, pikërisht për ata që ju i nxorët jashtë sot!

Adelina Rista – Mos më ndërprit, se unë nuk të ndërpres! Jam te fjala ime për procedurë!

Bardh Spahia – Kjo foltore është për qytetarët, nuk është foltore politike!

Adelina Rista – Bardhi, do të mësohesh me rregullat parlamentare?

A do të mësohesh me rregullat më elementare të qytetarisë së personit?!

Bardh Spahia – Po.

Adelina Rista – E pra, mos më ndërhyjni kur flas!

Bardh Spahia – Lëreni zonjën të vazhdojë fjalën!

Adelina Rista – Është elementi më qytetar!

Bardh Spahia – E ndërpretë ju e para zonjën!

Adelina Rista – Jo, unë mora fjalën për procedurë!

Bardh Spahia – Ju e ndërpretë e para!

Adelina Rista – Unë nuk fola pa leje! Ma dha fjalën kryetari për procedurë dhe jam te procedura!

Të lutem!

Bardh Spahia – E ndërpretë! Ju e ndërpretë!

Adelina Rista – Jo, unë nuk ndërhyj kurrë pa leje!

Bardh Spahia – E ndërpretë! Ju e ndërpretë!

Adelina Rista – Jo, ma dha kryetari fjalën!

Bardh Spahia – Ju të gjithë!

Adelina Rista – Të lutem, mos fol!

Bardh Spahia – E pra.

Adelina Rista – Mbylleni mikrofonin, pasi kam të drejtën e fjalës!

Bardh Spahia – Ju e ndërpretë!

Adelina Rista – Kur ta mbyllni ju mikrofonin, do ta marr fjalën unë!

Bardh Spahia – E kishte fjalën zonja Shqina, por e ndërpretë ju!

Adelina Rista – Mos më ndërhyjni në fjalën time!

Zoti kryetar, ju ma dhatë të drejtën e fjalës.

Petrit Vasili – E mbaruat fjalën për procedurë.

Adelina Rista – Jo, nuk e kam mbaruar, sepse më ndërhyri zoti Spahia!

Petrit Vasili – Jo, jo, e mbaruat gjerë e gjatë, e morëm vesh!

Adelina Rista – Jeni ju që e drejtoni këtë komision dhe përgjegjësia bie mbi ju për rregullin dhe mbarëvajtjen e punës në këtë komision!

Petrit Vasili – Me tone më të qeta, zonja Rista, se nuk më impresionojnë...

Adelina Rista – Ne, si grup parlamentar, kërkojmë pesë minuta pushim.

Zoti kryetar, zonja përfaqësuese e grupit të Partisë Socialiste ju ka kërkuar, në emrin e grupit tonë, pesë minuta pushim. Hidheni në votë që ky komision të hyjë në...

Bardh Spahia – Mbi ç'bazë e kërkon...?

Klodiana Spahiu – Mbi bazën e shkeljes së Rregullores që bëre ti.

Bardh Spahia – A doni të zbatojmë Rregulloren, se folët për të, mbi ç'bazë?

Klodiana Spahiu – Po ta them unë, Bardhi, mbi bazën e shkeljes së Rregullores.

Bardh Spahia – Cilës Rregullore? Citojeni.

Klodiana Spahiu – Është rast i paprecedentë.

Bardh Spahia – Lexojeni.

Klodiana Spahiu – Po ta them unë, do ta shtojmë si pikë.

Floida Kërpaçi – Zoti kryetar, kërkoj fjalën.

Petrit Vasili – Po.

Floida Kërpaçi – Zonja Spahiu, diskutimet personale vazhdojini më vonë!

Petrit Vasili – Vazhdoni zonja...

Floida Kërpaçi – Ju lutem, se keni folur disa herë, ju vlerësojmë se kërkon fjalën, por na jepni edhe ne mundësinë e kohës sonë!

Bardh Spahia – Ju ndiheni mirë ndërmjet kriminelëve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi – Ju lutem, dua...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua të tërheq...

Roland Xhelilaj – Po, Bardhi, po, nuk pate respekt as për Grida Dumën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I prishe dëgjesën, o Bardh!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi – Zoti kryetar, duhet...

Roland Xhelilaj – Çfarë do të vish? Do të marrësh ndonjë porosi tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kthyet mbledhjen në mbledhje politike, zoti kryetar, ndaj unë propozoj të shtyhet dëgjesa!

Floida Kërpaçi – Ju lutem, a keni respekt ndaj kolegëve për t'i dëgjuar?

Petrit Vasili – Zonja...

Floida Kërpaçi – Jua mbyllët gojën qytetarëve që i larguat nga kjo sallë, doni të na e mbyllni edhe neve?

Petrit Vasili – Ka të drejtë të flasë ajo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka të drejtë të flasë ajo?

Roland Xhelilaj – Kë larguam, moj?

Floida Kërpaçi – Ju lutem, më lejoni që të flas!

Roland Xhelilaj – Kush ishte i ftuar që e larguam?! Kë larguam, moj?!

Floida Kërpaçi – Ju lutem, sepse kam marrë kohën për të folur!

Roland Xhelilaj – Kë larguam, moj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi – Mbani...

Roland Xhelilaj – Mos hyj aty ku nuk je pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Lëre të flasë.

Floida Kërpaçi – Pati një diskutim shumë diskriminues, që, në fakt...

(Deputetja Bode flet pa mikrofon.)

Zonja Bode, e kuptoj që në grupin tuaj parlamentar nuk ka rregulla dhe flet kush të dojë dhe çfarë të dojë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu jemi në zyrën e Kuvendit dhe ju do të na respektoni!

Edlira Bode – Me rregullat e kam shumë mirë, zonjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi – E njihni rregullin që ta lejoni kolegen tuaj për të folur, apo jeni mësuar të mos i njihni rregullat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për qytetarët që po na ndjekin, jemi duke zhvilluar seancën për sa i përket ndihmës ekonomike. Më vjen shumë keq...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga ana e ministres ka një diskriminim...

Klodiana Spahiu – Për shkelje të procedurës, ju kërkoj të pezulloni mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi – A ka mundësi ta mbaroj fjalën, apo...?

Klodiana Spahiu – Zonja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi – ...dhe flisni që të gjithë.

Pati një diskriminim nga zoti Pendavinji, i cili u mbështet më vonë edhe nga zonja ministre, ku u tha: na erdhën në këtë komision... E, mo, çfarë ishin ata, disa qytetarë të Kamzës?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi – Ky është një diskriminim.

Roland Xhelilaj – Pezullojeni mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi – Jo, jo, këtu ka dëshmitarë dhe ju jeni mësuar t'i përdorni qytetarët për të bërë politikë..

Të gjithë qytetarët shqiptarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja ministre...

Ogerta Manastirliu – Ju lutem shumë, zonja Kërpaçi, respektoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni zgjedhur të shfrytëzoni qytetarët, madje sollët këtu dy qytetarë.

(Ministrja Manastirliu dhe deputetja Kërpaçi flasin njëkohësisht.)

Qytetarët duhet të ishin këtu.

Floida Kërpaçi – Mësohuni të respektoni, të dëgjoni...

Ogerta Manastirliu – Por nuk ndërhyj te procedurat e komisionit.

Skema e ndihmës ekonomike është e suksesshme, këtë nuk e them unë, por e thotë Banka Botërore.

Floida Kërpaçi – Nuk keni shkuar t'i shikoni sesi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ogerta Manastirliu – Ka vend për t'u përmirësuar.

Floida Kërpaçi – Mbi njëzetmijë familje nga skema e ndihmës ekonomike.

Petrit Vasili – Zonja Kërpaçi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ogerta Manastirliu – Ata dy qytetarë duhet të ishin këtu. Pse? Sepse nuk e kanë paguar të gjithë procesin e skemës së mbështetjes së mbrojtjes sociale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem shumë, zoti kryetar, pasi më vuri në gojë fjalë dhe veprime, të cilat...

Floida Kërpaçi – ...që kishin disa qytetarë të Kamzës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Floida...

Floida Kërpaçi – Është detyra jonë që të gjithë qytetarët t'i trajtojmë në mënyrë të barabartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Megjithatë, kjo është një sjellje transparente, që tregon se si i trajtoni ju qytetarët, prandaj mbi njëzetmijë familje...

(Diskutime pa mikrofon)

Ogerta Manastirliu – Ju lutem, kini mirësinë të dëgjoni, sepse ju fola në lidhje me skemën.

Floida Kërpaçi – ...për shprehjen diskriminuese të zonjës ministre. Madje ju zonja Bode distancohuni nga ajo shprehje, sepse ne jemi përfaqësues të popullit dhe të gjithë qytetarët shqiptarë janë të barabartë për ne, nuk janë disa të nënës, disa të babës, siç i trajtoni ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atyre të nënës u jepni ndihmë ekonomike, ndërsa këtyre të tjerëve ua hiqni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është e turpshme dhe e pafalshme për ju!

Ogerta Manastirliu – Hajde të flasim me shifra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Me shifra vazhdojmë gjatë debatit.

Fjalën e ka zonja Shqina.

Klodiana Spahiu – Edhe një herë, zoti kryetar, se po bëhemi...

Petrit Vasili – Po, zonja Shqina.

Grida Shqina – Zonja ministre...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Ju lutem, edhe një herë, merrni një vendim tuajin, sepse kjo histori nuk mund të vazhdojë më.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Ka interes më të madh për dëgjesën sesa për këto.

Klodiana Spahiu – Ju lutem, dëgjesa është me shumë interes dhe ne do ta vazhdojmë deri në fund!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Këto janë krejt pa interes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Njerëzit kanë interes të dinë se cilat janë shifrat.

Klodiana Spahiu – Ju lutem, keni shkelur Rregulloren.

Petrit Vasili – Nuk kam shkelur asnjë rregullore.

Klodiana Spahiu – Kam kërkuar urgjentisht mbledhjen e kryesisë së komisionit.

Petrit Vasili – E referova që nuk ka ndodhur asgjë.

Klodiana Spahiu – Nuk mund të vazhdoni më në shkelje të Rregullores.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Vazhdojmë me pyetjet e dëgjesës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Metalia...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë në rregull dhe do ta dëgjojmë nëpërmjet shifrave!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Metalia, zonja Bode, ju lutem!

I diskutojmë shifrat gjatë dëgjesës, nuk kemi pse humbasim kohë me këtë gjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grida Shqina – Zonja ministre, mund të vijojmë?

Pra, pyetja ishte: sa janë në dhjetor...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Grida, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Vazhdoni me dëgjesën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Xhelilaj – Kështu jo!

Petrit Vasili – Vazhdojmë me dëgjesën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Edhe një herë, zoti kryetar, ju kërkoj të mbledhni urgjentisht kryesinë e komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Xhelilaj – Kështu jo!

Klodiana Spahiu – Kjo gjë mbështetet në Rregullore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ju do të mbledhni kryesinë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Ka interes për dëgjuesën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Ju duhet të thërrisni urgjentisht kryesinë e komisionit.

Ilir Pendavinji – Ne kishim mundësi ta bënim para një muaji, kur ju nuk ishit këtu, por e lamë me vetëdije që të ishte edhe opozita.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me kërkesën e ministres të jetë edhe opozita, por jo të bëjë shou. U shty sepse nuk ishit ju. Kur ju ishit me pushime, ne punonim.

Kishim mundësi ta bënim atë muaj që ju pushuat, por me kërkesën e ministres nuk e bëmë, sepse donte që të ishit edhe ju. Nuk mund të vazhdojmë kështu. Nuk mund ta trajtoni ministren kështu ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji -Petrit Vasili qesh kur thuhet se jemi ofenduar dhe pranojmë të flitet vesh më vesh.

Klodiana Spahiu - Nuk mund të vazhdojë mbledhja kështu.

Ilir Pendavinji – zoti kryetar, mos qesh kur flasim! Ti nuk pranon kur bëhet një ndërhyrje nga vendi, madje na tërheq vëmendjen. Ne po themi është prishur zhvillimi i mbledhjes me mënyrën si ka vepruar Bardh Spahia. Ka shkatërruar mbledhjen dhe i ka ndërhyrë deputetes. Ne duam të mbajmë qëndrim.

Petrit Vasili- Zonja Duma, vazhdo me pyetjen. Ka interes për dëgjuesë, këto janë gjëra fiktive, nuk na interesojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji– Nuk kanë interes?

Petrit Vasili– Të shkëmbejmë informacionin, që të dëgjojnë qytetarët. Qytetarët kanë interes për dëgjesat, nuk kanë për këto.

Ilir Pendavinji –Unë i propozoj ministres të tërhiqet, kjo formë mbledhjeje është e dyshimtë dhe skandaloze, me qëllim politik. Bëjini pas datës 18 dhe 20 kur të jeni të qetë shpirtërisht dhe të sillni edhe 2 kriminelë këtu brenda.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu- Zoti kryetar, jeni kryetar komisioni dhe nuk mund të veproni këtu sipas mendjes suaj. Ne zbatojmë Rregulloren. Mbledhja pezullohet për shkelje të Rregullores dhe këtë e hedhim në votim.

Petrit Vasili- Këtë nuk e vendos ti, se nuk je ti Rregullorja.

Klodiana Spahiu- Ju shkelni Rregulloren.

Petrit Vasili- Jo, nuk e kam shkelur Rregulloren, këtë e thua ti.

Klodiana Spahiu- Jo, nuk them unë. Unë jam në kryesinë e komisionit, ku jemi ne të katërt dhe unë propozoj pezullimin e mbledhjes dhe thirrjen e kryesisë së komisionit. Hidheni në votim.

Petrit Vasili- Jo nuk kam pse ta hedh në votim

Klodiana Spahiu- Po hidheni në votim, se ne jemi 4 anëtarë të kryesisë së komisionit, ju jeni 2 kundër, ne jemi 2 pro. Hidheni në votim.

Petrit Vasili-Ministrja ka ardhur për të treguar skemën e ndihmës dhe e falënderuam.

Klodiana Spahiu- Duhet ta kthejmë mbledhjen në normalitet pasi të sqarojmë pse u shkel Rregullorja. Nuk mund të vazhdohet kështu, sepse është një fenomen që mund të përsëritet edhe nga ju, edhe nga ne, kështu që nuk është e drejtë kjo gjë. Këtë seancë që është kaq e rëndësishme nuk duhet ta kthejmë në një zhurmë kaq të madhe. Ne nuk mund ta vazhdojmë, nëse nuk mblidhemi.

Petrit Vasili – Nuk e vendos ti Rregulloren, mund të ndodhë që edhe mund të futen njerëz nga rruga, prandaj kemi Gardën këtu për ta zgjidhur situatën dhe ne vazhdojmë përpara.

Grida Duma-A mund ta marrim fjalën për procedurë edhe ne të tjerët?

Zoti kryetar, e keni dhënë deri tani 20 herë fjalën për procedurë, është e pamundur të mos e ngremë zërin, po përpiqemi pa fund të mos ngremë zërin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Ju lutem, vazhdoni me pyetjen!

Grida Shqina Duma – Unë jam e bindur se të gjithë e duam dëgjuesën. Dëgjuesën nuk e shmangim dot. Opozita e ka kërkuar dëgjuesën dhe normale që me opozitën do të bëhej.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji- Nuk mund të vazhdojë kështu kjo mbledhje, sepse kemi një orë që diskutojmë vetëm për këtë problem. Kjo mbledhje po kthehet prapë pas, nuk e kuptoj.

Grida Shqina Duma- Ilir, po e pengon.

Ilir Pendavinji- Po, patjetër që po e pengoj.

Grida Shqina Duma- Pse po e pengon?

Ilir Pendavinji- Sepse është shkelur Rregullorja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të vazhdojë kështu. Kërkojmë 5 minuta pushim, të marrim një vendim dhe të vijmë përsëri këtu.

Petrit Vasili – Në rregull, shkoni, bëni mbledhje nëse doni.

Grida Shqina Duma – Ju lutem, t’i thërrasim arsyet. Dëgjesa është e rëndësishme, të dyja palët biem dakord për këtë. Kjo dëgjesë duhet të bëhet. Ju doni ta shtyni dy ditë dhe nuk doni ta bëni sot. Unë nuk besoj se i shërben kujt, madje as reputacionit tuaj. Ju doni të bëni diskutime për Rregulloren, dhe për çfarë nuk u bë, por unë mendoj më mirë të bëjmë dëgjesën. Këtu jemi prapë, e bëjmë këtë diskutim pas dëgjesës. Pse duhet ta pengojmë dëgjesën? Ishin dy qytetarë, ju nuk ratë dakord t’i dëgjonit, ne e pamë normale. Patëm dy qasje të ndryshme. Tani qytetarët dolën. Ju jeni duke bërë vetëm zhurmuesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Folët dhe nuk ngritët dorën.

Pra, jemi në kushtet që me muaj po kërkojmë dëgjesën. I drejtohem prapë ministres, ministrja prapë shikon nënkryetaren socialiste për të mos vijuar.

Kërkoj të vijojmë dëgjesën.

Klodiana Spahiu- Po çfarë janë këto që thua, Grida?

Grida Shqina Duma – Atëherë i kërkoj grupit socialist që, gjithashtu, thotë që duhet dëgjesa, të vijojmë me dëgjesën, mos e pengoni mbledhjen. Çdo gjë që nuk shkon mund ta zgjidhim me mënyra procedurale më pas. Ju themi ta ndërpresim tani të mos bëjmë dëgjesën dhe të zgjidhim procedurën. Kjo nuk duhet të ndodhë, sepse ju nuk jeni në kryesim të këtij komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu- Unë jam në kryesinë e komisionit.

Grida Shqina Duma- Ti nuk je në kryesim të komisionit.

Brenda Rregullores parashikohet që kryetari i komisionit të përjashtojë këdo që e bën të pamundur dëgjesën dhe unë ia kërkoj tani. Keni 25 -30 minuta që nuk po e lini të flasë.

Klodiana Spahiu- A mund të të bëj një pyetje? A ishit në dijeni të njerëzve që erdhën pa ftuar?

Grida Shqina Duma- Kur të bëhet procedura do të flas.

Klodiana Spahiu - Kjo duhet bërë përpara.

Grida Shqina Duma- Jo kjo duhet bërë prapa, tani jemi në shërbim të qytetarëve.

Jeni duke reaguar në mënyrë disproporcionale.

Klodiana Spahiu– Kjo është në shërbim të qytetarëve, sepse është në dobi të qytetarëve. Ne kemi kërkuar pezullimin për të shqyrtuar...

Grida Shqina Duma - Nuk e keni këtë të drejtë.

Klodiana Spahiu – Atëherë ne si pjesë e kryesisë kërkojmë pezullim.

Grida Shqina Duma - Nuk keni të drejtë sipas Rregullores.

Klodiana Spahiu - Atëherë ne do ta hedhim në votim këtë gjë.

Grida Shqina Duma- Atëherë ju po bëni zhurmuesin.

Klodiana Spahiu - Për cilin zhurmues e keni fjalën?

Do të vazhdojë patjetër, por ne do të zgjidhim së pari, atë që ka ndodhur.

Duhet të mblidhemi njëherë ne.

Grida Shqina Duma- Zoti kryetar, zonja Duma më përmendi emrin dhe kam të drejtë për të thënë dy fjalë.

Petrit Vasili - Zonja, Bode e ka kërkuar fjalën para jush.

Nuk jemi në seancë plenare këtu për të bërë replika.

Adelina Rista- Ne nuk jemi kundër dëgjësës dhe nuk jemi për të bojkotuar dëgjësën. Nëse do të ishim për të mos bërë dëgjësën, për të mos qenë ju në dëgjësë ne do ta kishim bërë këtë kur ishim vetëm pa ju.

Petrit Vasili- Jo, nuk e bënit dot, sepse nuk erdhi ministrja.

Adelina Rista– Ne ju pritëm ju për të bërë këtë dëgjësë.

Petrit Vasili– Të gjitha i bëni vetë ju, por ka rregulla kjo punë.

Adelina Rista - Tashmë nuk doni që ne ta bëjmë këtë dëgjësë, ju doni që ne ta bojkotojmë këtë dëgjësë, përderisa na thoni të ikim po deshëm. Por ne nuk do të ikim dhe kërkojmë pushim për t'i rikthyer dinjitetin këtij komisioni dhe normalitetin e punës. E thashë edhe një herë këtu nuk është han pa porta, ka rregulla në zhvillimin e punës në komision, prandaj për të rikthyer dinjitetin e komisionit dhe normalitetin e punës ne kërkojmë këtë pushim si grup.

Petrit Vasili – E ka kërkuar fjalën zonja Bode.

Adelina Rista - Ju lutem është hedhur një propozim. Ne kërkojmë pushim dhe jo ta bojkotojmë.

Petrit Vasili – Në votë nuk hidhen gjëra të kota, hidhen gjëra që votohen.

Ky është rregulli juaj, që në Rregullore nuk ekziston.

Edlira Bode - Të gjithë thanë këtu që dëgjesën e duam, duam ta bëjmë ne dhe ju. Pati një shkelje të Rregullores. A duam ta vazhdojmë pas kësaj?

Petrît Vasili - E konstatuat ju që ishte shkelje e Rregullores, por nuk ishte shkelje e Rregullores. Nuk jeni ju që vlerësoni a u shkel Rregullorja, ju vetëvlerësoheni. Rregulloren e vlerësoni ju, vendimin e merrni ju. Nuk është kështu. Ja ku janë kamerat. Mbledhja është hapur në mënyrë korrekte, u futët dy persona dhe dolën përjashta. Mund të futet edhe një gazetar atje i pirë dhe del përjashta. A doni ta bëni? Shumë e thjeshtë.

Edlira Bode - E korrigjoj atë që thashë, është e vërtetë që ne e konstatuam.

Petrît Vasili – Nuk ka pasur në sallë njeri përveç të ftuarve të ministrisë.

Edlira Bode- Në rregull, u shpreha unë gabim, nuk e konstatuat ju, e konstatuam ne.

Petrît Vasili- Po kur e konstatuat ju, sepse seanca u hap krejt normalisht? Ata që u futën, ishin keqkuptuar dhe dolën.

Klodiana Spahiu- Po lëreni të flasë!

Petrît Vasili - Mos fol, se nuk të marr leje ty kur të ndërhyj.

Edlira Bode- Zoti kryetar, a mund ta mbaroj fjalën?

Meqenëse të dyja palët edhe ne edhe ju shprehim interes ta vazhdojmë dëgjesën pse trembeni, ju çfarë ju prish 5 minuta?

Petrît Vasili- Kapricio që nuk kanë lidhje me Rregulloren, nuk kanë vend këtu.

Klodiana Spahiu- Ka shkelje të Rregullores.

Petrît Vasili- Nuk është e vërtetë që ka shkelje të Rregullores.

Klodiana Spahiu - Kam të drejtë unë si nënkryetare e komisionit të bëj propozimin, sepse ju keni shkelur Rregulloren, anëtar i kryesisë ka shkelur Rregulloren. Unë dua të bëj një propozim.

Petrît Vasili- Pse e ke Rregulloren tënde ti?

Klodiana Spahiu - Unë po bëj propozim me lejen tuaj, të pezullohet komisioni.

Petrît Vasili- Pse ku jemi këtu, jemi në parti? Jo, jemi në mbledhje të komisionit.

Bardh Spahia- Kolegë, të maxhorancës, ju lutem, përmbahuni pak me ofendimet. Nuk i shkon një femre kjo!

Të dashur kolegë, edhe ju të maxhorancës unë nuk e kuptoj kë qëndron vështirësia për të vazhduar një seancë normale dëgjese me ministren e Shëndetësisë për një çështje tejet të rëndësishme. Mua më shqetëson fakti, pse që në fillim të kësaj dëgjese sot edhe kur nuk ishin të pranishme mediet të gjitha propozimet që u bënë nga opozita për dëgjesa me ministren e shëndetësisë u hodhën poshtë.

Klodiana Spahiu- Ti ke të drejtën ta bësh dëgjesën.

Bardh Spahia – U hodh poshtë madje edhe kërkesa për të bërë një dëgjese me Ministrinë e Shëndetësisë, me Ministrinë e Arsimit dhe të Rendit për një çështje tejte të rëndësishme sensibël, siç ishte akti i rëndë i ndodhur në qytetin e Kavajës.

Duhet t’ju informoj ju të gjithëve në komision që sot ai akt është përsëritur në mënyrën më makabre në Malësinë e Madhe ku një punonjës i lartë i Policisë së Shtetit ka përsëritur akte dhune përdhunimi me një minorene 15-vjeçare. Sot sapo është bërë publike. Duhet të tregoni përgjegjshmëri! Tendencia juaj është për të fshehur, për të mos u përballur në dëgjesa publike, për të mos kërkuar llogari e informacion ministrive përkatëse, prandaj **dua t’ju...**

Klodiana Spahiu - ...meqenëse nuk e jep do t’ia jap unë...

Bardh Spahia – Po ju bëj thirrje edhe një herë, bëhuni të përgjegjshëm...

Petrit Vasili – Ja ku e ke, mos na pengoni më tej...

Bardh Spahia - se është kjo papërgjegjshmëri juaja që i sjell ato akte të turpshme kriminale...

Petrit Vasili – ...mos na pengoni më tej, sepse po na pengoni qëllimisht...

Klodiana Spahiu - Qëllimisht thua. Dëgjesën?

Petrit Vasili – Po.

Bardh Spahia - .. duhet të tregoni përgjegjshmëri...

Klodiana Spahiu – Edhe një herë...

Bardh Spahia – Në qoftë se ju jeni kundër dëgjesave dhe mundoheni t’i mbuloni ato akte...

Petrit Vasili – Ju doni të largoheni...

Bardh Spahia - ... nuk bëni asnjë gjë tjetër veçse bëheni bashkëfajtorë të atyre persona që ju i keni futur në punë...

(Diskutime pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Ju lutem, zoti Spahia...

Petrit Vasili – Pati një problem, u zgjidh...

Bardh Spahia – ... të atyre personave që ju i keni marrë. Kjo maxhorancë e ka futur në punë edhe inspektorin në 2014-ën, pasi u hoq nga dekriminalizimi është marrë në punë ai zotëria atje...

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar i komisionit, a mundem?

Bardh Spahia - .. nga ju, nga kjo maxhorancë, prandaj dua t’ju them të ngrini zërin për kriminelët dhe jo për ato fakirët që erdhën sot për të marrë pjesë në dëgjese...

Klodiana Spahiu – Zoti Spahia, ju lutem, dua të bëj një propozim konkret!

Bardh Spahia – Ngrijeni zërin kundër kriminelëve, të cilët i keni futur në Policinë e Shtetit, në arsim, në parlament...

Klodiana Spahiu – Zoti Spahia, ju lutem...

(Diskutime pa mikrofon)

Bardh Spahia – Zonjë, është hequr ky dekriminalizimi që sollëm ne, e keni marrë ju në 2014-ën...

(Diskutime pa mikrofon)

Klodiana Spahia – Zoti Spahia, ju lutem...

Ilir Pendavinji – Zoti Spahia, jeni jashtë rendit të ditës...

Bardh Spahiu – Ju donit të dinit pse i kisha komunikimet? I kisha për këtë akt tejet të rëndë që duhet t’ju shqetësojë....

Klodiana Spahiu – Në rregull, ke të drejtën...

Bardh Spahia – Është kjo maxhorancë që e ka hequr...

(Diskutime pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar i komisionit, kam një propozim konkret se çfarë mund të bëjmë!

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Në qoftë se ka qeveri që i ka penalizuar, ata jemi ne. I kemi futur në burg për korrupsion, madje disa ministra dhe ish-ministra janë në ndjekje penale...

Bardh Spahia – Kjo është ajo për të cilën duhet të shqetësoheni ju, jo ata dy fakirët që i keni hequr nga ndihma ekonomike...

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar i komisionit...

Bardh Spahia – Kriminelët me të cilët keni mbushur shtetin...

(Diskutime pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Kisha diçka për procedurë sa i takon vazhdimin të mbledhjes, kam diçka...

Bardh Spahia – Mësojeni, se vlerësimi shumë shpejt do t’ju vijë. Më 16 shkurt dhe do të përballeni me të gjitha këto...

Ilir Pendavinji – E shikon populli...

Bardh Spahia – Vlerësimi po ju vjen zotërinj...

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo është maxhoranca e përdhunuesve, e kriminelëve, e trafikantëve...

Klodiana Spahiu – Ju lutem, për procedurë, zoti kryetar!

Bardhi, të lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Petrit Vasili – Po, zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu - Për ta kthyer seancën në normalitet, meqenëse Rregullorja e Kuvendit nuk e ka një rast të tillë, sepse është i paprecedentë dhe ne duam ta zhvillojmë mbledhjen, sepse thamë se është në interesin e të dyja palëve dhe të të gjithë shqiptarëve, ju lutem, të mos humbim kohë dhe t'i bëjmë një kërkesë Këshillit të Legjislacionit. A mundet që Drejtoria Juridike...?

Petrit Vasili – Çfarë t'i bësh Këshillit të Legjislacionit?

Klodiana Spahiu – Patjetër! A mundet...

(Diskutime pa mikrofon)

Bardh Spahia – Ku jemi këtu, jemi në parlament apo ku jemi?

(Diskutime pa mikrofon)

Thoni dy fjalë për përdhunuesit që i keni futur atje...

(Diskutime pa mikrofon)

... jo po dilni kundër kur është seancë dëgjimore për aktin e Kavajës apo për aktin tjetër që ka ndodhur sot në Malësinë e Madhe...

Adelina Rista – Boll bëre teatër këtu në komision, sepse nuk kanë nevojë ata për teatrin tënd...

Bardh Spahia – Ngelët duke folur për dy qytetarë të thjeshtë aty...

Klodiana Spahiu – A mund ta kthejmë mbledhjen në normalitet?

Petrit Vasili – Vazhdojmë me dëgjesën...

Bardh Spahia – Nuk dimë me kë flasim, flasim me mbrojtës kriminelësh apo me çfarë flasim...

Petrit Vasili – Në normalitet është, vazhdojmë me dëgjesën dhe hyjmë në një normalitet shumë të mirë...

Klodiana Spahiu – Nuk është në normalitet, zoti Vasili, megjithatë, meqenëse komisioni drejtohet nga opozita, ju vazhdoni dhe e lini të lirë, në këtë rrjedhje të tillë, prandaj po ju them...

Petrit Vasili – Jo, debati ishte i kryqëzuar, nuk ishte vetëm i jashtëm. Duke vazhduar me dëgjesën ne shkojmë drejt normalizimit...

Klodiana Spahiu - ...Rregullorja nuk e parashikon këtë pikë që diskutuam ne...

Petrit Vasili – Unë jua thashë se nuk e parashikon këtë gjë, por ju këmbëngulët dhe keni 2 orë që na e humbni kohën kot, prandaj ju thashë ta vazhdojmë mbledhjen normalisht.

Klodiana Spahiu – A kemi përfaqësues nga Drejtoria Juridike e Parlamentit...?

Petrit Vasili – Jo, nuk e kam thirrur...

Klodiana Spahiu – A mundet, ju lutem, t'i marrim një opinion këshilltarit ligjor ose drejtoreshës juridike...?

Petrit Vasili – Jo, nuk kam nevojë për asnjë opinion...

Klodiana Spahiu - ... për një rast të tillë që është i paprecedent?

Petrit Vasili – Mbarojmë dëgjuesën, pastaj me dëshirën tuaj mund të vazhdojmë më tutje...

Klodiana Spahiu - Dëgjesa në momentin që...

Edlira Bode - ... në Rregullore, e kishit menduar deri në detaje...

Petrit Vasili – Unë jua thashë që në fillim se nuk ka parashikim në Rregullore, por është kështu siç ju them unë. Pra, çdo rezervë që do të keni e verifikojmë më pas.

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar, edhe një herë...

Petrit Vasili – Siç edhe jua thashë, për çdo rezervë që keni do të veprojmë më pas...

Klodiana Spahiu - .. ne jemi të interesuar që seanca të zhvillohet dhe të mos humbim kohë në zhvillimin e seancës...

Petrit Vasili – Nuk drejton administrata e Kuvendit këtu, drejtoj unë...

Klodiana Spahiu – Ju nuk drejtoni dot i vetëm, zoti kryetar...

Petrit Vasili – Absolutisht jo, në bazë të Rregullores...

Klodiana Spahiu - ... pavarësisht se jeni kryetar i komisionit...

Petrit Vasili – Në bazë të Rregullores dhe ti nuk ke fitim, koha mbaroi...

Klodiana Spahiu – Në bazë të Rregullores ju drejtoni me kryesinë e komisionit...

Petrit Vasili – E ke bërë mirë këtë rol, deri tani e ke bërë shkëlqyeshëm. Lëre se tani kjo nuk funksionon më...

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar, kjo punë do të zgjidhet para se të fillojë seanca, e keni gabim. Ne do të rrimë këtu deri sa ta zgjidhim...

Petrit Vasili – Në rregull, sa të doni!

Klodiana Spahiu – Ne si maxhorancë kërkojmë, meqenëse Rregullorja nuk e ka një interpretim të tillë...

Petrit Vasili – Interpretimet e Rregullores nuk bëhen gjatë...

Klodiana Spahiu - ... kërkojmë nga ana juridike...

Petrit Vasili – A do të pushosh të dëgjosh apo jo? Gjithë kjo logore e madhe...

Klodiana Spahiu – Ju lutem, asnjë propozim tonin...

Petrit Vasili - Jo, Rregullorja nuk interpretohet gjatë komisionit...

Klodiana Spahiu – Kush ka logore e vërtetojnë të tjerët këtë, sepse nuk ka kuptim të ofendoni kaq hapur...

Petrit Vasili – Mirë e kam unë, flas unë më shumë dhe ti më pak...

Klodiana Spahiu – Mundohuni të mos ofendoni kolegët se po bëni një gabim..

Petrit Vasili – Në rregull, unë jam llafazan, ti nuk flet...

Klodiana Spahiu - ...shumë të madh. Unë dua vetëm të zbatohet Rregullorja...

Petrit Vasili – Ta mbarojmë pra...

Klodiana Spahiu – Hajde t’u marrim një opinion njerëzve që merren me këtë punë...

Petrit Vasili – Jo, nuk marr fare opinione unë, absolutisht jo, për interpretimet për një çështje të caktuar. Ju lutem, zonjave të administratës, mbledhja e komisionit vazhdon. Kur të mbarojë mbledhja, flasim për çdo gjë. Unë, kur nuk kam pasur dakordësi, i jam edhe drejtuar Kryetarit të Kuvendit me letra e me të gjitha, i kam stabilizuar gjërat dhe kam pranuar të gjitha vendimet që janë marrë. Unë nuk bëj standard të veçantë për ju për gjëra që nuk ia kam lejuar vetes....

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar, kjo nuk mund të bëhet në fund të mbledhjes së komisionit, sepse është kjo është procedura e fillimit të komisionit, është pika e parë e seancës dëgjimore ...

Petrit Vasili – Ka filluar në mënyrë shumë korrekte, pa asnjë diskutim. Normaliteti minimal është që të ecim në rrugën e dëgjësës, së cilës iu krijua një pengesë e madhe pa asnjë kuptim, e pabazuar në Rregullore...

Klodiana Spahiu – Ju doni ta përdorni politikisht...

Petrit Vasili – Unë nuk dua të përdor asgjë...

Klodiana Spahiu – E përdorët politikisht dhe bëtë atë që deshët...

Klodiana Spahiu – Bardhi, të lutem, pusho!

Petrit Vasili – Seanca filloi shumë në rregull dhe ju më pas filluat...

(Diskutime pa mikrofon)

Pati një problem, dolëm përjashta, ishte një shkëmbim opinionesh midis ministres dhe zonjës Duma...

Klodiana Spahiu – Se si ishte seanca, për fat të mirë janë mediet dhe procesverbalet që e vërtetojnë këtë gjë. Që ju e shkelët këtë punë dhe shkelët Rregulloren...

Petrit Vasili – Nuk kam shkelur, e thua ti këtë...

Klodiana Spahiu – Kjo ishte mëse e qartë...

Petrit Vasili – Nuk të kanë vënë ty të vendosësh...

Klodiana Spahiu - ... dhe doni ta shfrytëzoni politikisht, është puna juaj...

Petrit Vasili – Absolutisht, vetëm zhurma ka ardhur këtej. Unë thashë që zonja Duma të vazhdojë me pyetjet...

Klodiana Spahiu – Ne duam ta kthejmë në normalitet dhe të vazhdojë seanca dëgjimore. Ju jeni kundër çdo propozimi, jeni kundër për të bërë 5 minuta pushim...

(Diskutime pa mikrofon)

Petrit Vasili – Ju votuat kundër për 4 propozimet që u bënë...

Klodiana Spahiu – Ju keni të drejtë të bëni çdo seancë dëgjimore që është në interes të deputetëve...

Bardh Spahia – Ju e nisët me votimin kundër....

Petrit Vasili – Seancën tjetër që do të bëjmë me këta njerëz, e hëngre një seancë dhe mbetesh në rekord, prandaj mos u shqetësoni...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju bindëm! Ti kishe të drejtën tënde me Rregullore...

Klodiana Spahiu – Unë mbetem në rekord...

Petrit Vasili – Ju kishit të drejtën tuaj dhe nuk i ndjetë fare, dakord, pavarësisht se u mor përsipër...

Klodiana Spahiu – Ju nuk pranoni se kjo është e paprecedent dhe nuk doni një mendim nga instancat që e gjykojnë këtë punë...

Petrit Vasili – Cilat instanca?

Klodiana Spahiu – Këshilli i Legjislacionit, Drejtoria Juridike për të marrë një vendim...

Bardh Spahia – E vendos Rregullorja këtë gjë, për çfarë instancash flisni?

Petrit Vasili – Një gjë që nuk parashikohet në Rregullore do të vijë të ma japë mua stafi i Kuvendit?

Klodiana Spahiu – Po kush do t’jua japë, zoti kryetar?

Petrit Vasili – Jo, moj zonjë. Do të vijë një nëpunës dhe të më thotë mua: kështu është Rregullorja, megjithëse nuk shkruhet...

Klodiana Spahiu – Në qoftë se ju mbledhjen e ardhshme...

Petrit Vasili – Jo, interpretimet nuk i bën asnjë, absolutisht...

Klodiana Spahiu - ... bëni diçka totalisht në shkelje të ligjit dhe të Rregullores, atëherë çfarë do të bëjmë ne?

Bardh Spahia – Zonja Spahiu, ti trego pse votuat kundër kësaj dëgjese...

Klodiana Spahiu – Zoti Spahia, ju keni të drejtë të bëni çdo dëgjese, është e drejta juaj...

Grida Shqina Duma – A ka mundësi ta mbarojmë dëgjesën me ministren? Boll Klodi, a ka mundësi? Duam të mbarojmë dëgjesën me ministren, kaq po kërkojmë?

Klodian Spahiu – A ishte ti në dijeni të kësaj gjëje që do të ndodhte, sinqerisht?

Grida Shqina Duma – Unë po ju them që këto pyetje dhe çdo gjë që keni për procedurë bëjini pas mbledhjes, ne këtu jemi për dëgjesën...

Klodian Spahiu – A ishte në dijeni të kësaj gjëje që do të ndodhte?

Grida Shqina Duma – Po sillini, pa asnjë problem...

(Diskutime pa mikrofon)

Petrit Vasili – Grida, vazhdo me pyetjet.

Grida Shqina Duma – E lamë te numri total i përfituesve...

Ilir Pendavinji – Pastaj i bie që këto 2 orë paskemi diskutuar kot, zonja Duma.

Zoti kryetar, dua ta kthesh pak vëmendjen këtej, 5 minuta pushim...

Petrit Vasili – Zoti Pendavinji, nuk ka asnjë referencë në Rregullore dhe unë do të rri të bëj interpretime të Rregullores tani...

(Diskutime pa mikrofon)

U pa që nuk ka asnjë keqkuptim, kështu që vazhdojmë me dëgjesën.

(Diskutime pa mikrofon)

Punë e madhe, kjo i shërbeu sqarimit të një situate...

Klodian Spahiu – Çfarë sqaruam ne?

Petrit Vasili – Fillove prapë tani?

Klodian Spahiu – E gjithë kryesia të mungon...

Petrit Vasili – Si kryesia mungon...

Grida Shqina Duma – Duam të bëhet dëgjesa, o njerëz...

Petrit Vasili – Grida, të lutem, vazhdo dhe mos iu refero asnjë komenti.

Grida Shqina Duma – Pyetja ishte se sa është numri i total i aplikantëve dhe i përfituesve...

Ilir Pendavinji – Ministrja të tha që nuk të përgjigjem dot për këtë pjesën...

Petrit Vasili – Po lëre se përgjigjet vetë ministrja...

Grida Shqina Duma – Po përgjigjesh ti?

Ilir Pendavinji – Jo, nuk përgjigjem unë, po vetë ministrja...

Petrit Vasili – Po lëreni të përgjigjet vetë ose mund të mos japë përgjigje është e drejta e saj.

Grida Shqina Duma - ...dhe ju thatë në dhjetor 60052. Unë ju kërkoj numrin e përfituesve për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Sa është numri total i përfituesve?

Edlira Bode – Janë dyfishuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Grida Shqina Duma – Zonja Bode, pyetja është për ministren...

Petrit Vasili – Duhet të kthejë përgjigje ministrja jo ti...

Grida Shqina Duma – Sa është numri total?

Ogerta Manastirliu – E para, për të bërë një krahasimore numrash duhet të kuptojmë skemën dhe...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo pra, duhet kuptuar skema...

Petrit Vasili – Zonja ministre, më falni, zonja Dume, mos ndërhy!

Vazhdoni me përgjigjen.

Ogerta Manastirliu – Unë do të them përgjigjen time...

Petrit Vasili – Po, keni të drejtë të vazhdoni me përgjigjen.

Ogerta Manastirliu – Faleminderit!

Atëherë, numri i familjeve përfituese në dhjetor 2018, pa përfshirë këtu gjithë skemën, subvencionin që u jepet bashkive prej 6%, që është transfertë e kushtëzuar dhe nga e cila, gjithashtu, përfitojnë familjet, ka qenë në dhjetor të 2018-ës për 60052 familje. Pyetja që ju shtroni nuk gjen terren krahasimor. Pse? Sepse në janar të 2018-ës ne e shtrimë skemën e re të ndihmës ekonomike në gjithë Shqipërinë, ndërkohë që pilotimi filloi në 2014-ën në tre qarqe. Të krahasosh 2017-ën me 2018-ën nuk ka bazë krahasimore, pasi një skemë tjetër ka qenë në 2017-ën dhe aplikohet një formulë tjetër, po kështu një formulë tjetër aplikohet në 2018-ën.

Grida Shqina Duma – Mbaruat?

Ogerta Manastirliu – Po.

Petrit Vasili – Më falni, kjo ishte pyetja e parë...

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Ministre, a keni ndonjë sqarim tjetër në lidhje me këtë pyetje?

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull.

Grida Shqina Duma – Mund ta vijoj si logjikë, meqenëse e kam kërkuar fjalën.

Petrit Vasili – Do të vazhdoni me pyetje?

Grida Shqina Duma – Po pyetje-përgjigje, me këtë logjikë jam.

Unë nuk ju pyeta nëse ka bazë krahasimore apo jo, por po ju pyes se sa janë familjet që kanë përfituar ndihmë ekonomike ndër vite. Kaq ishte pyetja ime. Pastaj sa i takon pjesës se si

bëhet baza krahasimore, kjo është për t'u diskutuar. Kam tri herë që ju bëj po të njëjtën pyetje dhe nuk po më jepni shifra.

Pavarësisht se cila është skema, është kjo apo një tjetër, ne jemi këtu për të realizuar atë që familjet në nevojë të marrin ndihmë dhe nuk jemi këtu për të justifikuar krahasimet. Në fund, si rezultante e kësaj do të jetë nëse familjet në nevojë e marrin ose jo ndihmën ekonomike të merituar nga taksapaguesit shqiptarë. Ne nuk jemi për të diskutuar a bëhet dot krahasim apo jo, e vetmja gjë që kemi si shqetësim është nëse e marrin apo nuk e marrin. Kjo është logjika që kemi si shqetësim sot, nëse kjo skemë mundëson që ndihma ekonomike të shkojë atje ku duhet dhe të plotësojë nevojat e familjeve në nevojë. Për këtë arsye ju pyes: sa janë shifrat në vite? Sepse, shifrat në vite na tregojnë varfërinë në familjet shqiptare; shifrat në vite na tregojnë a e kemi ne të mbuluar varfërinë me ndihmë ekonomike apo jo. Shifrat në vite na tregojnë nëse kemi probleme me skemën apo jo, nëse duhet ta përmirësojmë apo nuk duhet ta përmirësojmë, nëse kjo skema e re në raport me atë që ka qenë më përpara ka nevojë për përmirësime apo nuk ka nevojë, siç e thotë edhe Banka Botërore.

Unë sërish po rikthehem te shifrat në vite, buxheti në vite dhe për këtë kam edhe pyetjen tjetër. Ju këshilloj që ju ta dëgjoni dhe ta merrni shënim. A është rritur buxheti në katër vitet e fundit? E para.

E dyta, nga vitit 2012 e deri më sot e keni indeksuar me varfërinë skemën e ndihmës ekonomike dhe diskutimi deri në këto momente, prandaj pres përgjigjen tuaj, është: për cilën arsye ka ulje të numrit të përfituesve për sa kohë nuk ka ulje të familjeve të varfra në varfëri absolute?

Pyetja përfundimtare e këtij blloku pyetjesh është: sa është numri total i familjeve në nevojë, pavarësisht se sa keni ju buxhet? Pra, ju keni një buxhet prej 20-milionësh, pak a shumë, kaq keni alokuar. A e dini ju që ka familje të tjera në nevojë? Si shpërndahet ky 20-milionësh?

Petrit Vasili – Zonja Ministre, ju lutem!

Ogerta Manastirliu – Për pyetjen nëse është rritur apo jo buxheti i ndihmës ekonomike këto vite është rritur. 3.7 miliardë lekë ka qenë buxheti i ndihmës ekonomike në vitin 2013, 4.7 miliardë lekë është buxheti për vitin 2018, po kaq do të jetë edhe për vitin 2019.

Buxheti është rritur ndërkohë që skema është përmirësuar, pasi skema e re e ndihmës ekonomike ka hequr njëherë e mirë ndihmën e pjesshme. Unë besoj se më mirë se vet ju, e kuptojnë qytetarët në çfarë ishte kthyer skema e ndihmës ekonomike, në një skemë lëmoshe, ku familje të tëra mbaheshin me 8 deri 10 mijë lekë të vjetër në muaj. Numri i familjeve që dikur merrnin ndihmë ekonomike ishte abuziv në respekt me kriteret dhe kushtet e parashikuara, jo sepse ato mund të mos kishin nevoja për t'u mbështetur me programe të tjera

të mbrojtjes sociale, absolutisht po, por skema e re që ne aplikuam në 12 qarqe, na tregoi që këto familje, të cilat përfitonin në mënyrë abuzive, ishin ata që kishin shtëpi 3-katëshe, 2-3 makina dhe të ardhura të paverifikueshme nga administratorët socialë të bashkive. Këshillat bashkiakë, në tejkalim dhe në shkelje ligjore, jepnin ndihma të pjesshme dhe numri i familjeve shkonte 90 mijë. Ndërkohë, çfarë bëri skema e re? Ajo për herë të parë vendosi një sistem unik pikëzimi pra, e para, që të gjitha familjet të trajtoheshin njësoj në kushte të barabarta, duke vendosur gjithashtu prioritet në zonat rurale. Të dhënat na tregojnë që sot kemi një mbështetje shumë më të madhe të familjeve që jetojnë në zonat rurale dhe që kanë nevojë për të përfutur ndihmën ekonomike. Sot skema e ndihmës ekonomike njëherë e përgjithmonë ka hequr ndihmën pjesore dhe është rritur masa e ndihmës ekonomike mesatare duke u dyfishuar nga 3400 lekë në 5400 lekë. A është e mjaftueshme kjo? Sigurisht, jemi duke punuar për të përmirësuar skemën e ndihmës ekonomike, sepse mbështetja për qytetarët është jo vetëm në para, por duhet alternuar gjithashtu edhe me shërbime sociale në territor edhe me pagesa të tjera. Politika e re që kemi përfshirë për bonusin e bebes, do të ndihmojë gjithashtu edhe fëmijët të cilët lindin pikërisht nga familjet në nevojë me bonusin për fëmijën e parë, të dytë dhe të tretë.

Gjithashtu, vijon t'u jepet mbështetja për kompensimin e energjisë elektrike, mbështetja për mosbraktisjen e shkollës, mbështetja për ndjekjen e kalendarit të vaksinimit dhe gjithë politikat e tjera lehtësuese të qeverisë për mbështetjen e familjeve në nevojë.

Dua t'i kthehem pyetjes që ngritët me shumë të drejtë: a kërkon kjo skemë përmirësim të vazhdueshëm? Po, patjetër që kërkon përmirësim të vazhdueshëm, por së pari, kërkon konsolidim, që të gjithë ne ta kuptojmë dhe të bëjmë të mundur që publikisht kjo skemë të kuptohet nga përfituesit, aplikuesit pranë skemës ekonomike. Shpeshherë, qytetarët aplikojnë në skemën e vjetër ku nuk verifikoheshin *on line* të gjitha dokumentacionet e tyre dhe nuk deklaronin të vërtetën. Kjo është një skemë, e cila verifikon në mënyrë automatike në 6 sisteme, nga mbrojtja civile te regjistrimi i automjeteve, te tatim-taksat, pra, nëse ti nuk thua të vërtetën kur aplikon për ndihmë ekonomike, sistemi të kap në deklaram të rremë. Janë 20 mijë anëtarë familjesh që kanë aplikuar, të cilët kanë bërë deklaram të rremë, dhe duke qenë se sistemi është një sistem i ftohtë, në qoftë se rezulton që ke makinë, ke të ardhura të mjaftueshme, që deklaron në tatim-taksa punësimin, në qoftë se ti jeton në një shtëpi 3-katëshe, ti nuk mund ta përfutosh këtë ndihmë, ndërkohë që ka familje të tjera që janë në vështirësi.

A ka sot njerëz, të cilët mund të mos e përfutojnë ndihmën ekonomike për arsye të pengesave, burokracive apo edhe të mospërfshirjes së administratorëve socialë në këtë proces, që duhet të jetë procesi më serioz që bën një administrator social në bashki? Patjetër që mund

të ketë, ndaj edhe ne kemi ndërtuar një proces dhe mekanizëm transparent për të gjitha ankesat, për t'i verifikuar një më një. Nga aplikimi ndihmës deri tani janë bërë me mijëra verifikime, edhe për ata të cilët kanë deklaruar se nuk e marrin ndihmën ekonomike, për të verifikuar statusin social të tyre, statusin ekonomik dhe për t'i përfshirë në skemë, por nuk duhet të harrojmë diçka, ne nuk ia kemi hequr askujt mundësinë për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike, edhe kur sistemi mund të mos e nxjerrë përfitues, sepse fondi që ne u alokojmë bashkive, është një fond që duhet shfrytëzuar nga bashkitë, pikërisht për të përfshirë këta njerëz, të cilët mund të jenë në nevojë emergjente për ta përfituar këtë ndihmë. Nuk duhet abuzuar me këtë pikë. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur ngremë një çështje kaq sensitive, e cila prek qytetarët në nevojë, sepse kjo skemë nuk mund të jetë më një skemë lëmoshe, që jepej për 100 mijë qytetarë me një vlerë prej 8 mijë lekësh. E cila familje mund ta mbajë frymën gjallë me këto të ardhura?

Do të merremi me numrat, zonja Duma, apo do të merremi me efektin që ka prodhuar skema e re? Do të merremi me numrat e vitit 2013? Ne nuk po krahasohemi, por ejani të merremi me sa përfitojnë familjet në raport me aplikuesit.

Skema e re një gjë të mirë e ka bërë, ka dekurajuar abuzivët dhe ata që përfitonin në kurriz të atyre që kishin më shumë nevojë, se kur shkonte ai te sporteli dhe shihte komshinë e vet që ka vilë 3-katëshe dhe vet nuk merrte asgjë, çfarë mund të mendonte për sistemin që e kishit ju në dorë, se ju filluat të bënit një reformë, por e latë në letër. Reformat janë të vështira. Ne përballemi me sfida në implementimin e kësaj reforme çdo ditë.

Ata njerëz, si dy zotërinjtë që erdhën sot, të cilët mund të kenë problematika në aplikim (varet tërësisht nga administratorët e bashkive, por ne kemi siguruar një mekanizëm ankesash), pa dyshim, kanë të drejtë që të vijnë edhe në parlament, se parlamenti i njerëzve është, nuk është i kukullave, por e rëndësishme është që këta njerëz të trajtohen me seriozitet. Ne jemi seriozë kur i trajtojmë dhe nuk i takojmë njerëzit një herë në vit, kur na duhet të ngremë një çështje, për histori të çështjes e për ta bërë këtu *show-n* e radhës, por çdo rast e trajtojmë me seriozitet maksimal, me përkushtim, me përgjegjësi, dhe nëse ka abuzivitet në trajtimin e rasteve nga administratorët shoqërorë, siç ka qenë një rast që doli në media, që sot është për ndjekje penale nga shërbimi social shtetëror, nga administratorët e Kamzës, nëse nuk gabo, atëherë ata do të përgjigjen para ligjit për një të drejtë të mohuar familjeve, të cilët kanë të drejtën e tyre për të përfituar ndihmën ekonomike. Duhet të jemi seriozë kur t'i trajtojmë ata, se këto nuk janë çështje numrash, por çështje jete, të mbështetjes që shteti u garanton atyre që kanë nevojë.

Unë nuk dua t'i shmangem pyetjes, jua thashë edhe më parë, mund të jenë mbështetur edhe 200 mijë familje, por në çfarë vlere është bërë kjo, me 8 mijë lekë të vjetra thjesht për ta mbajtur në skemë e për të thënë që unë mbështes numra. Jo, ne mbështesim jetë, duam të sigurojmë mirëqenie. A jemi ne të kënaqur me masën e ndihmës ekonomike sot edhe pse e kemi dyfishuar? Jo, ne do të vijojmë ta përmirësojmë skemën e ndihmës, siç do të vijojmë gjithashtu të rrisim buxhetin. Por çdo gjë ka kohën e vetë, jo kohën e pambarimtë, sepse na kanë mandatuar njerëzit për të qeverisur dhe do të vijojmë ta bëjmë këtë me përgjegjësi të madhe, pa lënë borxhe e gropa, sipas gjithë normave më të mira dhe me përgjegjësi maksimale për ta.

Sa i përket pyetjes nëse ka ulje të numrit të përfituesve, përgjigja ime është: ka rritje të masës së ndihmës ekonomike për familjet; ka mbështetje me kompensime dhe subvencione për familjet. Numrat janë shumë të rëndësishëm kur flasim për statistika, por programet e mbrojtjes sociale maten si me numra, me efekte sociale dhe ekonomike që këto familje do të kenë një status më të përmirësuar brenda vendit a rrethit a njësisë administrative ku jetojnë, apo jo. Pa dyshim, sot ndihma ekonomike u shkon atyre që kanë më shumë nevojë. Ka nevojë për përmirësim, për riverifikime, sepse mund të ketë edhe të tjerë, të cilët e përfitojnë në mënyrë të pamerituar. Duke bërë verifikimet me Shërbimin Social Shtetëror ne jemi duke krehur të gjithë listën dhe kemi ngritur mekanizma, të cilët garantojnë që çdo ankesë të trajtohet me përparësi dhe t'i jepet e drejta çdo qytetari.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Do t'ju lutesha të bëni pyetje dhe komente të shkurtra.

Fjala për ju, zonja Duma.

Grida Shqina Duma – Zonja Ministre, së pari, shifra që dhatë është e gabuar dhe duhet të jeni më e përgatitur kur vini këtu. Nuk është rreth 3,7 miliardë, ndoshta jua kanë dhënë bashkë me PAK-un. 20 miliardë e keni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për çfarë shifrash?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk merrem me ty, por merrem me këto që keni në dokumente. Të dish dhe të mos dish, janë këtu!

Petrit Vasili - Ju lutem, zonja Ministre...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, a e kam mirëkuptimin tuaj? Do t'ju lutesha të mos ndërhyini në fjalën e njërit-tjetrit.

Grida Shqina Duma –Janë të dyja shkresa, dhe ndaj ju them që shifrën e keni të gabuar, që vijnë nga institucioni juaj, nga INSTAT-i dhe nga KLSH-ja. 20 milionë dollarë apo 20 miliardë. Ndaloni, se nuk ju ndërhyra!

3,7 miliardë nuk e keni vetëm për ndihmën sociale, se keni përfshirë edhe PAK-un, paaftësinë e kufizuar. Përtej kësaj gjëje..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë do të bëni ta jepni dorëheqjen.

Petrit Vasili - Zonjë, unë përpiqem të mbaj rregull, mos ndërhyuni, ju lutem!

Vazhdoni, zonja Duma, tek thelbi i çështjes.

Grida Shqina Duma – Ju thoni skema e vjetër, skema e re. Në vitin 2017 numri i përfituesve ka qenë 79491 familje, kohë në të cilën skema e re aplikohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra në tri qarqe, se edhe në qarqet e tjera që nuk keni lëvizje, keni po të njëjtën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe kur nuk është, keni përsëri lëvizje me 10 mijë familje.

Në qoftë se do të vazhdoni të mohoni shifrat, nuk jeni këtu për dëgjuesë. Nga viti 2017 deri në vitin 2018 jeni 79 me 60 mijë. Dakord? 79 mijë me 60 mijë. Gjithsesi referuar shifrave tuaja, ju thoni se nuk është kaq diferenca. Ju thoni: 18730 familje aplikuan për herë të parë, nga të cilët 14 mijë përfituan. Kjo do të thotë që në numrin tuaj të familjeve duhet të zbrisni këtë 14 mijëshen për të kuptuar diferencën. Por në fakt ju keni nxjerrë nga skema 42 mijë familje, sepse 14 mijë i keni futur rishtazi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra sistemi, për këtë sistem po flasim dhe për aplikimin.

Skema e re dhe reforma, nuk ka rëndësi nëse ka nisur në kohën e Partisë Demokratike apo jo, ka nisur që në vitin 2012 në draftim me Bankën Botërore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kanë nisur përpara kësaj qeverisjeje. Këtë e dini, sepse jeni specialiste.

Diskutimi që kemi sot, është nëse aplikimi i skemës është bërë mirë apo keq.

Ju keni një “thembër Akili”, për të cilën sido që t’i rrotullojmë shifrat nuk diskutohet që nga skema kanë dalë 40 e ca mijë familje në të gjithë Shqipërinë. Për këtë ju thoni se keni hequr një pjesë të madhe të familjeve që janë me ndihmë pjesore, pra me atë 8 mijë lekëshin e vjetër. Por gjëja që ju nuk doni me qëllim ta theksoni është që maksimalja e ndihmës është po aq sa ka qenë, 80 mijë lekë të vjetra dhe ju nuk e keni ngritur. E vetmja gjë që keni bërë ju është që keni hequr ndihmën pjesore. Ju nuk keni lëvizur as masën mesatare, sepse e keni

pasur 12 mijë lekë për moshën e tretë, 14 mijë lekë të vjetra për kryefamiljarë dhe 8 mijë lekë të vjetra për individ, pra nuk ka ndryshuar fare. Kjo duhet të ishte gjëja e parë që duhet të kishit bërë dhe këtë e keni në auditin e KLSH-së që nuk e keni indeksuar fare me indeksin e varfërisë qoftë dhe me një përqindje. 80 mijë lekë të vjetër ka qenë maksimumi në skemën e vjetër, po atë e keni edhe sot. Të njëjtin buxhet e keni pjesëtuar me 80 mijë lekëshin dhe patjetër që do t'ju dalin më pak familje, sepse kjo është e thjeshtë.

Por përveç faktit që nuk e rrisni buxhetin, diskutimi i madh është se përse fshihni pikëzimin e kriterëve? Ju thoni që sot do të çojmë përpara përgjegjësisë ata që keqpërdorin skemën, por diskutimi këtu është se ju keni 56 kriterë, ndër të cilat askush nuk e di se cili është koeficienti i pikëzimit të këtyre kriterëve dhe këtu është “thembra e Akilit”.

Ju thoni që keni hequr ndihmën pjesore, por ky është një diskutim që e kemi bërë në përpara jush, që duhet hequr ndihma pjesore. Pra, për ta kuptuar më qartë qytetarët, sepse ju e dini dhe e bëni me qëllim këtë, duke e mbajtur skemën e fshehtë, ju mjafton të ndryshoni një pikëzim brenda skemës tuaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju mjaftoni të ndryshoni një pikëzim, sepse i keni pa kontroll...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Zonja Duma, ju lutem përfundoni!

Grida Shqina Duma – Po si të përfundoj?

Petrit Vasili – Zonja Bode, unë nuk i vura kufizim ministres derisa shteroi përgjigjja.

Grida Shqina Duma – Në faqen 6 të auditit të KLSH-së është e shkruar qartë: “Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale të propozojë plotësimin e VKM-së me numër kaq dhe më tej për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, duke bërë transparente formulën e unifikuar të pikëzimit që përcakton përfituesit e ndihmës ekonomike”. Këtë nuk e keni bërë dhe nuk do ta bëni, sepse doni ta përdorni në mënyrë abuzive nga kompjuterët qendrorë dhe kjo nuk ka pikën e dyshimit. Nga Fletorja Zyrtare keni hequr pikëzimin dhe keni lënë vetëm kriteret. Sot në Fletoren Zyrtare nuk paraqitet se sa është pikëkoeficienti i çdo kriteri të varfërisë.

Një nga kriteret që keni vendosur thotë: “tualet jashtë dhe jo jashtë”, sa pikë ka ky tualeti? Keni vendosur “kuzhinë e ndarë apo e pandarë”, nga ta dijë qytetari se çfarë formuloni dhe pse keni vendosur “kuzhinë e ndarë dhe e pandarë”? Sepse qytetari ka të drejtën e informimit për të drejtën e tij zonjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush e bën verifikimin? Administratori është një punonjës i shtetit, i punësuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por që të mbajë përgjegjësi, duhet të kontrollohet nga dikush. Ai nuk mund të kontrollohet nga ai që ka bërë skemën, por duhet të kontrollohet nga ata që bëjnë *check and balance*, nga ata që nuk kanë mundësi ta përdorin skemën, pra duhet të kontrollohet edhe nga ky grup parlamentar edhe nga një komision parlamentar, sepse këtë po ju kërkojmë.

Gjëja e fundit që dua të bëj është të merrem me emra personal, por në faqen e fundit të auditit thuhet: “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të analizojë dhe të fillojë procedurën për masë disiplinore, ndaj sekretarit të përgjithshëm Arian Kraja, drejtoreshës së Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit dhe Programeve të Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes, Denada Seferi, për mosbashkëpunim dhe për mosdhënie informacioni grupit të auditit në lidhje me formulën e unifikuar të pikëzimit dhe drejtorit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm për mosdhënie informacioni më lidhje me raportet e auditimit”. Përse e citoj këtë pjesë, sepse vijoj t’ju them që e vetmja arsye që shpjegon përse nuk e jepni formulën e pikëzimit dhe e mbani të fshehtë në kundërshtim me ligjin është keqpërdorimi i saj.

Ju thoni: është qytetar i Kamzës, i Pezës apo i Petrelës? Është qytetar i Shqipërisë, është shtetas shqiptar. Unë ju përmend me emër dhe mbiemër personat që nuk kanë përfituar, por ju keni arsye krejtësisht banale, nuk gjejnë zyrën ku të aplikojnë. Po, nuk gjejnë zyrën ku të aplikojnë. Për shembull, Edison Ibrahim Ukdashi nuk e gjen dot zyrën e punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t’ju jap emrat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju i keni përzemër, ne i kemi përzemër, këtu nuk flasim për zemër, këtu flasim për detyrime

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju kujtoj që keni marrë 56 milionë euro nga Banka Botërore, e cila është asistencë teknike dhe mundësim infrastrukturor që skema të punojë. Ndër to keni edhe 11 milionëshin që do ta merrni kredi për riintegrimin, për të cilin mund t’ju pyesim.

Së pari, për kontratën dhe vijueshmërinë e projektit të Bankës Botërore, katër muaj përpara ju kam kërkuar transparencë të vijueshmërisë së projektit dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje nga ana juaj, pra as nga specialistët dhe as nga ju.

Së dyti, ju jam drejtuar me disa shkresa, ku kam kërkuar pikëzimin që të kuptoj se si e matni kriterin e varfërisë.

Sigurisht që minimumi jetik për shqiptarët, duket luks në këtë moment që ua ka nxjerrë përsëri auditi, por ju keni nxjerrë nga skema 40 e ca mijë familje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë ju them se është e vërtetë, sepse vjen nga diferenca në vite.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra me shifra, sepse për ato po flasim, për shifra dhe për buxhete.

Ju keni këtë përlllogaritje, në raportin tuaj thoni që 3% pak a shumë, keni matur dhe monitoruar skemën në 365...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk flas për ty, meqenëse t'i e di, por flas për qytetarët. Se çfarë di ti, po e shikoj si rezultat me 40 mijë familje të hequra nga skema.

Mos më thuaj mua se unë di, sepse atë çfarë di ti, unë e di.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deputete – Të lutem, Grida, nuk mund të lëmë të flasësh kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le nam ti Bardhi me ato që nxore nga goja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grida Shqina Duma – Unë ju jap një targetgrup në një njësi vendore, ku keni rreth 10 %, të cilët nuk gjejnë zyrën e punës të ndryshuar për të aplikuar, me gjithë ato milionat e Bankës Botërore.

Pra, nëse ju keni audituar dhe keni monitoruar 350 njësi, nga të cilat nga një targetgrup prej 8000 vetash keni vërtetuar që 275 ka qenë marshi i gabimit dhe me një matematikë të thjeshtë ju bie 3% që është marshi i gabimit me ato që keni deklaruar ju...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe atë e keni deklaruar gabim? Dakord, edhe këtë e keni deklaruar gabim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra jam e saktë, se ministrja nuk e di.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vijomë, në raportin që ka dalë nga auditimi ku thuhet që 4% është masa totale e riintegritetit të familjeve në nevojë, që pak a shumë nëse bëni 3% e gabimit dhe 4% e riintegritetit, i bie që duhet të kishin dalë nga skema 5600 familje. Duke përjashtuar pjesoren, përse ju dalin nga skema 42 mijë familje? Pyetja normale është: a është reduktuar varfëria e tejskajshme?

Këtu ju citoj Bankën Botërore e cila thotë: “Megjithëse rritja ekonomike shënon 1 pikë përqindje, rritja në shtresën më të varfër të shoqërisë nuk është shpërndarë fare dhe mbetet e ngurtë”. Pra indikatorët e varfërisë nuk kanë ndryshuar, në shtresën më të varfër të shoqërisë

nuk kemi shpërndarje të mirëqenies, ju nuk e rrisni masën 80 mijë lekë në muaj pavarësisht inflacionit, pra nuk rrisni asgjë nga masa mesatare dhe e shisni si sukses. Numri i familjeve ulet me 42 mijë, ndërkohë që marshi i riintegritetit dhe marshi i gabimit ju del 7%, ku maksimalisht mund të ishte 5500 apo 6000 dhe sot jemi në situatën ku thoni se jemi eficient.

Përsëri ju them, përse e mbani të fshehtë skemën e pikëzimit? Ju e kuptoni që do të jeni përballë një përgjegjësie shumë të madhe, sepse kjo skemë pikëzimi mund të përdoret dhe ka të gjitha gjasat që do të përdoret për fushatë elektorale, mes kafshatës dhe votës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë përse nuk e publikoni pikëzimin?

Petrit Vasili – Zonja Ministre, e keni fjalën.

Ogerta Manastirliu – Meqenëse zonja Duma përmendi Bankën Botërore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit, i cili në çdo inspektim dhe kontroll që bën, bën detyrën e tij për të bërë rekomandimet përkatëse në lidhje me përmirësimin, sidomos kur është një kontroll performace, siç ishte ai i bërë për skemën e ndihmës ekonomike.

Për sa i përket masave që kontrolli ka rekomanduar, dua t'ju informoj që nuk mbyllet aty procesi, por ka edhe një korrespondencë, të cilën ju nuk e keni, mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ministrisë, në përcjellje të një përgjigje të Bankës Botërore në lidhje me formulën e unifikuar të pikëzimit.

Unë e shpjgova dhe në fund, por dua t'ju bëj me dije që ne kemi përgjegjësinë maksimale për të gjithë nivelin e transparencës në raport me formulën e unifikuar. Kjo formulë është hartuar në mbështetje dhe me ekspertizë periodike të ekspertëve të Bankës Botërore, pra në asnjë moment nuk kemi operuar të vetëm pa konsulencën e tyre.

Duke u kthyer te komentet e Bankës Botërore dhe te statusi i implementimit të projektit, dua t'ju them që në janar të këtij viti, pas gjithë shtrirjes së skemës në të gjithë Shqipërinë, pas rezultateve verifikimeve dhe pas të gjitha proceseve që janë kryer përgjatë një viti në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me të gjithë hapat e ndërmarra, që nga modulet e krijuara për verifikimin e ankesave, për monitorimin e skemës, te strategjitë e riskut dhe të gjithë elementët e tjera, Banka Botërore ka theksuar dhe ka përcaktuar që kjo reformë ka pasur një progres sinjifikativ. Ajo ka vendosur disbursimin e 11,2 milionë eurove për qeverinë shqiptare, pasi të 5 indikatorët, të cilët ishin indikator kyq për sa i përket implementimit të kësaj reforme, të përcaktuar në fillim të bërjes së këtij projekti, janë arritur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Shërbimi Social Shtetëror, duke e

vendosur në plan të parë si një projekt, i cili ka arritur qëllimin e tij. Çfarë ka bërë? Ka targetuar më mirë dhe më shumë ata që janë në nevojë, këtu flasim për nevoja ekstreme. Kemi të optimizuar sistemin elektronik në më shumë se 90% të njësive bashkiake, ata janë 100%, por këtu po citoj indikatorin e vendosur nga Banka Botërore, janë verifikuar 80% e pjesëmarrësve përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, pra janë arritur të gjithë indikatorët që janë nënshkruar me Bankën Botërore duke disbursuar kështu 11,2 milionë euro. Po flasim për Bankën botërore, jo për ndonjë shoqatë që na i ka dhënë këto arritje rezultatesh pa bërë punën. Banka Botërore është institucioni më serioz, duke e shkruar të zezë mbi të bardhë dhe të publikuar që kjo reformë ka një progres sinjifikativ, i cili është arritur nëpërmjet përmbushjes së të gjithë indikatorëve të vendosur.

Sërish, për sa i përket Kontrollit të Lartë të Shtetit, është dhënë dhe është theksuar arsyeja e formulës dhe e koeficienteve në formulë. Absolutisht që formula është transparente, sepse është pjesë e VKM-së. Koeficientët për ekspertët...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pasi Banka Botërore të japë dakordësinë për ndarjen e formulës së unifikuar të degëzimit, patjetër që mund ta merrni, por ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që ne i kemi, por Banka Botërore ka shkruar që kjo formulë nuk është për publike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më vjen keq!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta jap, patjetër, pasi të mbaroj, sepse unë po flas me fakte. I kam këtu letrat të firmosura.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, për qytetarët aplikohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po them çfarë thotë Banka Botërore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Përgjigjja i është kthyer Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Petrit Vasili – Një minutë, zonja Ministre, të më falësh!

Zonja Duma, ju lutem, mos ndërhyjni!

Nëse jemi të kënaqur apo pa të pakënaqur nga përgjigjet, është një problem tjetër.

Zonja Ministre, fjala për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E përfunduat?

Ogerta Manastirliu - Po.

Petrit Vasili – Faleminderit!

Zonja Bode, urdhëroni!

Edlira Bode – Faleminderit, kryetar!

Unë, për komisionin dhe për publikun, pasi ministrja dhe stafi i saj i kanë gjërat e ditura, do të jap shifra që lidhen me ecurinë e ndihmës ekonomike në Bashkinë e Devollit.

Aktualisht, në muajin janar të vitit 2019, janë 788 qytetarë aplikues për ndihmë ekonomike dhe 728 janë fitues. Nga këta, 51 aplikues janë te 6%-shi, fondi i bashkive, ku kanë fituar mbi 40 veta. Pse është e rëndësishme? Meqenëse po flasim për shifra dhe patjetër që shifrat janë të rëndësishme, në dhjetor të vitit 2017 kanë qenë jo më shumë se 400 veta që merrnin ndihmë ekonomike. Brenda vitit kemi dyfishimin e personave që trajtohen me ndihmë ekonomike, përveç dyfishimit të vlerës së ndihmës ekonomike që përmendi ministrja. Vetëm në njësinë Miras ishin 150 persona që përfitonin ndihmë ekonomike dhe tani janë gati 400.

Dua të them edhe një fakt tjetër të rëndësishëm, që një pjesë e mirë e personave dhe familjeve kanë dalë nga skema ekonomike, sepse janë punësuar. Kjo skemë ka funksionuar në mënyrë të tillë, që ka nxitur edhe punësimin. Madje, për të gjithë qarkun e Korçës, brenda vitit 2018, nga janari në dhjetor, janë 328 të punësuar. Pra, janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike, sepse janë integruar në skemën e punësimit.

Unë nuk kam vërejtje apo probleme me skemën e ndihmës ekonomike, por përderisa ministrja thotë që ka vend për përmirësime, jam e bindur se do të ndodhin.

Kam falënderime për të gjithë banorët e Bashkisë Devoll, që as nuk e merrnin mundimin të aplikonin më parë dhe aplikimet ishin shumë më pak, por në saj të ecurisë së skemës, kanë filluar të marrin kurajë të aplikojnë dhe muaj pas muaji, edhe numri i përfituesve, është rritur, është dyfishuar brenda një viti.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Bode!

Zonja Ministre, unë kam vetëm një pyetje.

Sistemi i ri i pikëzimit sigurisht që është një mundësi e re për të zhvilluar edhe skemën, edhe për të pasur kriterë më të shëndetshme, por bashkëjetesa e kësaj skeme edhe me një grup tjetër, i cili trajtohet nga pushteti lokal, ka një problem, i cili është problem edhe logjik, edhe parimor. Skema nuk mund të ... Në parim, nga ana praktike dikush, me të drejtë, mund të thotë se për shkak të problemeve të skemës ne kemi gjetur një mënyrë për të amortizuar problemin,

por ekzistenca ... Nuk dua të them se janë dy sisteme paralele, sepse është shumë për ta thënë, por nuk mundet dhe kjo duhet të ishte drejt një minimizimi, sepse një nga elementet e para që skema ka pasur si gjetje, që nuk e bënin të shkonte përpara, ishte niveli i trajtimit në pushtetin lokal, abuzivizmi e të tjera, të cilat bënë që t'i futemi kësaj rruge. Por, në rast se ne jo vetëm e mbajmë, por edhe e inkurajojmë që fondi i pushtetit lokal të jetë më i lartë, që ata, të cilët nuk përfitojnë, të futen në një mënyrë tjetër, pa diskutim që metodikisht ka një dekonsolidim të një sistemi të caktuar, që është edhe shkencor, nëse doni ta quajmë, sepse i tillë është, kështu ka arritur.

Pyetja ime është: si mendoni, për sa kohë mund të vazhdojë ky paralelizëm? Në vend të ketë një fond më të pakët, pse është dyfishuar fondi? Skema ka ende tronditjet e veta, që kërkon të ketë një amortizator, apo çfarë ndodh? Në teori, fondi duhet të ishte zero. Fondi nuk synon ngjarjet e veçanta të një varfërie të improvizuar të çastit, skemës i duhet kohë për ta zgjedhur. Cili është opinionimi juaj në kohë të gjatë se si shkohet me këtë gjë?

Ogerta Manastirliu - Kur është bërë ky vlerësim me ekspertët e bankës, duke qenë se ishte një skemë që nuk aplikohet për herë të parë vetëm në Shqipëri, por një ekspertizë e ngjashme iu është ofruar edhe vendeve si Gjeorgjia, Turqia dhe vendeve të tjera ku ne jemi mbështetur me ekspertizën e bankës për të aplikuar këtë formulë të unifikuar të pikëzimit për familjet në nevojë, është rekomanduar nga ekspertët e Bankës Botërore, në mënyrë që të kishte sa më pak efekte sociale, duke qenë se shtrirja e një formule të re në të gjithë vendin do të kishte një impakt social, pasi të gjitha familjet ishin mësuar prej vitesh me një skemë që përfshinte në këtë mbështetje edhe familje që janë në pragun e varfërisë, edhe familje që janë në varfëri të thellë. Atëherë, çfarë vendosëm? Vendosëm që përpos sistemit elektronik, që është një sistem i ftohtë dhe i paanshëm, pra nuk merr asnjë lloj emocioni kur përlllogarit, vlerësohet që ka edhe gabime njerëzore, për shembull, administratorë socialë që nuk plotësojnë mirë deklaratimet, qytetarë që mund të vendosen përpara thënies po ose jo në një pyetje që është brenda në formularë dhe thonë një gënjeshtër, por që janë me të vërtetë në problematikë sociale apo ekonomike, me ekspertët e Bankës Botërore u vendos të rritej masa e mbulimit për bashkitë, e cila vjen sërish si fond nga buxheti i shtetit, pra 4.7 miliardë që janë të destinuara për skemën e ndihmës ekonomike, përfshirë edhe 6% që u jepet bashkive, duke vendosur bashkitë disa kritere, të cilat lehtësojnë përfshirjen në mbështetjen e ndihmës ekonomike edhe për familjet që nuk janë vlerësuar nga sistemi i pikëzimit. Kjo është quajtur si një masë mbrojtëse, që skema të ketë sa më shumë mbulim. Masa mbrojtëse është rritur për të pasur sa më pak të përjashtuar, të cilët mund të kenë nevoja emergjente për t'u mbështetur nëpërmjet

mbështetjes kesh, pavarësisht mbështetjes me shërbime sociale që garanton programi i mbrojtjes sociale.

Ne do të vijojmë të punojmë me Bankën Botërore deri në vitin 2021.

E para, sepse në parlament është ratifikuar financimi shtesë prej 11 milionë eurosh për reformën që do të bëjmë për të gjithë pagesat e aftësisë së kufizuar, reformë që do të kërkojë shumë impenjim politik, por mbi të gjitha njerëzorë, për të vendosur një sistem të ri të vlerësimit biopsikosocial për aftësinë e kufizuar. Por paralelisht ky vit do të jetë viti i strategjisë së daljes nga ndihma ekonomike. Brenda kësaj strategjie, që përsëri financohet si asistencë teknike nga Banka Botërore, ne do të kemi në vlerësim edhe këtë sistem të 6%-shit në aspekte të formalizimit të mëtejshëm të këtij sistemi dhe për përfshirjen brenda sistemit elektronik. Por ishte shumë i nevojshëm, pikërisht për të pasur jastëkun e nevojshëm për qytetarët që mund ta kishin plotësuar gabim apo administratorët mund të mos ishin korrektë, e të tjera, që të kishim mundësi që t'i trajtonim me mbështetje nga bllokskema që ne alokojmë për bashkitë. Strategjia që do të kemi gati deri në muajin tetor të këtij viti do të na japë edhe një vlerësim të qartë të formalizimit të 6%-shit për ta futur në sistem, por, nga ana tjetër, duke i vendosur edhe bashkitë, gjithashtu, në një përgjegjësi më të madhe për të shtuar edhe ato nga fondet e tyre për të ngritur shërbime sociale në territor, por edhe për të krijuar mundësi, xhepa ekonomike, për të mbështetur familjet në nevojë sociale.

Petrit Vasili – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Xhembulla.

Almira Xhembulla – Faleminderit, kryetar!

Së pari, e vlerësoj shumë pozitivisht faktin që sot jemi në këtë dëgjese! Megjithatë, më vjen keq që në fillim të mbledhjes së komisionit u përdorën disa instrumente jo korrekte dhe, në njëfarë mënyre, pati një çoroditje edhe të punës tonë, duke ditur që ministrja është shumë e përgatitur dhe ne si përfaqësues qarqesh, që vijmë me shqetësimet tona, ishim të interesuar për të pasur një diskutim shumë frutdhënës.

Dua të ndaj me ju shqetësimin që kemi edhe ne si përfaqësues qarqesh. Konkretisht unë përfaqësoj Dibrën, për fat, ndoshta jo të mirë, është një nga qarqet, i cili përfiton më shumë nga ndihma ekonomike. Në fillimin e implementimit të skemës së re hasëm shumë vështirësi dhe ne ishim jashtëzakonisht shumë të interesuar për ta ndjekur në kontakte të vazhdueshme me ministrinë duke qenë që në fillimin e implementimit në muajin janar të vitit 2018, numri i përfituesve ra ndjeshëm edhe për shkak të mosqartësisë të atyre që aplikonin, por ndoshta edhe nga mungesa e informacionit të administratorëve.

Përtej asaj që ky argument vazhdon të përdoret politikisht, unë them se nga puna e mirë, nga trajnimi dhe nga koordinimi shumë i mirë i të gjitha strukturave, nga niveli i njësive administrative, deri në nivelin e ministrisë është punuar mirë, por edhe ne vetë e kemi ndjekur duke qenë se jemi të interesuar që, çdo njeri, i cili ka nevojë për këtë ndihmë ekonomike, ta marrë, dhe të gjitha familjet në nevojë, dhe, siç është edhe fokusi, të targetohen më të varfrit.

Duke qenë se shpesh është përdorur politikisht dhe është thënë se është përgjysmuar numri, unë dua të sjell në vëmendje që muajt e fundit, dhjetor të vitit 2018, Bashkia Dibrë ka një numër me rreth 5222 përfitues të ndihmës ekonomike, Mati ka 1580, Klosi 1380, Bulqiza 1225. Në total janë 9375 përfitues të ndihmës ekonomike. Në krahasim, është një numër 300-400 më i vogël se në fillim të implementimit të skemës, por dua të sjell në vëmendje se edhe 6%-shi që alokohet nga njësitë e qeverisjes vendore për këtë gjë mundohet të trajtojë diferencën e këtij numri.

Dua të mos bëjmë politikë me këtë gjë, sepse besoj se të gjithë jemi të interesuar që të gjithë ata që kanë nevojë, ta marrin këtë ndihmë ekonomike. Nëse krahasohemi me muajin janar të vitit 2018 me sot, shifrat kanë qenë shumë progresive.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petrit Vasili – Po i kërkoja zotit Spahia të mos iu shqetësonte.

Almira Xhembulla - Ne kemi qenë të gjithë njësoj të ndjeshëm ndaj kësaj gjëje, sepse qytetarët që e kanë të nevojshme dhe jetike këtë ndihmë, duhet ta marrin, prandaj dua ta theksoj se këto ishin shifrat e përditësuara për dhjetorin e vitit 2018.

Edhe njëherë, ndoshta ministrja mund të na japë informacion për mënyrën si kemi ecur me koordinimin e rasteve që kanë dalë nga skema, se si koordinohet me zyrën e punës, a ka një përqindje për këtë për qarkun e Dibrës.

Për sa i përket punës që është bërë, unë do të doja t'i falënderoja, ndonjëherë edhe mund t'i kemi shqetësuar, sidomos në muajt janar, shkurt dhe mars, kur u bënë interpelanca, debate dhe diskutime, por të gjitha janë bërë në favor të qytetarëve, të cilët sot besoj se shumica prej tyre kanë marrë shërbimin, këtë të drejtë që ne ua kemi dhënë me skemën e re të ndihmës ekonomike.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Xhembulla!

A ka ndonjë plotësim zonjë Ministre?

Ogerta Manastirliu – Faleminderit!

Unë e thashë edhe më parë se çfarë ishte strategjia e daljes nga skema e ndihmës ekonomike, duke qenë se reforma i ka përcaktuar grupet dhe familjet, që kanë anëtarë në moshë

për punë, dhe, pikërisht te këta anëtarë duhet të fokusohet puna jonë në raport me punësimin dhe me aftësimin profesional.

Skema e ndihmës ekonomike parashikon ato familje me anëtarë në moshë madhore pune, sipas një afati 5-vjeçar, përjashtoj këtu të gjitha familjet të cilat kanë anëtarë jo në moshë pune dhe kanë problematika të tjera shëndetësore, të cilat do të jenë në skemë edhe pas këtij afati. Ajo çfarë ka filluar në muajin janar dhe po vijon edhe sot është që Shërbimi Kombëtar i Punësimit së bashku me Shërbimin Social Shtetëror kanë një qasje pozitive për sa i përket punësimit të anëtarëve të familjeve me ndihmë ekonomike, të cilët janë në moshë madhore pune, si dhe për sa i përket aftësimit dhe kurseve të formimit profesional. Thjesht për informacionin tuaj: janë 4266 qytetarë, anëtarë të familjeve me ndihmë ekonomike, të cilët kanë dalë jopërfitues në skemën e aplikuar. Këtyre njerëzve u është ofruar dhe sot kanë një punësim të qëndrueshëm, ashtu sikurse janë edhe 681 anëtarë të familjeve, të cilët kanë qenë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike apo janë refuzuar nga sistemi elektronik, duke u parë si mundësi për t'u aftësuar profesionalisht nëpërmjet kurseve të aftësimit profesional.

Meqenëse më pyetët për qarkun e Dibrës, mund t'ju them se janë 160 persona, të cilët janë punësuar nga janari deri në nëntor, sepse shifrat e dhjetorit nuk i kam ende për sa i përket bashkëpunimit në raport me ata që kanë mundësi për t'u punësuar. Këta persona kanë qenë përfitues të ndihmës ekonomike apo janë përfitues të ndihmës, por duhet të dalin nga skema nëpërmjet punësimit të qëndrueshëm.

Petrit Vasili – Zonja Ministre, para se të flasë zonja Kërpaçi, unë dua t'ju bëj vetëm një pyetje: sa është numri total i atyre që marrin ndihmë ekonomike në sajë të 6%-shit të ofruar nga pushtetit lokal?

Ogerta Manastirliu – Atëherë, po ju jap dy shifra, jo se janë në rënie, por sepse kanë një logjikë. Në muajin mars, në kohën kur skema ende po konsolidohej, kanë qenë 4484 persona, kurse në dhjetor numri ka shkuar në 3608 persona me 6%-shin e ofruar nga njësitë bashkiake. Kjo rënie e numrit ka ardhur, për shkak se është rritur numri i përfitueseve nga skema e sistemit.

Petrit Vasili – Po, zonja Kërpaçi.

Floida Kërpaçi - Përshëndetje, zonjë Ministre!

Në fakt, nëse do të kishim bërë një vlerësim të ndikimeve të skemës së re të ndihmës ekonomike që në momentin kur u pilotua, në fakt, kemi pasur edhe një debat shumë të madh për këtë reformë, ndoshta sot do të kishim parandaluar disa të vërteta apo këtë situatë që është krijuar për mijëra familje në të gjithë Shqipërinë.

Ne kemi dy fakte: së pari, janë larguar mbi 25 mijë familje nga skema e ndihmës ekonomike dhe, së dyti, këtë nuk e themi ne, por e thonë familjet shqiptare, ndihma ekonomike sot është një lëmoshë për ta. Bazuar edhe në vendimin e KLSH-së unë dua ngre dy pyetje:

Së pari, mbi çfarë kriteri është bazuar shuma e përcaktuar e ndihmës ekonomike, sepse ajo nuk reflekton nevojat reale dhe aktuale të familjeve, duke qenë se nuk ka një vlerë zyrtare të përditësuar të minimumit jetik në Shqipëri?

Së dyti, mbështetja me ndihmë ekonomike nuk bazohet në nivelin e lartë të çmimeve, në produktet e shportës së konsumatorit dhe çmimet e larta që janë në Shqipëri. Sipas shqetësimeve të ngritura nga qytetarët kjo ndihmë ekonomike nuk reflekton nevojat reale që kanë qytetarët. Këtë nuk e them unë, por e thotë raporti dhe mendimi i KLSH-së. A pranoni ju, zonja Ministre, që mijëra familje janë larguar padrejtësisht për shkak të mosnjohjes së formulës së pikëzimit, sepse kjo formulë nuk ka qenë transparente për mijëra familje, të cilat kanë aplikuar? A pranoni ju që procedurat e tejzgjatura dhe burokratike të kësaj skeme kanë penalizuar mijëra familje, duke u endur nga një zyrë në tjetrën, me dosje jashtëzakonisht të kushtueshme? A jeni dakord për fshehjen e transparencës së formulës së pikëzimit, sepse qindra familje kanë shprehur ankesën se kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike, sepse nuk ishin të qartë për këtë formulë dhe çfarë realisht kërkonte kjo formulë?

Faleminderit!

Ogerta Manastirliu – Unë e shpjegova edhe më parë çështjen e transparencës së formulës. Formula i ka të gjitha variablat të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficientët e variablave janë hartuar nga ekspertiza e Bankës Botërore dhe kjo është një skemë transparente e aplikuar në sistem. Sistemi, në mënyrë automatike, gjeneron të gjithë koeficientët që u duhen administratorëve në raport me përfshirjen e familjeve në skemë.

Lidhur me çështjen e burokracisë, që ngritët me të drejtë, zonja Kërpaçi, unë nuk e di se sa e informuar jeni për skemën e ndihmës ekonomike aktualisht, sepse sot nuk ka më burokraci. Është e vërtetë ajo që thoni ju, që ka pasur burokraci, por kjo ka ndodhur para aplikimit të formulës së re. Unë e thashë në fillim të fjalës sime, që qytetarëve u duhet të merrnin dokumente zyrë më zyrë dhe derë më derë për të aplikuar për ndihmën ekonomike.

Sot familjet shqiptare aplikojnë pranë njësisë administrative përkatëse vetëm me kartë identiteti për t'u futur në skemën e ndihmës ekonomike. Kjo mënyrë është shumë më e thjeshtë seç ka qenë dhe nuk ka më burokracira, pasi është përcaktuar një afat kur ata depozitojnë formularin dhe nga një muaj, që ka qenë, verifikimi është bërë një herë në tre muaj. Verifikimi bëhet në mënyrë automatike dhe nuk ka më nevojë që qytetari të marrë dokument nga zyra e punës, të marrë dokument nëse ka apo jo makinë, të marrë dokument te zyra e gjendjes civile,

por ai thjesht deklaroi dhe plotësoi formularin me ndihmën e administratorit. Prandaj, siç e thashë edhe më parë, është e nevojshme që të ketë më shumë persona të përgjegjshëm dhe teknikë, ndaj nuk duhet të bëjmë shumë ndërrime të administratorëve socialë, pasi ata trajnohen. Ne kemi marrë një proces shumë të gjërë dhe të gjatë trajnimesh për sa u përket administratorëve shoqërorë nëpër bashki, sepse ata mësohen që të plotësojnë formularin, pasi edhe plotësimi i formularit, sqarimi që u bëhet qytetarëve ka specifika të tij dhe në këtë aspekt ata duhet të jenë shumë të kujdesshëm dhe shumë të përgjegjshëm. Nga ana tjetër, edhe qytetarët duhet të informohen, që në rast se nuk do të thonë të vërtetën do të pezullohen si përfitues të ndihmës ekonomike, dhe nëse do të deklarojnë në mënyrë të rreme do të konsiderohen si abuzivë. Pra, është shumë e rëndësishme kjo lloj qasjeje, ky lloj bashkëpunimi dhe kjo përgjegjësi që administratorët socialë dhe njësitë administrative duhet të kenë në raport me qytetarët. Lidhur me pjesën teknike, do t'ju përgjigjet drejtoresha.

Petrit Vasili – Po, zonja Seferi.

Denada Seferi – Normalisht ka një tavan për ndihmën ekonomike dhe është një masë e përcaktuar e dhënies për çdo anëtar të ndihmës ekonomike dhe këtu janë ndjekur të gjitha kriteret si pasojë e ICD-së. Ekspertët e Bankës Botërore kanë bërë një ndarje, duke u dhënë një pagesë më të lartë fëmijëve dhe më pak kryefamiljarëve, të cilët mund të jenë në moshë aktive pune. Pra, janë përmbajtur këto kriteret për masën e shumës së përcaktuar. Në fakt, përcaktimi i masës dhe shumës për çdo anëtar të familjes, që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, është me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me udhëzim.

Petrit Vasili – Faleminderit!

Zonja Metaliaj ka kërkuar fjalën.

Lindita Metaliaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë nuk do ta kisha menduar ndonjëherë se në Shqipërinë e 2019-ës do të flisnim për varfëri ekstreme, për mjerim migjenian dhe për uri. Realisht mendoj se ato mijëra familje, të cilat janë përjashtuar, në mënyrë abuzive dhe jo të drejtë, nga skema e dështuar e ndihmës ekonomike sot janë duke na dëgjuar nëpërmjet ekranit. Shpresoj shumë që, në një mënyrë apo në një tjetër, nga ministrja të presin një fjalë të mirë, që të thotë se cilat janë mënyrat për t'u rifutur në skemë apo cilat janë mënyrat që t'u rritet sado pak ndihma ekonomike, sepse ajo nuk quhet ndihmë ekonomike, por lëmshë.

Në raportin që ka paraqitur Ministria e Shëndetësisë thuhet se maksimumi është 10 mijë lekë të rinj. Unë dua të di vetëm një familje, e cila merr 10 mijë lekë të rinj ndihmë ekonomike, vetëm një, nuk dua më shumë, sepse maksimumi, sipas informacionit që kam unë, është 8 mijë lekë të rinj.

Tjetra, në Bashkinë e Lezhës janë përjashtuar 800 familje nga skema e ndihmës ekonomike. Kjo është të talleni me ata qytetarë që po na ndjekin, me ato 800 familje, sepse nuk bëhet fjalë për abuzues, por janë familje ekstremisht të varfra, janë familje që në fund të ditës u mungon buka e gojës.

Në Mirditë është përgjysmuar numri i familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, ndërsa në Kurbin 70% e familjeve janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike. Tani, nëse këto përjashtime janë bërë për të nxitur punësimin, sepse këtu doli që në qarkun Dibër është nxitur punësimi, në Bashkinë Devoll është nxitur punësimi, mua më vjen shumë mirë, sepse të mendohet që, duke i hequr bukën thatë të gojës, të nxisin punësimin, janë politika që vetëm qeveria “Rama” mund t’i bëjë dhe asnjë qeveri tjetër në botë.

Në emër të qytetarëve që po na ndjekin, unë di të them se kjo skemë është po aq e dështuar dhe po aq korruptive sa vetë ministria dhe qeveria që e drejton.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Po, fjala për ju.

Flamur Golemi - Faleminderit!

Në fakt, gjëja e fundit që do të doja është të bëhesha pjesë e skenave që të paktën përjetuam të gjithë së bashku sot. E kam thënë edhe një herë tjetër që, për sa kohë të jem në politikë, nuk e kam në plan të bëjë politikë me varfërinë, apo me ndihmën ekonomike, apo të jem pjesë e atyre skenave që përjetuam sot. Unë kërkoj, së pari, nga përfaqësuesit e grupit socialist në kryesinë e komisionit, që të japin përgjigje për atë çfarë ndodhi sot në këtë komision.

Për sa i përket ndihmës ekonomike dhe asaj çfarë ndodh në qarkun e Gjirokastrës, edhe unë, sigurisht, para se të vija, mora informacion përkatës nga drejtuesit e pushtetit lokal dhe të shërbimit social shtetëror.

Në qarkun e Gjirokastrës janë 1023 persona aplikues, ndërkohë që kanë përfituar 840 persona. Funksionon apo jo skema? Sigurisht që për mua funksionon, por ka nevojë për korrigjime, siç e tha edhe ministrja. Por ndryshe nga çfarë ka qenë më parë, nuk kemi ose janë shumë të reduktuar personat që abuzojnë. Skema e ndihmës ekonomike nuk përfitohet sipas testerave të partisë që mbahen në xhepat e individëve dhe, sigurisht, janë thjeshtësuar shumë edhe procedurat.

Lidhur me 6%-shin, që kalon te pushteti lokal, mund të them se para disa kohësh pati një propozim nga një deputet i Partisë Socialiste për ta korrigjuar këtë defekt dhe këtë mangësi që ekziston aktualisht. Gjithashtu, nga përfaqësuesit e ministrisë u tha që shumë shpejt do të kishim edhe projektligjin përkatës. Ne jemi në pritje dhe shpresojmë nga ministra që të jetë sa

më i shpejtë për ta korigjuar, sepse nuk mund të lejojmë, qoftë edhe për teka, kushdo qoftë nga këshilltarët e çfarëdolloj ngjyre politike, të privohen qytetarët nga 6%-shi që ju takon.

Në shifrat që pata, diku te 115 persona të larguar nga skema dhe t'u jetë ofruar punësim. Sigurisht kjo do të jetë qasja dhe orientimi i ndihmës ekonomike: punësim dhe arsim profesional.

Përgëzoj bonusin e bebeve, që tashmë ka filluar dhe mendoj që kjo reformë të vazhdojë. Para se të vija po lexoja edhe për qeveri të tjera, ku për familjet me 3 fëmijë kredia zërohej apo te fëmija i katërt taksa shkon drejt zeros. Sigurisht që duhet të vazhdojmë me këtë lloj trendi dhe me këto politika.

Dua një përgjigje për personat me aftësi të kufizuar, ku në emër të tyre ju falënderoj, sepse unë si mjek kam parë çdo ditë mënyrën sesi merrej deri sot aftësia e kufizuar dhe thjeshtëzimi që i ka ndodhur procedurave për të përfituar aftësinë e kufizuar. Edhe këtu unë mendoj se duhet të ndërhyjmë dhe të kemi mundësi të ndryshojmë diçka për ata persona që nuk kanë pasur mundësi punësimi 1 vit në 5-vjeçarin e fundit. Së shpejti unë do të bëhem pjesë e një nisme për këta persona.

Faleminderit, kryetar!

Petrit Vasili – Kam një pyetje të karakterit teknik. Mora shtysë nga shifrat që zonja Xhembulla dha. Ju e dini se ka qenë objektiv që brenda vitit 2017 5 % e personave që përfitojnë nga skema, nëpërmjet punësimit do të largoheshin nga skema.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka qenë?! Objektiv i strategjisë kombëtare juaja ka qenë deri në 5%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë u referohem objektivave të strategjisë. Dokumentin duhet ta citoj, por nëse ju nuk doni, nuk e citoj. Më bëri përshtypje, sepse në atë kohë ky objektiv arriti deri te 4%-shi, ku nga 79000 që ishin në skemë, 3269 përfitues të skemës u punësuan, por më bën përshtypje se nga të gjitha qarqet e vendit, i vetmi qark që kishte nivelin e punësimit 0, ishte Dibra, ndërkohë që sot shifra e atyre që përfitojnë ndihmë ekonomike është 9000 e ca, por ka qenë 12000 e ca. A keni ndonjë koment për këtë, meqenëse shifrat janë të tilla?

Ogerta Manastirliu- Siç e thashë edhe më parë, në Dibër nëpërmjet programit të punësimit, të dedikuar për anëtarët e familjeve në programin e ndihmës ekonomike apo ata të cilët nuk janë përfshirë në sistemin elektronik si përfitues, nga janari deri në nëntor janë 107 qytetarë. Më falni që nuk e kam shifrën e dhjetorit. Ndërkohë që në dhjetor të vitit 2018 janë rreth 5222 përfitues të ndihmës ekonomike. Patjetër që ka ende shumë për të bërë, por nuk duhet të harrojmë se përfitues të ndihmës ekonomike kanë qenë edhe ato raste abuzive, të cilët,

si pasojë e shtrirjes së skemës, kanë rezultuar me makina, me shtëpi dyaktëshe, me paga të padeklaruara dhe shumë elemente të tjerë, të cilët i kanë bërë këto persona të pa...

Petrit Vasili – Më falni që po ju ndërpres, por këtë shpjegim ju e shteruat gjerësisht që ka pasur abuzivitet, por pyetja ime ishte shumë e shënjestuar. Për vitin 2017 unë po ju jap një shembull, ku diferenca ndërmjet Elbasanit dhe Dibrës ka qenë rreth 25%, ndërkohë që në Elbasan punësoheshin 2266 vetë, ndërsa në Dibër numri ishte 0. Këto janë tabelat e shërbimit shtetëror në ministri, jo të miat. A ka ndonjë shpjegim pse në atë kohë shifra ka qenë zero?

Ogerta Manastirliu – Më fal, kryetar, cilit vit i referoheni?

Petrit Vasili - Fundit të muajit dhjetorit të vitit 2017.

Ogerta Manastirliu — Unë me këto shifra i referohem skemës së re të vitit 2018.

Petrit Vasili – Unë nuk kërkoj të përgjigjeni me pahir, por më bën përshtypje fakti që ekzistojnë diferenca kaq të mëdha. Në qoftë se në Elbasan kishte 2266 të punësuar dhe në Dibër ishte zero, unë mendoj se është një shifër që duhet të shqetësohesh, ndërkohë që qarku për numrin e madh që ka në raport me popullsinë përballohet me një varfëri të madhe. Prandaj them se programi i punësimit duhet të ishte i shënjestuar fort këtu, sepse shifra zero të fut në mendime.

Ogerta Manastirliu – Ju, patjetër i referoheni një shqetësimi të vitit 2017, ku numri i të punësuarve në Elbasan rezulton shumë më shumë se në Dibër, por unë nuk mund t'ju jap një përgjigje, sepse nuk e kam parë materialin që ju dispononi dhe do të doja ta shihja. Unë sot jam këtu për t'iu përgjigjur...

Petrit Vasili – Është cituar edhe në materialin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ogerta Manastirliu – Citimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet t'i referohemi se ku është bazuar, sepse mund të jetë bazuar te SHKP-ja, e cila nuk ka lidhje me efektet që ka prodhuar ndihmë ekonomike. Ajo është çështje e politikave të punësimit, të targetimit të personave dhe ekonomisë së zonës. Pa dyshim që ka shumë elemente, që mund t'i japin edhe arsyetim teknik edhe ekonomik kësaj që ju po thoni, por unë dua të them se në raport me vitin 2018, edhe pse se në Dibër është rritur numri i përfituesve nga janari deri në dhjetor, ka pasur 1792 deklarime të rreme dhe mospërputhje. E them këtë për t'iu treguar se sa ka qenë numri i atyre që kanë bërë deklarin të rremë në plotësimin e formularit. Edhe këta persona nuk përjashtohen nga fakti që mund të jenë familje me problematika sociale dhe ekonomike, prandaj 6%-shi i bashkive synon t'i amortizojë këto familje, të cilat nuk mbulohen nga sistemi elektronik, por nga 6%-shi. Nga ana tjetër, në rast se këto familje kanë anëtarë në moshë aktive pune, referohen nga shërbimi social shtetëror në zyrat e punës si prioritetet për punësim. Fakti që viti 2017, siç thoni ju, pasi unë nuk i kam këto të dhëna, paska rezultuar...

Petrit Vasili – Unë i referohem tabelës, por po të doni mund edhe të mos e merrni në konsideratë.

Ogerta Manastirliu - Jo, unë nuk i kam këtu këto të dhëna, prandaj po them, por ne kemi rezultate pozitive për vitin 2018, me 160 persona të punësuar. I gjithë objektivi dhe strategjia e daljes nga skema është kjo: nëse janë në moshë madhore të aftë për punë duhet t'i aftësojmë profesionalisht, t'i punësojmë dhe t'i nxjerrim nga skema e ndihmës ekonomike. Duke arritur të punësojmë sa më shumë persona, që janë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike, do të shkojmë drejt asaj që skema do të bëhet më efiçiente, do të rritet masa e ndihmës ekonomike dhe mbulimi do të jetë më i targetuar tek ata që kanë më shumë nevojë.

Petrit Vasili – Megjithatë, për t'i qëndruar korrekt pyetjes që bëj, diferenca ndërmjet atyre që marrin ndihmë ekonomike, e cila është 12870 dhe atyre që marrin 9000 është rreth 3000 mijë më pak, nga të cilët ju referuat se 1700 janë me deklaratime të tjera, po pjesa tjetër 1300 ku humbën, sepse nëse nuk ishin të tillë duhet të vazhdonin të trajtoheshin? Cila ka qenë arsyeja madhore që i ka nxjerrë nga skema? Këtu bëhet fjalë për 25% ose 30% dhe impakti nuk është i vogël. Ne duhet të themi që numri është zvogëluar dhe pas verifikimit kanë ndodhur këto gjëra, domethënë 1700 kanë qenë me probleme dhe 1300 të tjerë kanë pasur një problem tjetër. Kjo është një shifër e konsiderueshme, nuk është 18, 20 apo 25 veta.

Klotilda Bushka – Në raportin e paraqitur unë shoh se përveç faktit të uljes së abuzivizmit me përfitimin nga skema e ndihmës ekonomike, e cila sjell si pasojë edhe mundësinë e rritjes së pagesës që merret nga familjet në nevojë, patjetër si një element pozitiv, edhe çështjen e alternimit të të gjithë mekanizmit të ndihmës ekonomike me punësimin e personave në skemë.

Në vitin 2015 numri i individëve të punësuar nga skema ishte 1452 dhe nëse shohim vitin 2016, numri ka shkuar 2424 persona, në vitin 2017 numri është 3269 persona dhe në vitin 2018, sipas shifrave të sotme, është 4266 persona. Pra, shohim se ka një rritje të punësimit, që tregon efektshmërinë e politikës së ndërthurur për ndihmën ekonomike me punësimin e atyre që janë në skemë.

Unë kam një shqetësim, që ndoshta nuk është vetëm kompetencë e ministrisë dhe institucioneve që ju drejtoni, por edhe e atyre të punësimit. Personat që punësohen, domethënë këto shifra në rritje, gjatë periudhës së punësimit a ndiqen nga shërbimi social shtetëror? Kjo për të kuptuar nëse ky punësim është i qëndrueshëm, sepse përndryshe do të rikthehen prapë në skemë. Pra, a kemi ne një politikë qëndrueshmërie? Këtë e them, sepse shumë persona punësohen në zyrën e punës, por më pas nuk kanë aftësinë e duhur, dalin nga puna, nuk u pëlqen më ajo punë dhe ngelim te situata e mëparshme.

Pyetja e dytë lidhet me 6%-in e bashkive për të ulur pikërisht ato emocione që nuk i ka sistemi dhe i sheh në mënyrë të ftohtë. Në zonën ku unë punoj, 6%-shi i ka realizuar pritshmëritë e atyre që nuk përfituan dot nga sistemi elektronik i ndihmës, por nuk e di si është për njësitë e tjera vendore në të gjithë Shqipërinë. A ka rezultuar efektiv 6%-shi edhe për njësitë e tjera vendore dhe nëse jo, a jeni duke menduar që ky 6%-ësh të rritet?

Ogerta Manastirliu – Politika e punësimit dhe punësimi i qëndrueshëm në vetvete është një ndër prioritetet tona, pavarësisht se nuk është i lidhur drejtpërdrejt vetëm me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por edhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në raport me shërbimin Kombëtar të Punësimit. Ne kemi bërë një marrëveshje midis dy institucioneve, veçanërisht dhe specifikisht për anëtarët e familjeve të skemës së ndihmës ekonomike dhe prioritetin që kanë jo vetëm në gjetjen e punësimit, por edhe në qëndrueshmërinë e punësimit të tyre. Nga kjo marrëveshje jo vetëm që lehtësohet punësimi si prioritet për të dalë nga skema e ndihmës ekonomike apo edhe atyre që nuk kanë mundur dot të futen nëpërmjet sistemit elektronik, pra të dy targetet kanë prioritet në raport me marrëveshjen që ne kemi me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, por, gjithashtu, ata ndiqen edhe 3 muaj më pas nga punësimi i tyre për të parë se sa efektiv kanë qenë në punë apo për të parë edhe mundësi të tjera për të mbështetur këta anëtarë të familjes.

Për sa i përket analizës së 6%-shit, duke qenë se kemi vlerësuar 6%-shin në ato bashki, të cilat kanë treguar përgjegjësi për ta dhënë në momentin e parë, kur skema filloi të aplikohet në mbarë vendin, pamë se pati një efekt zbutës të atyre efekteve që solli futja e një sistemi të ftohtë në aspektet e ndihmës.

Patjetër, jemi duke e parë mundësinë për ta formalizuar sa më shumë këtë 6% (atë që i thashë edhe kryetarit të komisionit), sepse skema sa më shumë të jetë formale dhe e strukturuar, sipas një sistemi elektronik, aq më shumë është e drejtë. Nga ana tjetër, e kemi krijuar këtë lehtësi për vetë bashkitë, që ato të vendosin kriteret e tyre sociale, në mënyrë që të mos ngelet asnjë familje e papërfshirë, familje të cilat me të vërtetë kanë nevojë për t'u mbështetur nga kjo lloj pagese, që i bie përsëri nga buxheti, pra nga Ministria e Shëndetësisë. Analiza është duke u bërë, pasi për strategjinë e riskut jemi duke u konsultuar me Bankën Botërore dhe me një asistencë teknike, ku strategjia e daljes për skemën e ndihmës ekonomike do të na japë edhe një vlerësim për strategjinë që ne do të ecim në raport me fondet, 6%-shin, por edhe në raport me rishikimet e mundshme të skemës, jo për të ndryshuar formulën, pasi formula është e suksesshme, por për të bërë axhustimet e duhura në raport me përfituesit.

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Ministre!

Urdhëroni, zonja Spahiu!

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zoti kryetar!

Çështja që po diskutojmë sot është me të vërtetë shumë delikate dhe po të kthehemi pas në kohë, ne i kemi provuar të dyja sistemet, kemi provuar sistemin e ndihmës ekonomike ku ndahej nga njësia vendore, dhe kemi parë sa shumë vuanin njerëzit dhe se sa jorezultative ishte. Sistemi i ri duhej bërë dhe, fatmirësisht, janë vendime që janë marrë që në vitin 2009, dhe në vitin 2013 e më tutje ne kemi qenë dëshmitarë dhe e kemi ndjekur rregullisht se çfarë ka ndodhur me sistemin e ndihmës ekonomike. Në komisionin parlamentar ka pasur dëgjesa në mënyrë të vazhdueshme dhe me përfaqësues të ministrisë për çfarë ka ndodhur ndër vite. Në qoftë se ne do ta shikojmë me një sy tjetër, me syrin e interesit të qytetarit, dhe të mos përfshihemi politikisht në deklarata politike, mendoj se ky lloj sistemi nuk krahasohet fare me atë që ka ndodhur më parë, sepse është e vetmja mënyrë për të targetuar ata që janë në nevojë dhe më të varfrit. Në qoftë se ne nuk jemi dakord me mënyrën e pikëzimit dhe themi se kriteret e pikëzimit duhet t'i kemi më të buta, atëherë duhet të themi se duhet të kemi një buxhet shumë më të madh për të shtuar edhe njerëz, që nuk janë shumë të varfër. Për një gjë duhet të biem dakord të gjithë bashkë sot nga kjo tryezë, që kjo skemë duhet të funksionojë, që të fillojë mbështetja për ato që realisht janë nevojtarë. Nëse ne themi: në rregull edhe një pjesë e tyre që kanë dalë nga skema në mënyrë të padrejtë dhe që nuk kanë abuzuar kanë nevojë për ndihmë ekonomike, a nuk jemi të gjithë dakord se nëse këto familje kanë njerëz që janë në moshë pune në familjen tyre, të punojnë dhe të kthehen riintegrit, që të mos mbeten gjithë kohës të varur nga ndihma ekonomike. Për këtë duhet të biem të gjithë bashkë dakord, që duhet një format i ri, ku ne duhet t'i nxisim familjet në nevojë. Si duhet t'i nxisim familjet në nevojë? Nëpërmjet një arsimimi të detyruar. Në qoftë se e marrin ndihmën ekonomike, nuk duhet t'i mbajnë fëmijët në shtëpi, duhet t'i regjistrojnë në shkollë. Ne ua japim ndihmën ekonomike, por do t'u themi që fëmijët duhet t'i vaksinojnë. Të mos harrojmë që ka plot familje, të cilat e marrin atë ndihmë ekonomike, por duhet të kenë edhe një nxitje të mëtijshme për riintegrim, sepse situata që ne kemi sot pretendon për një kërkesë tjetër të qytetarëve. Pra, në qoftë se ne do të biem dakord që të targetojmë ato që janë me të vërtetë shumë në nevojë, pra të mbështesim gratë kryefamiljare, dhe të gjitha ndryshimet që kemi bërë ndër vite, si Aleancë e Grave Deputete, kanë qenë në këtë frymë: ne të ndihmojmë që të përfitojnë ata që kanë vërtet nevojë dhe, mbi të gjitha, të mbështesim gratë kryefamiljare. Pra, këto kanë qenë ndryshimet që kemi propozuar ne në këtë parlament dhe që, për fat të mirë, ka ardhur dita që sot të kemi një sistem elektronik, i cili i ka të gjitha të dhënat për secilën familje që aplikon për ndihmë.

Nuk duhet të harrojmë edhe një gjë thelbësore, sot me të vërtetë një familje shumë e varfër mund të mos ketë mundësinë për të aplikuar, por mua më jepet mundësia që t'u bëj një

thirrje administratorëve kudo që janë, edhe në ato bashki që e drejton e djathta, sepse në qoftë se ai nuk e ka zërin dhe forcën që të shkojë deri tek administratori, duhet administratori të shkojë pranë familjes në nevojë, ky shqetësim na vjen në mënyrë të vazhdueshme, duke qenë deputetë nëpër zona, jemi të detyruar që ne të kontaktojmë shpeshherë dhe të marrim ankesa. Për shembull, për rastin e djeshëm të dhënat u shfaqën nga një televizion dhe ne e morëm në telefon, gjetëm mundësi për të kontaktuar me atë grua, e cila ishte në nevojë dhe duhej mbështetur, por duhet që administratori i zonës të jetë më prezent për të identifikuar raste të tilla.

Të nderuar kolegë, familje në nevojë, do të ketë sot, do të ketë edhe në vazhdimësi dhe nuk mbaron me këtë dëgjese. Ndaj, dua të kërkoj mirëkuptimin tuaj, që ne mos ta përdorim komisionin politikisht, sepse ajo që ndodhi sot dhe që kolegu me të drejtë më kritikoi mua, ishte një situatë e paprecedentë, ishte një situatë e pafalshme, për të cilën do të mbajnë përgjegjësi ata që e organizuan dhe nuk mund të përdoret kurrën e kurrës një qytetarë i varfër për qëllime politike. Unë kërkoj të gjithë dashamirësinë dhe mbështetjen tuaj, që ne të vazhdojmë punën në komision, siç e kemi bërë deri tani, sepse deri tani nuk ka një njeri që ka kërkuar dëgjese, pra të dëgjohet në këtë komision, dhe nuk ka ardhur të paktën nga viti 2009 që kam qenë vetë e deri tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Spahia, të mbaroj, sepse bëtë gjithë atë zhurmë sot, më pas jua jep fjalën kryetari.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ore, çfarë burrash jeni ju që ofendoni gratë në çdo moment?! Si të mos kthehem, keni që në fillim të seancës që ofendoni gratë?! Turp t'ju vijë që ofendoni gratë e komisionit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Ju lutem, mos e rihapni këtë situatë, sepse nuk ka nevojë!

Klodiana Spahiu - E bën vetëm për qëllime mediatike. Nuk ke të drejtë fare të bësh pyetje, sepse jam duke folur. Doni që të mbështesni njerëzit, por ju nuk dini të respektoni koleget që keni në komision.

Petrit Vasili - Zonja Spahiu, të lutem, vazhdoni!

Klodiana Spahiu – Unë do të vazhdoj me qetësi, por ofendimet që ju bëni në mënyrë të vazhdueshme...

Petrit Vasili - Unë po ju bëj ofendime?!

Klodiana Spahiu – Të dy bashkë.

Petrit Vasili - Si të dy bashkë moj?! Unë të thashë: “Të lutem, vazhdo”!

Klodiana Spahiu – Ofendimet që u bëni në mënyrë të vazhdueshme deputeteve të komisionit, janë të pafalshme! Megjithatë, unë nuk barazohem fare me asnjë lloj niveli dhe secili vjen në komision për t’u paraqitur për veten e tij dhe nuk mbaj fare përgjegjësi se çfarë nxjerr nga goja ti, Bardh Spahia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili - Të lutem, zonja Spahiu, vazhdoni!

Klodiana Spahiu - Ti nuk mund të vazhdosh më të ofendosh gratë në komision, sepse do të kërkojmë masë ndaj teje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Zoti Spahia, mos ndërhyini më!

Klodiana Spahiu – Është e vërtetë që kjo seancë dëgjimore u kërkuar nga një anëtare e opozitës, por me këtë seancë dëgjimore, pa dyshim, ishim dakord të gjithë, sepse është një skemë dhe një punë e bërë ndër vite, është një skemë që ka filluar që në vitin ’92 dhe do të vazhdojë kjo skemë edhe kur të mos jemi ne. Historia e ndihmës ekonomike, përveç faktit se duhet një herë të vetme të formatizohet dhe të ketë regjistra të tillë elektronike, ku dikush hyn dhe dikush del, patjetër që do të jetë e tillë. Ne duhet të insistojmë, që në qoftë se ka raste që nuk e kanë përfituar ndihmë ekonomike për arsye të mosmbështetjes, për arsye të paditërisë, për arsye të moskorrektesës në punë dhe administratorit shoqëror, hajdeni të bëhemi bashkë, të shkojmë në çdo rajon që është i mundur dhe të nxjerrim mangësitë dhe problematikat. Askush nga ne sot apo nesër, kur do të ndodhë diçka tjetër, apo do të jetë në pushtet dikush tjetër, nuk do të ndihet mirë kur të shikojë kronika që në vendin tonë ka familje shumë të varfra. Ato familje duhen mbështetur, por të jeni të sigurt që për të ardhur zëri i tyre deri në nivelin e ndihmës ekonomike, duhet një bashkëpunim shumë i madh midis të gjithë aktorëve dhe faktorëve, sepse vetëm me ligje kjo punë nuk bëhet.

Edhe një herë, dua t’ju përshtendës për një fakt shumë të madh, sepse një pjesë e përfaqësuesve që janë këtu sot nga ministria, kanë qenë që në atë kohë dhe na kanë raportuar vazhdimisht se çfarë ka ndodhur, ku jemi dhe çfarë do të kemi në vazhdimësi. Prandaj kjo nuk është më çështje emrash dhe as çështje numrash, unë e konceptoj ndryshe këtë fenomen. Në qoftë se ju mendoni që kjo punë zgjidhet kështu, duke shtuar numrin e familjeve ekonomike në listë, unë them jo. Unë mendoj se kjo punë, së pari, zgjidhet me rritjen ekonomike dhe me nxitjen e politikave të punësimit. Kemi një ligj që na ka ardhur dhe mendoj se është shumë i mirë, do ta shikojmë të gjithë bashkë dhe do ta konsultojmë edhe me grupet e interesit. Mendoj se kjo duhet të jetë fryma e punës në këtë komision.

Të nderuar kolegë të maxhorancës, ju kërkoj të gjithëve ndjesë për atë fenomen që ndodhi sot!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Spahiu!

Urdhëroni!

Grida Shqina Duma – Kam depozituar kërkesën për projektin e Bankës Botërore, si vijon ecuria me të gjitha kushtet, si janë llogaritur koeficientët, varfëria në qarqe të ndryshme dhe gjithçka tjetër. E kam bërë këtë kërkesë 3 muaj më parë, jua rikërkoj, por duhet të jetë edhe në procesverbal. Nuk e di se cila është mënyra për t’ju shtrënguar juve të jepni informacionin transparent dhe të plotë, sepse nuk e keni sjellë.

Së dyti, ju bëj përsëri kërkesë për t’u shënuar qartazi për dhënien e justifikimit apo atë që ju e quani argumentim të Bankës Botërore, e cila, sipas jush, thotë se nuk duhet publikuar pikëzimi dhe kriteret. Ne e duam atë shkresë.

Së treti, shqetësimi madhor mbetet, ka qenë 80 mijë lekë të vjetër maksimalja dhe mbetet po aq, që nga viti 2012. Në vitin 2019 indikatorët e jetës janë rritur nga 35% deri në 40%, pra shtrenjtësia e jetës dhe kostot e jetesës. Përveçse nuk ka një minimum jetik, i cili është një diskutim tjetër dhe nuk i takon kësaj tryeze, minimalisht duhet të kishte pasur një indikator tjetër të kostove të jetesës dhe duhej të pasurohej. Pra, cilat masa dhe pse nuk merrni masa për 80 mijë lekë të vjetër, të cilat nuk rritet që nga viti 2012 deri sot? Këto nuk janë çështje të këtij komisioni për t’i dhënë tani përgjigje, të tria këto çështje i kërkoj me shkresë. Kur nis 11-milionëshi, që keni marrë kredi? Si do të shpenzohen dhe për çfarë? Si janë shpenzuar? Ju thoni 40, dikush thotë 50, dikush tjetër thotë 61. Shifra nga më të ndryshmet midis medias e të tjerëve. Minimalisht ky komision duhej të kishte një shkresë, ku të tregohej sa është projekti në miliona, sepse i kalon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjitha këto i kemi kërkuar, në vitet 2003, 2009, në çdo kohë është kërkuar kjo shifër. Duhet të keni parasysh se minimalisht vetëm projekti për asistencën është sa 1 vit ndihma ekonomike për të gjithë shqiptarët.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Shqina!

Nuk shikoj që të ketë ndërhyrje të tjera, kështu jemi drejt mbylljes.

Në lidhje me pyetjet e fundit, në qoftë se zonja ministre mjaftohet me shënimin e tyre dhe me kthimin e informacionit, atëherë kjo është korrekte. Për pjesën e informacionit të munguar, besoj se në ditët në vijim ministria do të na i vërë në dispozicion. Në rast se zonja Shqina, mendon t’ia drejtojë edhe formalisht për informacion...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithsesi, biem dakord për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Normalisht, sipas Rregullores së Kuvendit, pas 2 javësh është procedura e kthimit të përgjigjes, por besoj se për këtë punë kemi mirëkuptimin e njëri-tjetrit.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit dhe do të vazhdojmë sipas kalendarit që miratuam sot.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA